



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 3 QERSHOR 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
3. JUNA 2011. GODINE**

**QERSHOR - JUNA
2011**

E premte, 3.6. 2011, ora 10:00

Drejtton seancën: nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas rendit të ditës pikë e parë është-

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar, siç e dini, zgjat në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Andaj, kërkoj nga deputetët e paraqitur për diskutim që të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Tani siç e dini sipas Rregullores, radha është e atyre që kanë mbetur nga seanca e kaluar për ta marrë fjalën.

Me qenë se është praktikë që të paraqiten shumë, po thuaj se, s'ë di a kanë nevojë ta marrin fjalën a jo, po sipas Rregullores unë jam i obliguar që t'ua jap fjalën.

Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në mbledhjen e 18 majit 2011, Qeveria e Kosovës ka marrë vendimin mbi themelimin e Ministrisë së Diasporës, e cila njëherit është edhe ministria numër 19 e kësaj Qeverie. Në këtë mënyrë Qeveria e Kosovës u bë te qeveritë me numër më të madh të ministrive dhe zëvendëskryeministrave jo vetëm në regjion, por edhe më gjerë, madje, duke tejkaluar në këtë drejtim edhe shumë e shumë shtete të mëdha dhe të zhvilluara ekonomikisht.

Kështu, krahasuar me vendet e regjionit, Kosova ka më shumë ministri se sa Mali i Zi, Sllovenia dhe Bullgaria, të cilat kanë nga 17-sish, pastaj se Kroacia dhe Rumunia që kanë nga 15, si dhe Shqipëria dhe Maqedonia që kanë nga 14 ministri.

Për fat të keq, Kosova në krahasim edhe me shumë shtete të mëdha, si për nga numri i banorëve dhe territori, ashtu edhe për nga zhvillimi ekonomik, ka numër më të madh të ministrive, si për shembull qeveritë e Rusisë, Spanjës dhe Francës kanë nga 18 ministri, ndërsa Qeveria e Gjermanisë, me 80 milionë banorë apo 40 herë më shumë banorë se sa Kosova, ka vetëm 13 ministri.

Vërtet është për t'u habitur se si një vend, me një popullatë jo mbi 2 milionë, me një territor që nuk arrin as 11 mijë kilometra katrorë, me një zhvillim tejet të ulët ekonomik, me një shkallë të lartë të papunësisë dhe me një përqindje të lartë të popullatës së papunë, të ketë një Qeveri kaq të numërt e cila do të rëndojë edhe buxhetin tejet të varfër të Republikës së Kosovës, i cili, madje, pas shpërbërjes së njëanshme të Marrëveshjes me

Fondin Monetar Ndërkombëtar, për fajin e kësaj Qeverie, në këtë vit do të varfërohet edhe për 150 milionë të tjerë.

Kjo Qeveri paraqet një barrë të rëndë për buxhetin e Kosovës, i cili sajohet kryesisht nga taksat e popullatës së varfër të Kosovës, sepse përbëhet nga një kryeministër, 6 zëvendëskryeministra, 19 ministra, të cilët do t'i kenë edhe 38 zëvendësministra, diku afër 120 këshilltarë të ndryshëm, 65 shoferë personal, 65 asistente, e që vetëm me pagat e tyre mujore, Kosovës do t'i kushtojnë mbi 2 milionë e gjysmë euro në vit.

Po që se llogariten edhe shpenzimet e tjera të tyre, si për derivate, mëditje, bileta udhëtimi, atëherë kjo shumë e shpenzimeve për këtë kabinet qeveritar, sigurisht do të dyfishohet dhe arrin mbi 5 milionë.

Jam i vetëdijshëm që shteti nuk mund të funksionojë pa Qeveri, respektivisht Kabinet qeveritar, por assesi nuk e arsyetoj një qeveri e cila konstruktohet për përshtatjen e apetiteve partiake të partnerëve të koalicionit.

Aq më parë arkitektët e një qeverie të këtillë të Kosovës, duhet të pasur parasysh fatin se në Kosovë jeton popullata më e varfër e Evropës, respektivisht e 177 në botë për nga varfëria, në të cilën afër 30% e popullatës së saj, jetojnë në një varfëri të skajshme, andaj, edhe shpenzimet për qeverisje duhet të jenë në pjesëtim me jetesën e qytetarëve të saj. Një fjalë e urtë popullore thotë: “Fukaraja mban dy shtëpi”, ndërsa populli i varfër i Kosovës, përveç familjeve të tyre, po e mban edhe Qeverinë e stërmadhuar të Kosovës me shpenzime tejet

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!
Bali Muharemaj, e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua të shpreh shqetësimin tim edhe të qytetarëve të komunës së Suharekës rreth procesit të shpronësimit të pronave të paluajtshme private në hapësirën ku po ndërtohet autostrada Vërmicë – Orlat.

Pronat nëpër të cilat kalon traseja e autostradës nuk po kompensohen në mënyrë të drejtë. Shqetësimi i qytetarëve të komunës së Suharekës ka të bëjë me kriteret që po përdorin gjatë vlerësimit të pasurive të paluajtshme të personave privat. Gjatë procesit të shpronësimit, qytetarët e kësaj komune janë dëshmitarë që kompania e kontraktuar për vlerësimin e pronave po përdor standarde të dyfishta të trefishta apo edhe më shumë.

Është për t'u habitur fakti se si është e mundur që tokat të cilat janë një pozite gjeografike, të njëjta edhe me rëndësi të njëjtë, po paguhën shumë në vlera të ndryshme për kompromis për një ari tokë.

Po ashtu dua të shpreh shqetësimin tim dhe të qytetarëve të komunës së Suharekës edhe për vlerën e kompensimit të pasurisë të shpronësuar. Përderisa gjatë vitit 2010, një ari tokë në të njëjtën hapësirë ku tani po bëhet shpronësimi është shitur në vlerë diku 8300 euro, kopjen e të cilës kontratë me numër 619 e posedoj edhe unë, mirëpo në momentin që është duke u bërë vlerësimi i tokave është 750, 850, 950 dhe 1050 euro.

Të nderuar deputetë,

Qytetarët e Suharekës nuk janë kundër ndërtimit të kësaj autostrade, por ata kërkojnë nga organet kompetente që të dalin në terren dhe t'i hetojnë të gjitha rastet në fjalë, në mënyrë që kjo praktikë të ndalet dhe pronarët e tokave t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të cilat u janë prekur nga procesi i shpronësimit edhe ata të marrin kompensimin e merituar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Sali Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Një çështje e cila është ngritur edhe nga kolegu deputeti që vjen nga komuna e Malishevës, do ta ngre edhe unë sot, ka të bëjë kryesisht me ethet hemorragjike që përfshin regjionin e Prizrenit e veçanërisht komunën e Malishevës, ku prej vitit 2001 deri në vitin 2010, janë regjistruar 454 raste ose 90% e rasteve të etheve hemorragjike dhe për rajonin e Prizrenit janë 27 raste me vdekje, që nënkupton diku rreth 70% e rasteve janë për komunën e Malishevës.

Qeveria e Kosovës ka ndarë një shumë buxhetore në vlerë prej 20 mijë euro, gjë që mendoj është e pamjaftueshme, krahas rrezikshmërisë me të cilën përballlet kjo komunë dhe njëkohësisht kisha kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga vetë ministri që t'ia bëjë një vizitë komunës së Malishevës, Drejtorisë për Shëndetësi dhe njëkohësisht Shtëpisë së Shëndetit në Malishevë, që të marrë informata të sakta lidhur me rastet dhe shqetësimin me të cilin po ballafaqohen qytetarët e komunës së Malishevës.

Njëkohësisht nga ekspertët profesional kisha kërkuar që Ministria e Shëndetësisë të organizojë fushatë vetëdijësuese, kryesisht nëpër shkolla fillore dhe shkolla të mesme dhe njëkohësisht në zona të cilat janë më të rrezikshme dhe janë të prekur nga ethet hemorragjike në komunën e Malishevës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Episodet e tmerrshme, të përjetuara apo të dëgjuara nga të shpëtuarit fatlumë në luftën e fundit, janë të shumta dhe nga më të llojllojshmet, nga më të dhimbshmet, nga më të

paimagjinueshmet. Shumë mendje njerëzore nuk mund ta imagjinojnë atë që ka ndodhur në këtë nën qiell, jo vetëm në luftën e fundit, pikërisht duke respektuar pafajësinë e këtyre mendjeve dhe kohën tonë nuk dua t'i kaloj nëpër mendë as t'ua rikujtojë juve ato histori, që të tjerët kush di se si do t'i kishin trajtuar, paraqitur, riprodhuar apo shfrytëzuar.

Megjithatë, episodi më i tmerrshëm, më i dhimbshëm, më shkatërrues në aspektin gjinor, individual, familjar dhe shoqëror, është ai i dhunimeve.

E di se miqtë tanë ndërkombëtar që shpesh në mirëbesim barazojnë viktimën e dobët dhe të pafuqishëm me agresorin e fuqishëm dhe të paskrupullt, do të thonë dhunime ka në çdo luftë, megjithatë ne nuk mund të besojmë se në secilën luftë ka dhunime të organizuara, masive të orkestruara nga aparati shtetëror i agresorit sikur këto që kanë ndodhur në Kosovë, të paktën jo në Evropë, dhe jo në shekullin XXI.

Unë si nënë, grua, motër, bijë, si edhe shumë të tjera si unë, dua të di përfundimisht sa femra në Kosovë u dhunuan gjatë luftës së fundit? Kush duhet ta sigurojë dhe vërtetojë një të dhënë të tillë, sa prej këtyre kriminelëve të sëmurë mendërisht e shpirtërisht u identifikuan, akuzuan dhe u dënuan? Çfarë është bërë për të ndihmuar risocializimin e këtyre viktimave apo për të zbutur dhimbjen e grave të dhunuara që u dëbuan në rrugë nga burra trima, që nuk qenë të zotë t'i mbrojnë nga dhunuesit, por patën fuqi t'i ndajnë nga fëmijët e tyre dhe t'i hedhin në rrugë? A ka dobësi më të madhe se kjo? Kush nuk ka respekt për atë burrë që e ndihmoi gruan e vet për ta tejkaluar këtë akt mizor dhe pasojat psikologjike të kësaj thyerje shpirtërore dhe kush nuk ndjen neveri për burrërinë e pështirur të atij që dëboi gruan, pse e pa tek e dënonin dhe s'ishte i zoti ta mbrojë. Kush duhet dhe kur ta përgatisë dosjen e dhunimeve në Kosovë?

Mendoj se sjellja jonë si shoqëri me këtë kategori është tregues i pjekurisë sonë si shoqëri, jo vetëm ne si deputetë të popullit, por edhe secili njeri i thjeshtë duhet të ketë shumë më tepër mirëkuptim ndaj këtyre grave dhe të kontribuojë në mënyrë aktive, pa paragjykitime dhe stigmatizim në identifikimin e tyre dhe përgatitjen e dosjes së turpit të një pale apo dosjes së martirizimit të palës tjetër.

Prandaj, thërras në radhë të parë institucionet tona shtetërore, përgjegjëse por edhe secilin individ që të kontribuojë në identifikimin dhe regjistrimin e këtyre rasteve duke iu garantuar anonimitetin maksimal të mundshëm viktimave. Thërras gratë e dhunuara, që për të mos mbetur viktimat të përjetshme, t'i paraqesin rastet e tyre në funksion të dënimit të merituar të kriminelëve. Natyrisht, ne të gjithë i përulemi me respekt shpirtmadhësisë së këtyre grave, sepse vetëm njeriu shpirtfortë mund të ngadhënjejë vetveten dhe të heshtë një krim që ia ka shkatërruar jetën, familjen dhe të ardhmen, por, në këtë rast kjo shpirtmadhësi këto gra po i shndërron në viktimat të përjetshme. Prandaj, në mos për shpagimin e vuajtjeve të tyre dhe nëpërkëmbjeve nëpër të cilat kanë kaluar këto gra, duhet t'i paraqesin këto krime të kryera kundër këtyre për hir të drejtësisë, për hir të gjithë atyre viktimave të pafajshme të kësaj lufte...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani. Nuk është.
Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Përshëndetje kryesues,
Përshëndetje ministra,

Ne sot veç jemi në rend të ditës me pikën e prodhimeve vendore të verërave dhe me iniciativën tonë që ne duhet të bëjmë është nga një produkt alkoolik që kanë qenë verërat tani veç me projektligjin e shohim që një produkt ushqimor dhe është çështje e rëndësisë në ligjin për akcizat janë verërat, ende ekziston atje që duhet t'u hiqet edhe akciza, sepse vetëm si produkt nuk i ndihmon prodhuesve vendor. Prandaj edhe në ligjin 2003//L-220 për akcizën, mendoj që Ministria e Financave duhet ta sjellë këtë ligj në Kuvend, ta amendamentojmë dhe ta ndryshojmë edhe konceptin edhe formën që prodhimeve të rrushit t'u hiqet akciza, sepse është një mundësi e stimulimit të bujqve edhe prodhuesve tanë.

Ndërsa, në anën tjetër, mendoj që institucionet tona duhet të bëjnë më shumë pikërisht në këtë drejtim të stimulimit të prodhuesve vendor, jo vetëm të verërave, por të gjitha produkteve të ngrisin cilësinë, sepse me këto kemi mundësi t'i arrijmë edhe objektivat tona në shoqëri dhe në krijimin e kushteve më të mira të tyre. Duke krijuar kushtet edhe stimulimin e bujqësisë, ne i mundësojmë që qytetarët tanë mos të jenë të rrezikuar për shëndetin e tyre nga vendet e ndryshme të rajonit, por edhe të Evropës, por të jenë të sigurt me prodhimet e veta dhe në ushqimet e tyre që i prodhojnë vetë. Prandaj, kërkoj që gjithë atyre prodhimeve vendore, të cilat lidhen edhe me çështje të akcizës t'iu ndihmohet, të hiqet kjo dhe të jetë një mundësi më e mirë për bujqit për prodhimet e tyre vendore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

Punëtorët e ish- Bankës Popullore të Kosovës edhe sot e 12 vjet nga përfundimi i luftës, kanë mbetur pa punë, pa asnjë përkujdesje institucionale, pra kanë mbetur thjeshtë rrugëve, ndonëse shumë herë, me anë të shkresave dhe kërkesave të shumta të tyre, u janë drejtuar institucioneve vendore për zgjidhjen e problemit të tyre.

Pra, për të gjitha këto vite, ato bredhin rrugëve të Prishtinës, pa fajin e tyre, falë neglizhencës, moskuptimit, anashkalimit dhe mos angazhimit edhe të njerëzve përgjegjës në Bankën Popullore të Kosovës.

Ne mendojmë, se në mos të gjithë punëtorët e ish- Bankës Popullore të Kosovës, shumica, ose një pjesë e tyre do të mundë të sistemoheshin në punët dhe detyrat përkatëse, por gjithashtu jemi të bindur se për shumicën e punëtorëve ka pasur hapësirë të mjaftueshme për angazhim në këtë drejtim.

Punëtorët e ish- Bankës Popullore, vazhdimisht, në të gjitha takimet, qoftë me autoritetet vendore e ndërkombëtare, përgjegjëse, janë ankuar dhe kanë marrë premtime se në të gjitha konkurset për pranim, do të kenë përparësi, por për fat të keq kjo nuk ka ndodhur.

Sipas të dhënave përkundër gjithë kësaj përgjegjësit në Bankën Popullore të Kosovës kanë pranuar në punë punëtorë pa kurrfarë eksperience, madje edhe jashtë Kosovës, ndërsa ish- punëtorët kanë mbetur rrugëve. Një kompensim minimal shumë simbolik iu ka dhënë për 6 muaj në vlerë prej 100 markave. Të pakënaqur dhe të shqetësuar tej mase disa herë këta ish- punëtorë janë mbledhur dhe janë tubuar dhe kanë protestuar para ish-selisë së UNMIK-ut dhe Bankës Popullore të Kosovës. Për t'i realizuar të drejtat e tyre ata kërkojnë që zëri i tyre të dëgjohet edhe sot në Kuvendin e Kosovës, me qenë se Banka Popullore e Kosovës është transformuar faktikisht në Bankën Qendrore Kombëtare, ata kërkojnë që të drejtat e tyre seriozisht të merren në konsideratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Afrim Hoti.

AFRIM HOTI: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni që këtu sot para jush të paraqes njërën nga çështjet më të dhimbshme, më brengosëse dhe më të ndjeshme të kësaj shoqërie, e cila është duke ndodhur jo më larg se 50 metra nga ndërtesa e Kuvendit të Kosovës. Këtu ish- ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka kohë që tash janë ngujuar në grevë urie, në një tendë duke kërkuar as më shumë e as më pak nga ky Kuvend, se sa miratimin e Ligjit për vlerat e luftës, ligj ky që më në fund do të institucionalizonte mirënjohjen politike për këtë kategori të shoqërisë.

Të nderuar deputetë,
Këta ish- ushtarë me akt po ashtu janë duke shprehur: pakënaqësitë, mllëfin, dëshpërimin dhe zemërimin e tyre në realitetin e mjerë dhe gjendjen e pashpresë ku është katandisur struktura më e madhe e ish- luftëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të tyre. Përgjithësisht, këta ish- luftëtarë të cilët me gjakun, mundin, djersën dhe sakrificën e tyre ku shumë nga ata që sot ndodhën në tendë kanë dhënë edhe gjymtyrët e trupit të tyre për lirinë që ne sot e gëzojmë, kanë nevojë për një trajtim dhe intervenim urgjent nga ana e këtij Kuvendi për plotësimin dhe realizimin e kërkesave të tyre.

Ndërkaq, ajo tendë dhe gjendja e grevistëve janë panorama reale e kësaj shoqërie dhe më shumë se asnjë dukuri tjetër e pasqyron mënyrën se si sistemi aktual e ka trajtuar deri më sot plejadën më sublime të sakrificës së kësaj shoqërie.

Të nderuar deputetë,
Kjo ngjarje sot më shumë se kurrë duhet të na shërbej si një moment vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi që çdo njeri nga ne t'i bëjë thirrje ndërgjegjes se tij politike, qytetare dhe morale duke parashtruar një pyetje të thjeshtë se këta ish- luftëtarë- a e meritojnë të injorohen, të mashtrohen dhe të poshtërohen nga politika institucionale dhe zyrtare e shtetit të Kosovës, sidomos kur këtu nuk duhet harruar faktin se ishin pikërisht ata veteranë të luftës që sot jo larg nesh, kërkojnë dinjitet dhe drejtësi të cilët dikur në saje të

veprimtarisë dhe guximit të tyre, arritën që t'i përndezin gjeneratorët e rezistencës kombëtare, t'ia rikthejnë dinjitetin dhe besimin e tulatur kësaj shoqërie si dhe shpresën e humbur në potencialet e saj çlirimtare? Pra, ata që dikur me vizion dhe luftën që u pulsonte nga gjakimi për liri pa u dridhur në asnjë moment thellësisht të qenies së tyre nga kauza e drejtë që e mbronin u bënë çelësi i zgjidhjes së të gjitha problemeve të cilat patën kapërthyer si mynxyrë këtë shoqëri, sot fatkeqësisht nga politika e këtij vendi janë katandisur në problem social të kësaj shoqërie.

Të nderuar deputetë,

Këtu duhet rikujtuar se këta veteranë të luftës nuk janë duke kërkuar ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta shtojani. Në emër të Grupit Parlamentar është.

AFRIM HOTI:... asgjë më shumë se një trajtim identik që edhe kolegët e tyre gëzojnë në shtete të rajonit. Bie fjala në Kroaci, luftëtarët e lirisë i kanë të garantuara të gjitha të drejtat e tyre nga shteti për të cilin luftuan dhe u sakrifikuan. Kështu ata edhe sot me kërkesat e tyre vazhdojnë të jenë e vetmja shpresë e shoqërisë që rrezatojnë vlera universale, ashtu sikur se ishin kauza sublime për të cilat u sakrifikuan. Pra, ata nuk janë duke kërkuar privilegje, mbisundim, por vetëm po duan që çështja e tyre të zgjidhet me ligj dhe kështu kalvari i vuajtjeve të tyre të marrë fund një herë e përgjithmonë, me ç'rast deri më tani u ka qëndruar si mallkim mbi jetën e tyre të kapitur. Kështu është obligim i këtij Kuvendi që më tutje të mos e zvarris këtë ligj në sirtarët e administratës së tij, me gjithë arsyetimet banale për shkak të kostos buxhetore duke zgjatur pa fundimisht mos miratimin e tij. Por, duhet që urgjentisht këtë ligj të procedojë në agjendën plenare me qëllim që ai të miratohet sa më parë nga të gjithë deputetët e këtij Kuvendi, pa dallime politike. Pra është ligji, kjo kategori politike dhe juridike që jep fund kësaj gjendje për shkak të vlerës imperative, universale që ngërthen në vetvete dhe miratimi i ligjit mbi vlerat e luftës shënon pikërisht mirënjohjen universale të karakterit që e ka pasur Lufta Çlirimtare e Kosovës.

Paramendoni, vetëm natën e mbrëmshme si e kaluan ata në atë rrebesh shiu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ministra, deputetë të nderuar Kuvendit të Kosovës,

Sot në sallë e kemi ish- anëtarin e Kongresit amerikan zotin Erl Pomeroy një mik i vjetër i Kosovës, një njeri që ja ka kushtuar një kohë të gjatë punës së vet, Kosovës dhe njerëzve të Kosovës dhe në emër tuaj kisha dashur ta përshëndes. Faleminderit!

Pjesa tjetër e fjalës sime do të jetë për 100 ditshin e Qeverisë.

Në shumë vende të botës 100 ditë të Qeverisë maten për shkak se 100 ditë e përbëjnë gati diku 7 ose 8% të jetë gjatjes së mandatit, nëse flasim për maksimum të mandatit prej 4 vjetëve dhe 100 ditë janë të mjaftueshme për ta parë kursin të cilin e ndjek Qeveria për ata parë kulturën e punës, të cilën e sjell një Qeveri dhe për ta parë ritmin e punës të cilin e sjell një Qeveri.

Dhe unë po provoj t' i shpjegoj ato që ne i shohim, qoftë për kursin, qoftë për kulturën e punës, qoftë për ritmin të cilin e ka sjell Qeveria e cila aktualisht është në zyre.

Kursi është kursi i rritjes së taksave dhe kursi i akumulimit sa më të madh të mjeteve për t' i mbushur vrimat që i kanë shkaktuar si deficit si pjesë e kursit. Është bankroti të cilin po e shohim tani, e gjithë bota po na thotë se jemi duke shkua drejtë bankrotit. Është skamja, edhe pse janë rritur rrogat, rritja e çmimeve që e ka shkaktuar po kjo rritje e rrogave ka bërë që njerëzit sot me të ardhurat e veta të blejnë shumë më pak se që kanë blerë, shembull ta marrim para 3 vjetëve dhe kjo në esencë drejtpërdrejtë ndikon në rritjen e varfërisë, në rritjen e skamjes.

Një letër tjerë që vjen prej së jashtmi thotë kështu: Në fund të vitit 2007, pak para se ta marrë kjo Qeveri pushtetin, rezervat në Kosovë kanë qenë mbi 7% GDP, ndërsa sot janë minus 2.6% të GDP-së dhe pyetja që e bëjnë institucionet ndërkombëtare për Qeverinë drejtpërdrejt zoti ministër është ku i keni lënë parat, çka keni bërë me ato para, i keni këto pyetje i keni marrë? Kursi, është izolimi, shihni se kush del prej Kosovës jashtë, shihni se çka po ndodhë me Kosovën, shihni çka po ndodhë me liberalizim të vizave. Thuhet në do letra se Kosova ka shkuar prej gjendjes së keqe, në gjendje të rrezikshme fiskale, që do të thotë edhe kjo është pjesë e kursit. Kurs tjetër është autostrada Vërmicë – Arllatë, do të thotë është ndërruar kursi i autostradës dhe në vend se të shkojë ku ka qenë dashur të shkojë ku ka qenë dashur të shkojë qysh ka votuar Kuvendi, është ndërrua traseja me vendim të Qeverisë që është vendim i paligjshëm, do të thotë, kursi është vendime të paligjshme të Qeverisë. Punët e pakryera, asnjë prej rrugëve të mëdha nuk është kryer krejt, dil e shihni rrugën deri në aeroport, shini rrugën deri në Pejë, shihni deri në Mitrovicë, shihni nëse ndonjë rrugë është përfunduar, rrugët që kanë nisur para 4 vjetëve.

Kultura e punës është kulturë e premtimeve që nuk mbahen, a ju kujtohet kur e ka nënshkrua marrëveshjen me pensionistë kryeministri, pyetni pensionistët a e ka mbajtur premtimin? Shihni pagat retroaktive, këqyrni rritjen prej 6% shihni tjera, është kamuflim i punës, kamuflim i vazhdueshëm, është korrupsion. Ne nëse e pyesim Qeverinë pse po kushton Abetarja 15 euro, këta përgjigjen pse jeni ju kundër Abetares? Kjo është kultura, domethënë kjo është e punës që e sjell Qeveria. Nëse ne i themi pse po e shitni PTK-në 300 milionë këta thonë, ju jeni të majtë se s'po doni ta shitni PTK-në. Kjo është kultura që e ka sjell Qeveria.

Marrëveshjen me FMN-n e kanë thyer edhe kjo thyerje e marrëveshjeve në shtator të vitit të kaluar e kanë nënshkruar vetë se s'e kanë ditur që kanë zgjedhje, në momentin që janë shpallur zgjedhjet iu kanë bërë premtim njerëzve për ta blerë votën, iu kanë premtuar

se kanë për t'ua rritur pagat e kanë thyë marrëveshjen dhe i kanë humbur 156 milionë euro për ta varfëruar Kosovën.

Rritmi, s'ka rritëm, kjo Qeveri nuk ka rritëm se hala nuk i ka emëruar as zëvendësministrat, domethënë nuk ka mëri për 100 ditë ta plotësojë Kabinetin e vet, nuk vlen për Ibrahim Makollin, ky 100 ditësh, tjerët nuk kanë mbërri t' i plotësojnë kabinetet për 100 ditë, domethënë 100 ditë punë asnjë gjë tjetër nuk është bërë edhe mund të them që prej këtu duhet t' i themi kryeministrit të Kosovës, nëse e do vendin vetëm pak, vetëm pak, mblidhi shokët edhe lësho rrugë, jep dorëheqje, tërhiq, se Kosova po shkon drejtë katastrofës. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Do të flas për situatën aktuale në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, ku pak ditë më parë, në Preshevë, u arrestua Belgzim Kamberi, e që është kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut për këto tri komuna. U mbajt për disa orë me radhë në stacionin policor të Preshevës dhe u mor në pyetje nga policia serbe. Pritet të ngrihet padi dhe Belgzimit i kërcënohet edhe burgosja.

Si pretekst për arrestimin e Belgzimit, u mor demonstrata paqësore e 10 dhjetorit 2010, e mbajtur në Preshevë, e që u bë kundër mosnjohjes së diplomave të Universitetit të Prishtinës, si njëra nga mjetet në politikën diskriminuese të shtetit serb mbi shqiptarët, politikë kjo që po rezulton dita-ditës me shpërngulje masive të shqiptarëve nga vatrat e tyre dhe më zbrazjen e këtyre tri komunave të banuara më shumicë shqiptare dhe që vazhdojnë të jenë nën pushtimin serb.

Demonstrata godiste qartë, ishte pra kundër “dëbimit të trurit”, siç edhe u quajt nga organizatorët, kundërshtonte përjashtimit nga e drejta e punësimit të shqiptarëve që kanë mbaruar studimet në Prishtinë, e të cilët detyrimisht janë të detyruar të braktisin vendin. Kjo demonstratë ishte ndër më masovikët në Preshevë, dhe si e tillë, paraqet problem për Serbinë, por edhe për atë pjesë të diplomacisë që këto tri komuna i do me çdo kusht të jenë të qeta, të qeta dhe të duruara derisa të zbrazen plotësisht dhe qetësia në këtë pjesë të territori të jetë akt i kryer.

Dhe, ajo që e prishi qetësinë, demonstrata pra, duhet goditur nga pushteti që të mos përsëritet dhe preteksti u gjet.

Sipas fletarrestit të lëshuar, Belgzimi akuzohet për fyerje të ministrit serb të Pushtetit Lokal.

Banaliteti që normalisht nuk i ndodh askujt tjetër, pos jetimit apo në këtë rast të braktisurit, të braktisurit nga Prishtina, Tirana, e edhe Brukseli.

Nga ana tjetër po zhvillohen negociatat, dhe tani jemi në momentin kur po flitet se si do të ndahet, se si nuk do të ndahet Kosova, edhe pse Serbia ka filluar ta kërkojë këtë, se si jemi të vendosur të mos japim territor etj. Pra, po vazhdon te flitet dhe si gjithmonë vetëm për Kosovën, pasi si temë e vetme për këtë është Kosova, por jo edhe Serbia. Kjo është edhe një ndër pikat e shumta që Lëvizja “Vetëvendosje” i kundërshtoi këto negociata. Ata po vazhdojnë të kërkojnë e ne po mburremi që po u japim vetëm pak, larg prej asaj që po kërkojnë.

Serbia edhe përkundër faktit që gjendet të një proces të favorshëm negociimi për veten e saj, pasi ky proces negociimi po ia mundëson futjen në BE, me ndihmën tonë, të Kosovës, të shqiptarëve, pra që janë njësoj me ata të Preshevës, ajo vazhdon me politikën e saj të terrorit dhe dëbimit të shqiptarëve, vazhdon dhe me këtë jep mesazh të qartë se nuk ka ndryshuar

aspak, është po ajo Serbi, si çdo herë edhe pse ne vazhdojmë të japim mesazhe relaksimi, natyrisht brenda agjendës të tyre të veprimit.

Të nderuar pushtetarë, derisa po vazhdoni negociatat, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci po zbrazen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

I fundit është deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në seancën e 19 majit e kam ngritur çështjen për nevojën e përsheptimit të Ligjit për vlerat e luftës, më 19 maj në këtë foltore kam thënë se asnjëri nga ne nuk do ta ndijë veten mirë, derisa ky ligj të mos aprovohet nga Parlamenti i Kosovës. Besoj që asnjëri nga ne derisa ka kaluar nga tenda e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk e ka ndie veten mirë.

Unë edhe para se veteranët të vendosin tendën kam kërkuar përsheptimin për aprovimin e Ligjit për vlerat e luftës. Mbështes kërkesën për Ligjin për vlerat e luftës edhe të këtyre veteranëve që janë këtu, por edhe të shoqatave të cilët kanë punuar në hartimin e këtij ligji bashkërisht me Qeverinë dhe Parlamentin e Kosovës.

Pos diskutimit tim në këtë foltore jam interesuar pas diskutimit tim, jam interesuar që për ligjin ku është ai, ku ka mbetur dhe ku është çështja e ligjit? Ligji edhe në legjislaturën e kaluar ka qenë i përpunuar dhe për shkak të shpërndarjes së Parlamentit ka mbetur i paaprovuar. Ligji është në draftin final dhe do të vijë këtu në parlament dhe besoj që shumë shpejtë në procedurë të rregullt ai ligj do të aprovohet, prandaj, është tejet e panevojshme politizimi i këtij ligji apo tendenca e dikujt për të marrë merita për aprovimin e këtij ligji, për arsye se të gjithë ne deputetët do ta kem mundësi ta votojmë këtë ligj dhe meritat do t'i takojnë atyre që punuan në ligj, realisht nuk ka nevojë as që të merren merita për këtë se është një nevojë e kamotshme për rregullimin e kësaj çështje të vlerave të luftës me ligj.

Prandaj, pasi është ligji në procedurë dhe mendoj, i nderuari kryesues, që do të ishte mirë që Këshillin organizues të këtyre protestuesve, ta pritni ju në zyre dhe të përfundojë çështja e veteranëve të cilët janë duke qëndruar në grevë, në tendë dhe është e panevojshme mendoj qëndrimi i mëtutjeshëm i tyre pasi që ligji është në aprovim dhe nuk ka nevojë absolutikisht që të krijohet përshtypje që ky ligj gjoja se do të vijë këtu në Parlament nën presionin e dikujt apo me presion, për shkak që është punua një kohë të gjatë edhe nga shoqatat e dala nga lufta edhe nga të gjithë ata të cilët kanë qenë të kyçur rreth ligjit. Prandaj, edhe ky ligj si të gjitha ligjet tjera të vijë në procedurë të rregullt në Parlament dhe të aprovohet.

Mbështes kërkesën thashë të veteranëve dhe duke falënderuar të gjithë edhe ata që punuan në ligj, mendoj që edhe efektin e vetë edhe veteranët të cilët qëndruan në tendë e kanë dhënë për shkak se kanë sensibilizuar edhe më tepër çështjen e Ligjit për vlerat e luftës si nevojë e domosdoshme. Prandaj, duke pasur parasysh nevojën që ndoshta të pritët nga kryesuesi i Parlamentit, Këshilli organizativ edhe të përfundojë çështja e qëndrimit të tyre në tendë dhe kjo çështje pasi është në procedurë të rregullt do të vijë në Parlament, të votohet dhe nuk ka nevojë absolutisht që të krijohen përshtypje se ky ligj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

Koha ka përfunduar.

Dua t'i informoj deputetët të paraqitur pas gjysmës së kohës së diskutimeve që nuk do ta kenë fjalën të parët në seancën e ardhshme, sepse praktika e rezervimit të fjalës në fund të pikës, nuk është e rregullt. Prandaj, nuk do të jenë në seancën e ardhshme të parët, po le të paraqiten sipas kohës së caktuar në fillim të pikës së rendit të ditës.

Fjalën e ka kërkuar në emër të Qeverisë, ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMAZA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar të pranishëm,

Jo me qëllim që polimizojmë apo të replikojmë, po u ngritën disa çështje që kanë të bëjnë me sferën e financave dhe unë konsideroj që donë përgjigje.

U tha se brenda këtij 100 ditësh janë ngritur taksat, nuk është ngritur norma e tatimit në fitim të korporatave, nuk është ngritur norma e TVSH-së, nuk është ngritur norma e tatimit në të ardhurat individuale.

U tha se në fund të vitit 2007 ka qenë bilanci bankar 7% në raport me GDP, nuk është gjendje e mirë kjo. Kjo tregon mungesën e kapaciteteve për ekzekutimin e buxhetit. U tha se në vitin 2010 kemi kaluar në deficit që ky deficit ekzakt është 2.6% edhe është brenda parametrave të Bashkimit Evropian, mirëpo duhet të kemi të qartë se në fund të vitit

2010, kemi pasur edhe bilancin bankar prej 244 milionë, dhe dua t'ju informoj se Kosova është në pozitën më të mirë sa i përket ngarkueshmërisë me borxhin publik në raporton me GDP. Nuk duam të themi se Kosova është në gjendje të mirë ekonomike, e dimë normë e papunësisë, e dimë që kemi probleme ma varfërinë, e dimë që kemi probleme edhe me deficitin e lartë tregtar.

Gjithashtu u përmend çështja e rritjes ekonomike, unë po i referona raporteve të institucioneve financiare ndërkombëtare mjaftë kredibile, që edhe FMN-ja e jep vlerësimin që për vitin 2011, Kosova planifikon që të ketë rritje ekonomike prej 5.5%.

U përmend çështja e inflacionit, ne kemi vlerësuar inflacionin, ky është një vlerësim i cili planifikohet se të jetë mbi 5% sa i përket vitit 2011. Mirëpo, inflacioni normalisht që e varfëron standardin e qytetarëve, por nuk mund ta amortizon rritjen e pagave.

Dhe krejt në fund u përmend edhe çështja e marrëveshjes me FMN-në. Ne kemi arritur një marrëveshje me FMN-n, nuk po e devijojë prej asaj që është, është edhe quhet marrëveshje e monitoruar nga stafi, që është një marrëveshje qift deri në fund të vitit 2011, do t'i ketë dy vlerësime. Vlerësimin e parë pritet që të ndodhë në vjeshtën e këtij viti, nëse vlerësimi është pozitiv, Banka Botërore mund t'i derdhë mjetet në buxhetin e Kosovës të premtuar për këtë vit. Dhe nëse vlerësimi i dytë që pritet të ndodhë në fillim të vitit të ardhshëm është pozitiv, hapet rruga për një marrëveshje të re. Kur jemi te fondet, nga Fondi Monetarë Ndërkombëtar duhet të shpjegoj se këto nuk janë donacione janë kredi, janë kredi të cilët qytetarët e Kosovës janë të obliguar t'i kthejnë, kemi të paguajmë kamata për këto dhe gjithmonë duke ditë se respektimi i këtyre marrëveshjeve është i mundshëm, nuk është i lehtë, nëse respektohen marrëveshjet Kosova do të ketë qasje në këto fonde në vitin 2012. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në këtë pikë s'ka replikë, jemi marr veshë. Nuk e di. Okej, Ardian, unë po të toleroj, por me Rregullore në këtë pikë të rendit të ditës nuk ka. Merre fjalën, s'ka problem.

ARDIAN GJINI. Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ministri iu referua fjalës sime gjatë gjithë kohës dhe kjo është arsyeja pse po lypj replikë. Unë fola për kulturën, edhe ministri ekzakt e vërtetoj krejt atë që thashë unë, nisi të shesë mjegull tash kur kanë ikur 145 milionë euro, ky po na thotë që ato kanë qenë të këqija se ishin kredi, edhe mirë që s'na kanë dhënë. Ministër, kjo është kultura e punës, po të lutna, nëse e do Kosovën pak ti edhe krejt shokët e tuaj, jepni dorëheqje lëshoni rrugë. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare,

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund të parashetrojë më së shumti 2 pyetje.

Pyetjen e parë është për ministren Vlora Çitaku, që nuk është këtu, e bërë nga deputeti Xhevdet Neziraj. Deputet, a dëshironi ta bëni pyetjen? Veç po dua ta sqaroj në qoftë se ju jeni dakord, ju ja keni adresuar ministres Vlora Çitaku, pyetjen, zoti Bajram Rexhepi është kompetent për pyetjen që e keni bërë dhe është e fushës së tij, në qoftë se ju jeni dakord mund t'ua japë përgjigje ministri, në qoftë se jo, atëherë mund ta lexoni pyetjen dhe mund ta presim ministren prapë. Deputetit Neziraj, fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Jo unë dua ta marrë një përgjigje dhe a do ta japë përgjigjen Vlora Çitaku apo Bajram Rexhepi, për mua është njëjtë.

KRYESUESI: Atëherë, lexoje pyetjen, deputet!

XHEVDET NEZIRAJ: Pyetja, mendova se veç është i përgatitur atëherë po ia përkujtoj pyetjen, se pyetja ka të bëjë me persona e ri-integruar në Kosovë që po vijnë nga vendet perëndimore, do të thotë Qeveria e Kosovës ka nënshkruar disa marrëveshje me vendet e Evropës Perëndimore, më duket që janë 9 marrëveshje dhe ka filluar edhe para këtyre viteve që njerëzit të kthehen nga vendet e Evropës Perëndimore dhe deri më sot Qeveria e Kosovës nuk ka financuar në ata njerëz, në projekte, në ndërtim dhe rindërtim apo diçka tjetër. Dua t'i them ministrit të Rendit se që nga viti 2005 ku nënshkrimin e parë ka bërë zoti Shtajner me ministrin e Punëve të Brendshme të Gjermanisë, ka filluar kthimi dhe ata qytetarë nuk janë ndihmuar as nga Qeveria lokale dhe as nga Qeveria qendrore dhe shpresoj që këtë vit do të ketë një numër shumë më të madh të kthyerve dhe do të shohim se çfarë plane dhe çfarë projekte ka Qeveria në ri-integrimin e këtyre personave, sepse e di se shumë me rëndësi është se kemi të bëjmë me liberalizimin e vizave e një prej këtyre kushteve është edhe riatdhësimi i qytetarëve me origjinë nga Kosova dhe në këtë drejtim më së tepërmi është duk pësuar komuniteti shumicë por edhe komuniteti egjiptas se ka një numër më të madh të kthyerve për shkak që mund të integrohet më lehtë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

Unë pyetjen e dita, por ju e dini më mirë Rregulloren që megjithatë lexohet, prandaj desha vetëm t'ua përkujtoj që e keni obligim ta lexoni.

Natyrisht që pyetja e koncipuar se sa ka kapacitete Kosova të bëjë akomodimin e njerëzve që na kthehen, të cilët nuk e kanë të rregulluar statusin legal në vende të ndryshme, është një obligim për Kosovën, na obligojnë edhe marrëveshjet e nënshkruara, deri tash t'ju them janë nënshkruar 12 marrëveshje dhe deri në fund të vitit do të nënshkruhen afër 20 marrëveshje që në këtë drejtim të plotësohen kushtet. Dhe, kërkesa më e madhe nga shtete e caktuara është respektimi i kësaj marrëveshje, ripranimi i qytetarëve dhe ri-integrimi i tyre në vendin tonë, në komunat prej nga vijnë, se çfarë kapacitete kemi ne mund të themi se kushtet janë relative. Në bazë të obligimeve që kemi si nga niveli qendror, si niveli komunal, ne duhet të krijojmë kushte të barabarta si për të

gjithë qytetarët tjerë. As nuk do të jenë të diskriminuar, po as të privilegjuar. Ata ku kanë mundësi të kthehen në shtëpitë e tyre do të kthehen në shtëpitë e tyre, ata që s'kanë banim, komunat janë të obliguara të krijojnë kushte të banimit social ose forma tjera, ndërsa Qeveria e Kosovës ka ndarë 3 milionë e 470 mijë euro për këtë vit për ri-integrimin e tyre që nënkupton jo vetëm akomodimin, por edhe qasje në shërbime shëndetësore, sistemin e edukimit dhe nevoja tjera, ndërsa Ministria e Brendshme e ka për obligim t'i pajisë me dokumente personale edhe gjendjes civile. Pra, ne e dimë se është një ngarkesë për shtetin tonë, por në mënyrë që të kemi një perspektivë për liberalizim të vizave është obligim yni që të kryejmë këto obligime dhe të pretendojmë të jemi shtet serioz i cili ato që i nënshkruan edhe i respekton.

Prandaj, kemi mirëkuptim edhe nga shtetet të cilat i kthejnë këta qytetarë, e dinë që nuk kemi kapacitete të mëdha që flukse të mëdha t'i akomodojnë. Prandaj, shkohet në grupe të vogla në mirëkuptim të dyanshëm që parashihen edhe këto marrëveshje për ripranim. Prandaj, edhe një herë them i rrok të gjitha komunitetet, në disa shtete ka më shumë, në disa më pak dhe është obligim i ynë shtetëror të gjejmë fonde, por kemi premtime edhe nga shtete të caktuara që do të ndihmojnë me fonde në mënyrë që ky ri-integrim të jetë sa më dinjitoz për ata që kthehen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë, zoti Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

Jo unë e kam një listë këtu nga komuna e Pejës ku janë mbi 150 persona që gjatë këtyre viteve që janë kthyer dhe me përgjegjësi të plotë ata njerëz nuk kanë marrë asnjë centë as nga qeveria lokale dhe as nga ajo qendrore UNCHR i trajton jo si refugjatë, por as të kthyer, por një farë forme të riatdhesuar dhe nuk ka obligim të ndihmojë, zyrat lokale të komuniteteve jo vetëm që s'kanë kapacitete, po s'kanë edhe buxhet që të ju ndihmojnë, për arsye se zyrat lokale kanë vetëm për paga dhe mëditje, dhe shërbime e letra diçka tjetër nuk kanë, ndërsa Qeveria vetëm sivjet ka nda 3 milionë e 400 mijë. Ndërsa më herët ka ndodhur se njerëzit të cilët kanë ardhur nga diaspora ose s'kanë banuar nëpër hotele dhe është me shifra edhe në media ka qenë që njerëzit gjoja kanë banuar nëpër hotele dhe ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Janë dy kategori të kthyerve, disa që kthehen në baza vullnetare me mirëkuptim, ata nganjëherë marrin edhe disa mjete nga shtetet të cilat i deportojnë dhe është grupi tjetër që ju imponohet kthimi. Unë e di që në Zyrën për Komunitete dhe Kthim nuk kanë buxhet dhe mund të them se ajo është kërriga më e dobët në këtë zinxhir të riintegritit dhe do të forcohen ato zyra me njerëz që e dinë procesin, mirëpo tash në këtë fondin prej 3 milionë e 470 mijë euro, i paraqesin

projektet, kërkesat komunat e caktuara dhe në bazë të atyre kërkesave vlerësohen dhe u lirohen fondet për akomodimin e tyre. Prandaj ky është kjo mekanizëm.

Ndërsa, çështja e kthimit ka qenë edhe në kohën e UNMIK-ut, janë kthyer në forma të ndryshme, mos me marrë kohë, por tash këto mundësi janë dhe ato zyre të komuniteteve, komunat duhet të aplikojnë në këtë fond të riintegrim që quhet dhe në bazë të projektit të marrin mjetet dhe t'i akomodojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Agim Kuleta, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen.

Zoti Kuleta, fjalën.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke qenë se kryeministri vazhdimisht është shumë i rregullt në mungesa, unë do të dëshiroja t'ia adresoja pyetjen ndoshta ministri Beqaj është përgjegjëse për këtë çështje.

Çështja, është përdorimi i prefikseve telefonike të huaja në Kosovë, do të thotë është një çështje që përmban, si komponentin politike, po ashtu edhe ekonomike edhe financiare. Edhe këtë çështje do ta adresoja përmes dy pyetjeve parlamentare. Pse, dhe pas 12 vjetëve prej largimit të Serbisë dhe 3 vjetëve pas shpalljes së pavarësisë, Kosova vazhdon ta përdorë kodin telefonik të Serbisë, kur dihen shumë mirë opstrukcionet e vazhdueshme që Serbia i bënë ndaj Kosovës, si në planin ekonomikë përmes bllokadave tregtarëve të ndryshëm ashtu edhe në atë politikë si brenda dhe jashtë vendit. Kaq pyetja e parë.

KRYESUESI: Zoti Beqaj, e ka fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar deputet Kuleta,

Ju e dini që çështja e kodit telefonik është çështje që lidhet drejtpërdrejtë me anëtarësimin e shtetit në Kombet e Bashkuara, si parakusht për të marrë kodin e vetë telefonik. Në ndërkohë, proceset të cilat janë duke u zhvilluar është që ka komunikime të rregullta me organet ndërkombëtare të cilat janë përgjegjëse për lejimin e një përdorimi të një kodi të tillë dhe në këtë drejtim janë duke u bërë punë jashtëzakonisht profesionale të cilat do të sigurojnë që në një të ardhme të afërt do të thotë të mundësohet dhe të komunikohet me ta në mënyrë të drejtpërdrejtë, por kjo lidhet edhe me futjen e shtetit në Kombet e Bashkuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zoti Kuleta?

AGIM KULETA: Është e qartë e kjo edhe është korrekte kjo që thotë ministri, sepse duhet të jesh anëtare e OKB-së ose të paktën duhet të votohesh nga gjithë anëtarët që janë pjesë e ITU-s. Mirëpo, ekziston zgjidhja për këtë problem, unë konsideroj që përdorimi i prefiksit të Republikës së Shqipërisë do të ishte shumë më i leverdishëm ekonomikisht dhe shumë më i përshtatshëm politikisht.

Unë këtë rast do të ta ndërlidhja edhe pyetjen e dytë, sepse këtu përdoren edhe dy kode të tjera, do të thotë ajo e Monakos dhe i Sllovenisë. Ekziston gjithashtu një klauzolë e cila pengon përdorimin e një kodi të huaj telefonik, mirëpo në rastin e Kosovës këtu ekziston precedencë, do të thotë tri kode të huaja përdoren, nuk përdoret vetëm ai i Republikës së Shqipërisë, në kohën ku ai gjithsesi është më i lavdishëm dhe politikisht më i përshtatshëm. Faleminderit! Do t'u jap sqarime lidhur me këtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj.

BESIM BEQAJ: Sigurisht se raportet bilaterale të cilat ndërtohen në mes të shteteve janë çështje edhe komerciale edhe çështje të cilat lidhen edhe me politikë. Ne kemi një vendim i cili është marrë shumë më herët, është marrë në bazë të një procesi konkurrues dhe të leverdisë ekonomike, prandaj, në këtë kontest është marrë një vendim i tillë, nuk kisha dashur që të përziejme këtu aspektin e futjes së Shqipërisë apo të ndonjë shteti tjetër, sepse nuk kemi të bëjmë këtu vetëm me çështje patriotike, por kemi të bëjmë me çështje komerciale dhe në atë kohë është diskutuar në mënyrë shumë të hapur dhe ka qenë një proces konkurse për një kod të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

E ke bërë pyetjen, u krye.

E pate, jo, jo s'ke të drejtë.

Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Nenad Rashić. Deputet e ke fjalën.

Deputeti Afrim Kasolli. Regjia deputetit Afrim Kasolli, mikrofonin. A e ke shtypur zoti Kasolli?

AFRIM KASOLLI: Në bazë të Ligjit të punës në Kosovë, orari i plotë i punës zgjatë 40 orë në javë. Neni 23, paragrafi 1, i Ligjit të punës thotë se në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punëve dhe në raste të tjera të domosdoshme, me kërkesën e punëdhënësit, punëtori duhet të punojë më gjatë se orari i punës, puna jashtë orarit, por më së shumti deri në 8 orë në javë.

Një punëtor krahu, ministër, në firmën Bechtel&Enka punon minimum 10 orë në ditë apo 70 ditë në javë dhe paguhet vetëm 70 centë për orë ore dhe ka pushim një herë në dy javë ose dy ditë brenda muajit. Po ashtu, punëtorët e ndërmarrjes "Biatext" sh.p.k. kanë refuzuar para dy javësh kontratat e ofruara nga punëdhënësi për shkak të pakënaqësisë së tyre me orarin e punës, dhe po ashtu me mos pagesën e punës gjatë ditëve të festës.

Pyetja parlamentare për ministrin për ministrin është: Kush e mbikëqyr zbatimin e Ligjit 03-L-212 të punës dhe çfarë masash sanksionuese kemi ndërmarrë në rastet e identifikuara të shkeljes së tij?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsedavajući,

Kolege ministri,
Narodni poslanici,

Na početku bi hteo samo da vas podesim da Bechtel & Enka, firma koja je od prošle godine, krajem prošle godine bila započela aktivnost svoje na izgradnji puta, u to vreme nije bio još na snazi Zakon o radu, pa su oni došli sa jednim predlogom kako da nađemo zajedničko rešenje. I tada je bilo naglašeno da svi radnici koji budu radili po normama predviđenim zakonskim, znači ne više od 40 sati nedeljno, mogu na vulnetarnoj bazi, znači dobrovoljno odnosno u saglasnosti sa kompanijom „Bechtel & Enka da imaju dogovor o naknadnom radu, znači za punë shtesë, koji će oni direktno sa svojom firmom, odnosno sa Bechtel & Enka da potpišu. Prema tome, to je jedan dogovor koji postoji još pre utvrđivanja samog Zakona o radu, znači svaki god deo potpisivanje ugovora, pogotovo o naknadnom radu je dogovoren između poslodavca i posloprimaoca.

A što se tiče samog utvrđivanja nadležnosti i poštovanja zakonskih procedura, Inspektorijat za rad pri Ministarstvu za rad i socijalno staranje ima obavezu kontrole, nadgledanja i sprovođenja ovog zakona, tako da po članu Zakona o radu o3/L-212, pod zakonskim aktom 94. sprovođenje i nadležnosti zakonske i podzakonske regulative na polju rada, u ovom slučaju sa Bechtel & Enkom sprovodi Inspektorijat za rad.

Što se tiče najdirektnijih inspekcija koje je Inspektorijat za rad uradio u firmi Bechtel & Enka, prva je urađeno 16.02. 2011. godine, u kome je bilo povrede na radu i povređeni radnik, ime njegovo je Jakup Sadiku, koji je imao lakše povrede. Drugog puta se desilo 30.03. 2011. godine, takođe u slučaju lakše povrede na radu. Treća inspekcija je bila 08.04.2011. godine, takođe je u istom slučaju jedan radnik lakše povređen, radnik se zvao Itmir Mazreku. Zatim 11.05.2011 je takođe još jedna inspekcija bila, u kome je povređen radnik Nadir Gashi...

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, por nuk është në rregull, zoti ministër, ose përgatituni për t'u përgjigjur, ose nuk ka nevojë të na i numëroni emrat e të gjithë të plagosurve.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Uglavnom jedan generalni izveštaj koji je urađen u vezi poslovanja Bektel & Enka je da je ukupno zaposleno 2750 radnika, da su 850 od njih strani zaposleni radnici, da su 1900 sa Kosova, da od tog imamo 72 žene, od toga 68 je radnika sa Kosova. Inače, ustanovljeno je da su svi radnici iznad 18. godina starosti i da nema nikakvih segmenata diskriminacije. Prema tome, mislim da ovim što jedna informisanost da smo mi bili sve vreme prisutni od kad funkcioniše Bechtele & Enka pokazuje da jesmo radili svoj posao.

Pored toga, zaboravio sam da kažem da je minimalna plata koja je utvrđena 270 evra u samoj kompaniji. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë, deputet?

AFRIM KASOLLI: E para, është dëshpëruese mënyra kur i dhatë këto informata, do të thotë ju keni informata se bëhet shkelje e të drejtave të punëtorëve aty dhe përsëri nuk keni guxim ose ashtu jeni të kushtëzuar të mos ndërmerrni asgjë për t'i mbrojtur të drejtat e punëtorëve.

Kontratat aty, obligimet, do të thotë, nuk janë në mënyrë vullnetare, por ata punëtorë janë të detyruar të punojnë jashtë Ligjit të punës, e para, ministër. E dyta, ju treguat shumë qartë se keni vendosur të mos respektoni atë që e keni nënshkruar, sikurse është Ligji i punës, por te respektoni atë që nuk e keni nënshkruar sikurse është ... apo marrëveshja multilaterale për investime, ku kompanitë multinacionale nuk iu nënshtrohen ligjeve vendore dhe, do të thotë, janë bartës të një eksploatimi të pakufi, çfarë janë duke e bërë këto kompani dhe që ju nuk keni guxim për të intervenuar dhe për ta ndalur këtë veprim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër!

MINISTRI: NENAD RAŠIĆ: Ja mislim da u ovom slučaju nemate bazu da kažete tako nešto zbog toga što, pored toga što smo ove mere preduzimali u samom smislu Bechtel & Enka, pored toga mi smo napravili stalne redovne sastanke sa predstavnicima sindikata, ponavljam, koji se održavaju, ja mislim svakih 15 dana sa predstavnicima Inspektorata za rad, u kome ispitujemo svaki slučaj, i to neće biti samo ono što se do sada desilo, i od sada ćemo ispitivati svaki slučaj eventualnog kršenja prava radnika.

Prema tome, od samog sindikalnog organizovanja, preko same komunikacije, preko Inspektorata za rad, mi ćemo uvek raditi na tome da se zakon poštuje doslovno. A još jednom ponavljam da u konkretnom slučaju Bechtel & Enka, ja znam, ja sam se video dva puta sa generalnim menadžerom baš u svrhu zaštite interesa radnika i oni su uvek potencirali da nijedno pravo radnika neće biti kršeno. Nama je to potvrđeno kroz izveštaj Inspektorata za rad. Ako bude bilo potrebno, mogu da vam dostavim to i u pismenoj formi, a možete da imate sastanak i sa predstavnicima Inspektorata! Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Danush Ademi, pyetje për ministrin Rashiq.

DANUSH ADEMI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Këtë pyetje e kam parashtruar edhe në seancën e radhës, por ministri nuk ka qenë këtu, sigurisht ka qenë në udhëtim zyrtar. Dua të njoftoj që me datën 20.05.2011, në ndërtesën kolektive në kampin e Plemetinit, komuna e Obiliqit, 38 familje të komunitetit Ashkali, Romë dhe Egjiptas kanë lëshuar ndërtesën për shkaqe të sigurisë, pasi që ndërtesa nuk i plotëson kushtet për banim dhe është afër rrënimit, por deri më tani askush nga organet komunale dhe qeveritare nuk u ka bërë asnjë vizitë këtyre familjeve dhe nuk është marrë asnjë hap për t'ju dalë në ndihmë këtyre familjeve. Prandaj, pyetja për ju, zoti ministër është: Këto 38 familje, a keni ndërmarrë ndonjë hap konkret për këto familje që t'i strehoni diku apo t'iu siguron kulm mbi kokë, apo t'i leni në mëshirën e Zotit dhe nën qiellin e hapur njerëzit e sëmurë, fëmijët e vegjël dhe njerëzit e varfër?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ministër Rashiq, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovani poslanice,

Pre svega, ja sam to dobio više nezvaničnih informacija da se to desilo, zbog toga što sa lokalnog nivoa, odnosno iz opštine Obilić nismo dobili nikakvo zvanično obaveštenje u kome se traži bilo kakva asistencija naša ili bilo kakva intervencija. To je prvo stvar.

Kao drugo, ja moram da kažem, koliko sam saznao, postoji jedan dokumenat koji su sami stanovnici te zgrade pripremili, jer je to jedna peticija i u kojoj se kaže da bi vrednost popravke bio negde iznad 70.000 evra. Ja mogu da kažem da budžet sam, organizacija budžeta nije predviđeno u kome možete u nekom sektoru da imate višak, baš u tom sektoru za popravku zgrada pa možete investirati u to, a na kraju vrlo je bitno znati da sama ta, da kažem samozapaljivanje zgrade je vrlo diskutabilno. Da vas informišem da sam još pre dve godine, dva puta tamo intervenisao u smislu popravke kanizacionog sistema i onog organizacije ispred zgrade, pošto je bilo strašnom neredu, ali čak je ispalo kontra produktivno da su sami meštani, stanari uspeli da sutra dan, sve ono što je napravljeno da sa nekom tendencijom pokvare. Nama zvanično treba, to da ostavimo po strani, nama zvanično treba zahtev od opštine Obilić, u kome će biti precizirano neko koofinansiranje, u kojima mi možemo da asistiramo do ne negde. Ja mogu kao i uvek što vam kažem, mogu da vas pozovem na saradnju, na jedan dodatni sastanak u kome možemo da razgovaramo o mogućnostima, ali stvarno mi sami da iznesemo taj teret, u ovom momentu ne možemo. Ali, ukoliko ste zainteresovani, hajde da nađemo neku mogućnost za podršku.

Pre svega, zvanični zahtev, zvanična inicijativa od strane opštine pošto, ponavljam još jednom, socijalna asistencija ili bilo koji vid socijalne podrške stanovništvu je decentralizovan. To ide više na teret, da kažem, ili pod odgovornost opština, nego što ide pod odgovornost ministarstva, ali opet kao znak dobre volje, mi ćemo biti uključeni u taj proces. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë?

DANUSH ADEMI: Bash po më bren rasti që po thotë ministri se nuk është përgjegjësi e Ministrisë kjo, e ka përgjegjësinë kuvendi komunal. Nuk e di a është përgjegjësi për ministrin, sepse 38 familje janë jashtë prej dt. 20.05.2011 dhe thotë që e ka kuvendi komunal. Ne e dimë që kuvendi komunal nuk ka mundësi që ta bëjë rindërtimin e shtëpive për ato familje, sepse buxhetin e ka shumë të vogël. Ju, zoti ministër, duhet të merrni hapa konkret për këto 38 familje, sepse janë nga komuniteti Ashkali, Romë dhe Egjiptas dhe prej fillimit ajo ndërtesë kurrë nuk i ka plotësuar kushtet për banim. Aty ka munguar edhe uji, edhe kanalizimi, edhe rryma, edhe ndërtimi dhe tash ata për këtë janë detyruar të lëshojnë shtëpitë dhe të dalin nën qiellin e hapur dhe kërkesa e jonë dhe, sigurisht, edhe e juaja do të jetë që ato familje sa më shpejtë t'i strehoni diku, e jo t'i leni nën qellin e hapur.

Me vet faktin, sepse këto komunitete sikur të ishin nga komuniteti serb, besoj që shumë shpejtë do t'i kishit gjetur fondet për të rindërtuar shtëpitë për këto familje.

KRYESUESI: Ministrit fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Pre svega, svi koji znaju način mog rada, znaju da nikada ne odvajam ljude po nacionalnosti. Baš se trudim da budem što više fer da mogu svima da ispunim te zahteve koje postoje. A vi znate i sami da, tačno je da Aškalijska i Romska zajednice žive u jednoj specifičnoj situaciji zbog možda neadekvatnog nivoa razumevanja te same situacije. I ja sam rekao, nisam rekao da opština Obilić ima kapacitete da sama reši, nego sam rekao sam da pokrene inicijativu, što je razlika od toga što kažete vi. Prema tome, ja još jednom ponavljam, znači u specifičnost te situacije, te zgrade tamo, da ukoliko se desi neko pokrene inicijativu, a ja ponavljam, to je bilo, do paljenja je došlo 31.12, baš na novogodišnju noć, i od tada to je skoro 6 meseci, ništa nisam video, nijedan zvaničan dokumenat u kome se traži nešto od mene, osim peticije stanovnika zgrade. Prema tome, neka iskrena odgovornost mora da postoji i od strane opštine, a mi jesmo tu da podržimo, u načinu koliko možemo, ali opština treba da bude ta koja pokreće. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Afërdita Berisha Shaqiri, pyetje për zëvendëskryeministren Mimoza Kusari Lila.

AFËRDITA BERISHA SHAQIRI: Ju faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pyetja ime është kjo: Me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve publike në Kosovë, disa kompani nuk i kanë përmbushur kushtet e parapara me kontratë të shitblerjes. A do të ndërmarrë masa Qeveria e Kosovës dhe cilat do të jenë masat që do të ndërmerren ndaj këtyre kopanive?

Këtë pyetje e kam bërë duke u bazuar në një takim me ish punëtorët e Fabrikës së gomës dhe kimike “Ballkan” të Suharekës, fabrikë e cila deri në vitin 2006, kishte 860 punëtorë. Ajo është shitur me Spin-off special me çmim përbuzës 1.4 milionë euro, edhe pse ishte njëra ndër tri objektet më të mëdha të Kosovës pas Trepçës dhe Ferronikelit. Kompania turke e cila e bleu “Ballkan”-in, sipas ish punëtorëve, nuk përmbushi asnjë kusht të paraparë me kontratën e shitblerjes. Nuk punësoi numrin e paraparë të punëtorëve, përkundrazi prej 860 punëtorëve, sa kishte në vitin 2006, u përgjysmua në 375 punëtorë. Nuk bëri punësim të ri, por bëri largim. Nuk bëri investime, por vetëm shkatërrime. Prandaj, me plotë të drejtë punëtorët po kërkojnë nga Qeveria e Kosovës që të shikohet mundësia e rishikimit të kontratës së blerësit, i cili nuk përmbushi kriteret sipas marrëveshjes. Prandaj, pyetja është: A do të ndërmarrë masa Qeveria e Kosovës, jo vetëm për rastin e “Ballkan”-it, por për të gjitha kompanitë të cilat nuk i kanë përmbushur kontratat e shitblerjes?

KLYESUESI: Zonja Kusari, e keni fjalën!

MIMOZA KUSARI LILA: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Po shpresoj se zonja deputete Afërdita Berisha Shaqiri, mendoi për ndërmarrje shoqërore, e jo ndërmarrje publike. Kompania në fjalë, është privatizuar si ndërmarrje shoqërore, ndërsa në kuadër të ndërmarrjeve publike, ende asnjë ndërmarrje publike nuk është privatizuar dhe ekziston një dallim në rast të pronësisë.

Sa i përket ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara deri më tani, nga pasqyra e privatizimit, i kemi pasur afërsisht 50 valë, nga të cilat 292 ndërmarrje, nga ndërmarrjet shoqërore janë krijuar 644 ndërmarrje të reja. Procesi i privatizimit në Kosovë është përcjellë me probleme dhe nuk është i krahasueshëm me privatizimet në shtetet tjera për shkak specifikave të veta që i ka pasur Kosova prej momentin kur ka filluar privatizimi, specifika apolitike dhe ekonomike.

Procesi i likuidimit për të cilin, domethënë, një numër i konsiderueshëm i problemeve edhe kanë dalë, është ballafaquar me vështirësi për shkak se kryhet në bazë të Rregullores së UNMIK-ut ende, e cila parasheh procedura të stërzgjatura. Për një likuidim të ndërmarrjes nevojiten afërsisht 3 vite, ndërsa janë 600 ndërmarrje që duhet likuiduar, e që bie ky proces të vazhdojë dhe të mos përfundojë as për 30 vjet.

Çka është duke u ndërmarrë tani? Agjencioni Kosovar i Privatizimit, i cili agjencion është, puna dhe veprimtaria e të cilit është i rregulluar me Ligjin 2008/03, nga i cili përgjegjësi ka Kuvendi. 5 drejtorë të Bordit janë të emëruar nga Kuvendi, 3 nga Zyra ndërkombëtare civile. Megjithatë, problemi kyç i kësaj agjencie ka qenë mosnjohja e subjektivitetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nga Oda e veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe, nga ana tjetër, njohja e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit si palë ndërgjyqëse, që ka krijuar vështirësi shumë të mëdha në kryerjen e procedurave gjyqësore, të iniciuara në këtë Odë dhe që janë ndërlidhur drejtpërdrejtë nga AKP-ja në procesin e privatizimit.

Më në fund, pas shumë përpjekjeve, Agjencioni Kosovar i Privatizimit, bashkë me Qeverinë, Kuvendin, Zyrën civile ndërkombëtare, Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe institucionet tjera janë duke punuar për procesin e filluar për të ndryshuar legjislacionin aktual dhe unifikimin e bazës ligjore, përshtatjen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pritet të bëhet ndryshimi në Ligjin e AKP-së, ku përfshihet edhe likuidimi dhe kontestet tjera të ngritura nga proceset sikur Spin-off-i special, si dhe janë krijuar komisionet punuese për ndryshimet legjislative dhe është punuar intenzivisht për nxjerrjen e këtyre ligjeve, zëvendësimin e rregulloreve të UNMIK-ut.

Ligji në fjalë ose Projektligji në fjalë, tashmë vetëm është dorëzuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe pas miratimit në Qeveri, do t'i procedohet edhe Kuvendit.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pyetje shitesë?

AFËRDITA BEERISHA SHAQIRI: Si mendoni, zonja zëvendëskryeministre, procesi i privatizimit në Kosovë, ka përmirësuar situatën ekonomike dhe sociale në Kosovë, apo e ka rënduar edhe më shumë?

MINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: Unë e përmenda që procesi i privatizimit në Kosovë nuk është zhvilluar sikur në vendet tjera për shkak të situatës specifike të Kosovës, politike dhe ekonomike, me rezultatet të cilat janë treguar, shkalla e punësimit nuk është ngritur në masën në të cilën është pritur dhe ka probleme në vazhdimësi, të cilat duhet të sanohen me një formë tjetër të promovimit të mundësive investive në Kosovë dhe stimulim të sektorit privat. Dihet se lista e prioriteteve dhe plani aksional për zhvillimin ekonomik të Qeverisë vetëm është përgatitur dhe në kuadër të kësaj përfshihet në veçanti edhe ngritja e kapaciteteve të sektorit privat për pjesëmarrje më të madhe në ekonomi.

Nëse e kërkon një përgjigje definitive, nëse shikohet nga bilanci dhe mosfunksionimi i këtyre ndërmarrjeve për një periudhë një dekadë gjatë viteve '90, mund të themi se nuk i ka arritur rezultatet të cilat kanë qenë të pritura, jemi të gjithë të vetëdijshëm, për këtë arsye edhe po mundohemi që të paktën procesin në aspektin ligjor dhe funksional ta përmirësojmë. Për këtë arsye edhe janë iniciuar ndryshime në legjislacionin për funksionimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Afërdita Berisha Shaqiri, pyetje për ministrin Blerand Stavilevci. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen?

AFËRDITA BERISAHA SHAQIRI: Nuk do ta bëjë pyetjen.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Donika Kadaj - Bujupi, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Nga monitorimi i Ligjit të buxhetit, kemi të dhëna që Ligji është duke u shkelur në vazhdimësi në pozicione të caktuara buxhetore, prandaj po e pyes ministrin e Financave, a është në dijeni për këto shkelje?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën, ministrit Hamza!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara deputete, zonja Bujupi,

Ju faleminderit për pyetjen! Edhe pse pyetja ishte e përgjithësuar, por përgjigja është kjo: Në Kosovë është duke u zhvilluar reforma e menaxhimit të financave publike, në

nivelin qendror dhe lokal, është e përkrahur edhe nga donatorët USAID, DFID, Komisioni Evropian dhe Banka Botërore.

Qëllimi i kësaj reforme, është ngritja e disiplinës financiare, transparencës dhe llogaridhënies.

Buxheti ekzekutohet nga shumë organizata buxhetore të nivelit lokal dhe të nivelit qendror. Në nivelin lokal, ne i kemi mbi 30 komuna, në nivelin qendror i kemi ministrinë, Kryeministrinë, Kuvendin, Presidencën dhe shumë autoritete tjera të pavarura.

Këtu punojnë shumë shërbyes civilë, që mund të jenë të të gjitha partive, mund të jenë edhe pa parti. Institucion përgjegjës për ta vërtetuar se sa është ekzekutuar buxheti, konform Ligjin për buxhetin, është institucioni i pavarur që është Zyra e Auditorit Gjeneral, e cila e ka obligim të dalë me publikimin e këtyre raporteve. Mbi bazën e këtyre raporteve, nëse ka të gjetura, menaxhmenti i ka obligimet e veta për t'i marrë veprimet e caktuara, mirëpo edhe organet e drejtësisë duhet ta bëjnë punën e vet mbi bazën e këtyre raporteve. Prandaj, nëse keni pyetje më specifike të cilat kanë të bëjnë me kompetencat e ministrit për Financave rreth kësaj çështjeje, unë do t'ju jap përgjigje.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pyetje shtesë? Deputetes, fjalën!

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Po, ministër, pretendimet që gjithçka është okej, shpesh po bëjnë që po na turpëroni para botës, na i keni humbur 145 milionë euro, na keni varfëruar. Ndërkaq, pyetja është shumë specifike: Ku e keni gjetur bazën juridike për ta ndryshuar pozicionin për Ligjin për financim të partive politike vetëm dy-tri ditë pasi që Ligji për buxhet është miratuar nga ky Kuvend. Besoj që shërbyesit civilë nuk e kanë bërë këtë punë, por e keni bërë ju, si ministër për Financa dhe Qeveria Thaçi. Domethënë, 2.4 milionë euro i keni ndryshuar, i keni rialokuar pasi që buxheti, do të thotë buxheti i Kosovës është aprovuar në këtë Kuvend dhe do të thotë e keni bërë një ndryshim, i cili nuk ka asnjë bazë juridike. Nëse ka bazë juridike, ju lutem, na njoftoni cila është ajo bazë juridike. Unë e di që keni deklaruar që keni bërë gabim, por gabimet e juaja po i kushtojnë shumë Kosovës me miliona euro të vazhdueshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRIHAMZA: Ju faleminderit, zonja deputete!

Pjesa e dytë e pyetjes nuk ka lidhje me pjesën e parë, por sidoqoftë nuk mund të bëhet rialokim brenda buxhetit jashtë Ligjit të buxhetit. Ligji i partive politike dhe financimi i partive politike është aprovuar në Kuvend, nuk e aprovon Qeveria, propozon dhe është aprovuar në Kuvend. Ligji i buxhetit është aprovuar në Kuvend. Nëse keni, nëse keni fakte që është shkelur ky ligj, të lutem, depononi faktet, ne secili, duke përfshirë mua dhe të gjithë të tjerët që jemi të obliguar për ta respektuar këtë ligj, ne mbajmë përgjegjësinë. Prandaj, mos të ngrehim dilema. Ligji për financimin e partive politike është i aprovuar nga Kuvendi. Ligji i buxhetit është i aprovuar nga Kuvendi dhe nuk ka transfere të

jashtëligjshme, me përgjegjësi e them, nuk ka transfere të jashtëligjshme në këtë drejtim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Niazi Idrizi, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

NIAZI IDRIZI: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuari zoti Mujota,

Kosova ka ndarë një buxhet të caktuar dhe jashtëzakonisht të madh për infrastrukturën rrugore. Më intereson ta di cilat kritere janë përdorur për përzgjedhjen e projekteve me prioritet për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrugëve ekzistuese në Kosovë. Ju faleminderit!

KYRESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari nënkryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Idrizi,

Nga viti 2003 dhe në vazhdim janë bërë një varg studimesh lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit rrugor në Kosovë. Në bazë të këtyre studimeve, është përcaktuar zhvillimi strategjik i drejtimeve kryesore të rrugëve të Kosovës, si pjesë e rrjetit themelor të Evropës Juglindore.

Mbi këtë bazë, janë përcaktuar këto prioritetë: drejtimi rrugor 6, Hani i Elezit - Prishtinë-Pejë, në drejtim të Malit të Zi, drejtimi rrugor 6/a Prishtinë – Mitrovicë-Zubin Potok, drejtimi rrugor 7 Morinë-Prishtinë-Merdarë. prandaj Ministria e Infrastrukturës tashmë ka kryer studimin e arsyeshmërisë dhe të ndikimit ambiental për drejtimet rrugore 6 dhe 7, ndërsa ka hartuar strategjinë e shumëllojshmërisë së transportit në Kosovë në bashkëpunim edhe me partnerët ndërkombëtarë.

Si rezultat i këtyre studimeve, është plani afatmesëm i aktiviteteve për ngritjen e nivelit të shërbimeve, që përfshin zgjerimet e drejtimeve të rrugëve kryesore. Kriteret themelore për zgjerimin e akseve rrugore në drejtimet Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-udhëkryqi për Lipjan QMI, kanë qenë kriteret teknike që lidhen me numrin e automjeteve që qarkullojnë në këto akse rrugore, kapaciteti i pamjaftueshëm i rrugëve për përballimin e numrit të automjeteve në qarkullim, shkurtimi i kohës së udhëtimit dhe zvogëlimi i aksidenteve rrugore, modernizimi i infrastrukturës rrugore me standarde që mundëson shpejtësi dhe nivel të lartë të shërbimeve, lidhja më e mirë e qendrave komunale me kryeqendrën dhe shtetet fqinje, lidhja më e shpejtë e kryeqytetit me Aeroportin dhe ruajtja e ambientit. Sa për ilustrim, po përmend një mesatare vjetore të dhënat e numëruesve automatik të trafikut, që janë të vendosur në rrugët nacionale dhe funksionojnë 24 orë.

Në segmentin e rrugës Prishtinë-Mitrovicë, mesatarja vjetore e komunikacionit për 24 orë në dy drejtime, është 15.697 automjete, dhe drejtimin Prishtinë - udhëkryqi për

Lipjan përkatësisht QMI, 24.602 automjete, udhëkryqi i Lipjanit-Ferizaj 14.161 automjete, Prishtinë-Fushë
22.483 automjete dhe Sllatinë- Komoran 14.700 automjete.

Tani, aktualisht po punojmë si Ministri e Infrastrukturës dhe i kam autorizuar ekipet profesionale të Ministrisë për të filluar studimin e arsyeshmërië dhe ndikimit ambiental për korridorin e ri rrugor, nga kyçja e autostradës Prishtinë-Shkup në Sojevë, në drejtim të Gjilanit, deri në kufi. Dhe, sa për ilustrim, po përmend edhe shifrat tjera. Në segmentin rrugor Prishtinë-Gjilan, automjetet që qarkullojnë për 24 orë, janë 4200 dhe në drejtimin Ferizaj-Gjilan 6650.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë?
Deputetit Idrizi, fjalën!

NIAZI IDRIZI: Dëshiroj ta theksoj, ministër, që kjo rruga, e kam fjalën për rrugën Prishtinë-Gjilan, ky është një segment rrugor shumë i rëndësishëm, është arteria kryesore e qarkullimit të qytetarëve, jo vetëm të Artanës, të Gjilanit, të Kamenicës, por edhe të Luginës së Preshevës, edhe një pjesë e qytetarëve të Vitisë qarkullojnë nëpër atë rrugë. Ajo rrugë është bërë shumë e rrezikshme, është dhe madje ka qenë, por është bërë për më keq, një rrugë shumë e mërzitshme për kalimtarët që e kalojnë atë rrugë. Prandaj, në këtë drejtim e kam shtruar pyetjen, kam dëshirë ta di ajo rrugë pse nuk është futur në kornizë afatmesme të shpenzimeve dhe si mendoni ta trajtoni në të ardhmen?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Ju faleminderit!

Unë tash vetëm sa dhashë një përgjigje për rrugët e rëndësisë nacionale dhe përpjekjet për të zgjidhur të gjitha problemet në këtë drejtim. Është e qartë se buxheti për ndërtimin e të gjitha rrugëve, buxhet të cilin e kemi miratuar, nuk do të mjaftoj, por është e rëndësishme të kemi strategjinë për të gjitha akset rrugore të rëndësisë nacionale në kuadër të rrjetit të transporteve në Evropën Juglindore dhe të kemi standarde të larta të pranueshme, ashtu siç është në gjithë rrjetin e transporteve në Evropë. Por, çështja e rrugës për të cilën tani ju flitni, është e vërtetë që gjendja e saj është ajo që është, për këtë vit nuk është paraparë ndonjë buxhet, mirëpo do të rishikojmë të gjitha mundësitë, nëse do të ketë hapësira për të bërë ndonjë riparim në kuptimin e mirëmbajtjes, përndryshe tani për tani është jo korrekte të premtohet një rishikim i plotë i kësaj rruge në kuptimin e këtij projekti sepse, besoj se kemi edhe shumë rrugë tjera të cilat janë në po këtë gjendje dhe nuk kemi mundësi që këtë vit ta realizojmë në kuptimin e drejtë të cilësisë. Sidoqoftë, ky rajon mendoj se po hap perspektivën e vet përmes këtij studimi të arsyeshmërisë dhe do të jetë një korridor, i cili në perspektivë do të zgjidhë probleme të mëdha të këtij rajoni dhe të gjithë Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Niazi Idrizi, pyetje për ministrin Dardan Gashi.

NIAZI IDRIZI: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti ministër Gashi,

Me ju kam pasur një bisedë para një muaj e gjysmë lidhur me shfrytëzimin e një resursi të Kosovës që shtrihet në një sipërfaqe mjaft të madhe të Kosovës, kemi biseduar, fjala është për ujërat termo-minerale, të cilat mund ta japin kontributin e vet në zhvillimi ekonomik të Kosovës dhe të krijimit të mirëqenies për një pjesë të qytetarëve, sidomos në atë pjesë ku ato shtrihen.

Ne e dimë, përgjigjen për veti e di e cila është, por dëshiroj që këtë çështje ta aktualizoj me qëllim që unë dhe ne së bashku, vendimmarrja këtu që jemi, t'ju mbështesim që në këtë pikë, ju të bëni atë që është më e mundshme për të bërë. Më intereson ta di, a ka ndonjë studim për potencialin e këtyre ujërave, për shtrirjen e tyre, për kualitetin e tyre dhe a e kemi të ndërtuar infrastrukturën, vërtet kornizën institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të tyre për shfrytëzimin shumë qëllimor të tyre, nëpër sektorë e kam fjalën. Ju faleminderit!

KRYEUSESI: Ju faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI: DARDAN GASHI: Zoti kryesues,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Institucionet e Kosovës nuk kanë asnjë studim të ndërtuar, pra, në bazë të institucioneve të Kosovës. Ekziston një studim që është bërë para vitit 1999. Sipas atij studimi, në të cilin bazohemi edhe ne, janë përafërsisht 50 pika në Republikën e Kosovës ku ka pasur lajmërimet të ujërave termominerale, prej tyre 4 janë të shfrytëzuara në bazë të ligjeve të Kosovës, të pajisura me leje ujore dhe licenca, që janë: Banja e Klllokotit, Banja "Nëna Naile", "Vëllezerit Ibishi", kurse edhe dy operatorët tjerë, të cilët sipas informatave që ne i kemi, nuk janë pajisur me asnjë leje dhe operojnë në mënyrë ilegale, të cilat janë kontaktuar nga Ministria edhe para se ne të fillojmë me këtë projekt.

Sa i përket kornizës ligjore, ekzistojnë Ligji i ujërave që nga viti 2004 dhe korniza tjetër ligjore, e cila e rregullon përdorimin e ujërave termominerale dhe të ujërave nëntokësore. Mirëpo, siç thashë, nuk kemi ndonjë studim të bazuar në institucionet e Republikës së Kosovës se ku gjenden këto ujëra dhe si mund të shfrytëzohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë, a keni? Deputetit Idrizi, fjalën!

NIAZI IDRIZI: Dëshiroj ta jap një koment lidhur me këtë, që nuk ka të bëjë me ministrin, por neve na ka ndodhur në vitin 2008, që për shkak të mungesës së një kornize të tillë institucionale janë ndërprerë punimet në të cilat ka marrë pjesë, për t'i promovuar kanë marrë pjesë edhe institucionet tona, për shkak të mungesës të një kornize të tillë. Këtu e kam pasur, fjala ka qenë për ndërtimin, për prodhimin e energjisë elektrike mjedisore, e cila ka qenë shumë e rëndësishme. Ai projekt është ndërprerë,

është dhënë një mesazh shumë i keq për investitorët këtu. Këtë e kisha mendjen, domethënë ta bëjmë punën para se të vijë investimet këtu. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Visar Ymeri, pyetje për zëvendëskryeministren Mimoza Kusari Lila.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Siç e dinë të gjithë, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, njërën prej masave që i kishte ndërmarrë Serbia për ta minuar këtë pavarësi, ka qenë dhe mbetet bllokimi i mallrave të prodhuara në Kosovë dhe moslejimi i eksportimit të tyre as në Serbi, e as lejimi i përdorimit të territorit të Serbisë si rrugë transiti për eksportimin e mallrave të Kosovës nëpër vendet e treta.

E njëjta gjë ndodhë edhe me Bosnjën dhe Moldavinë, mirëpo me Serbinë është gjendja shumë më alarmante. Ne e dimë se tregu i Kosovës vazhdon të jetë i vërshuar nga produktet e Serbisë. Pra, Kosova importon diku rreth 250 deri në 300 milionë euro në vit, ndërkohë që natyrisht kjo shifër është shumë më e madhe kur merret parasysh se pjesa më e madhe e produkteve nga Serbia hyjnë në Kosovë, madje as pa u regjistruar, e lëre më zhdoganuar.

Kohëve të fundit kemi dëgjuar që ministrja e Ministrisë për Tregti dhe Industri ka filluar të flasë për masa reciprociteti karshi Serbisë dhe pyetja ime është - çka saktësisht nënkuptojnë këto masa reciprociteti, për të cilat po flet ministrja, dhe kur do të fillojnë së aplikuari ato?

KRYESUESI: Ministres fjalën, ju lutem!

MINISTRJA MIMOZA KUSARI LILA: Ju faleminderit!

I nderuari kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Që prej nënshkrimit të marrëveshjes CEFT-a nga UNMIK-u, përfitimet ekonomike për Kosovën janë minimale dhe zhvillimet kanë qenë kryesisht procedurale. Përkundër vullnetit të mirë të Kosovës në avancimin e bashkëpunimit rajonal ekonomik, që nga 3 dhjetor 2008, Serbia në kundërshtim me qëllimet e marrëveshjes së CEFT-as, vendos bllokadë në qarkullimin e lirë të mallrave kosovare me destinacion tregun e Serbisë, si dhe në qarkullimin e mallrave tranzit. Të njëjtën frymë të mosbashkëpunimit dhe të krijimit të pengesave në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave, ashtu siç u përmend nga deputeti Ymeri, kanë vendosur edhe Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia.

Në vitin 2008, kur Serbia filloi bllokimin e produkteve kosovare, ajo eksportonte në Kosovë vlerë të mallrave 208 milionë euro. Sot vlera e importit të mallrave nga Serbia arrin 260 milion euro. Prej kohës kur Serbia i kishte bllokuar krejtësisht mallrat e Kosovës, niveli i eksporteve në Kosovë është rritur për 25% ose në rreth 50 milionë

euro mbi vlerën fillestare. Kjo është plotësisht e papranueshme nga ana e palës kosovare.

Bizneset kosovare tash e një kohë janë duke humbur miliona për shkak të moslejimit të qarkullimit të mallrave tona tranzit nëpër territorin e Republikës së Serbisë dhe Bosnjës. Në vend që të eksportojmë produktet e tyre në Evropë përmes Serbisë dhe Bosnjës, prodhuesit kosovarë duhet të gjejnë rrugë alternative, të cilat në vazhdimësi ka rritur koston e shpenzimeve të bizneseve kosovare.

Si rezultat për shkak të kostos më të lartë të transportit, çmimi i mallrave kosovare në tregun evropian rritet dhe ato i bën më pak konkurrenca në treg. Si Qeveri e Kosovës, strategjia jonë në lidhje me ndryshimin e kësaj situatë përbëhet nga dy faza: vendosja e tarifës doganore, faza e parë, dhe bllokimi i plotë i mallrave të importuara nga Serbia, faza e dytë.

Është e rëndësishme të theksohet se këto masa nuk janë të plota, reciprociteti në fazën e parë. Nëse Serbia nuk i pranon vullat doganore të Kosovës, tarifën doganore të vendosura për produktet e Serbisë do të jenë vetëm një hap në drejtim të bllokimit total të importit të tyre në Kosovë. Dëshiroj t'ju njoftoj që në kuadër të përgatitjeve për jetësimin e këtyre masave, jemi takuar me bizneset importuese nga Serbia me qëllim të diskutojmë më tutje implikimet e mundshme financiare dhe ndikimet në çmimet e konsumit të përgjithshëm në Kosovë.

Ekziston një përkrahje e gjerë edhe nga komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile për jetësimin e këtyre masave. Publikisht ju kemi dhënë kohë Serbisë deri në muajin, mesin e muajit qershor të këtij viti që të ndryshojnë qëndrimin e tyre në lidhje me eksportin e mallrave kosovare dhe përdorimin e territorit të Serbisë si rrugë tranzit për eksportin e mallrave të Kosovës në vendet tjera. Ne nuk kërkojmë asnjë favor, në këtë rast, për arsye se Serbia është nënshkruese e Marrëveshjes së CEFT-së e cila i obligon ata të lejojnë lëvizjen e lirë të mallrave nga vendet e rajonit. Marrëveshja vlen njësoj për të gjitha shtetet. Kosova në CEFT-a është e barabartë me të gjitha vendet pjesëmarrëse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë?

VISAR YMERI: Ju faleminderit!

Ministrja mori shumë kohë për të na shpjeguar situatën, gjë që ne e dimë dhe nuk kishte nevojë për atë punë. Pyetja ime ishte se çfarë do të jenë ato masa të cilat i përmendi ministrja, pra duhet ta dimë që masë reciprociteti nuk është zbatimi i taksës doganore për produktet e Serbisë, dhe se kjo masë e reciprocitetit ose kjo masë, si fazë e parë, mund të zhvlerësohet shumë shpejtë nga Sekretariati i CEFT-as, siç e dimë ne. Pra, pyetja ime do të ndërlidhet edhe me këtë që e thashë, se çfarë do të bëjë Qeveria e Kosovës po qe se kjo masë zhvlerësohet apo intervenon Sekretariati i CEFT-as për këtë çështje dhe a jeni të gatshëm të dilni nga CEFT-a për ta bllokuar Serbinë për shkak se

kjo kohë që po i jepet Serbisë, domethënë kjo kohë e vazhdueshme prej, tash u bënë gati 3 vjet, plus tash edhe 15 ditë, e jo tani edhe me fazat e ndërmjetme, kush e di sa kohë, është kohë absolutisht e paarsyeshme për shkak se ne nuk mund të presim që Serbia të bëhet e mirë ndaj neve, duke e lutur. Pra, duhet t'i zbatojmë masat e njëjta, në mënyrë që ajo ta kuptojë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zonja Lila, e keni fjalën!

MIMOZA KUSARI LILA: Po, ju faleminderit, zoti Ymeri!

Unë e ceka që aplikimi masës së parë, nuk është tërësisht reciprocitet, duhet ta kemi parasysh se 86% të importit të grurit në Kosovë bëhet nga tregu i Serbisë. Kjo ka qenë arsyeja e ngritjes së vëmendjes dhe gjetjes së importuesve, në fakt, tregjeve tjera për grurë, se çmimi, lëvizja në çmimin e bukës do të ishte një masë e kundër efektshme. Duhet të theksoj se në këtë rast Kosova nuk e ka asnjë ndjenjë inferioriteti ndaj Serbisë në raport me zbatimin e marrëveshjes së CEFT-as. Edhe në Sekretariatit e CEFT-as, edhe Komisionerit për Zgjerim të njëjtat qëndrime janë bërë. Asnjë lëvizje nga afati i paralajmëruar para një muaji, nuk ka. Është mesi i muajit qershor. Ajo çka ka ndodhur para 3 viteve, ka ndodhur, të gjithë e dimë se në çfarë faze ka qenë Kosova, megjithatë aplikimi i masës së vënies së doganës është testimi i parë në raport me tregun brendshëm. Ideja jonë është ruajtja e tregut të brendshëm dhe qytetarit të Republikës së Kosovës dhe, natyrisht, aplikimi masave të njëjta me Serbinë në rast se nuk ka lëvizje në këtë aspekt.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre!

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami, pyetje në fakt për ministrin Ramë Buja. Ministri nuk është këtu, a dëshironi ta shtroni pyetjen?

ARSIM BAJRAMI: Po e lë për seancën tjetër.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Konstatohet që pika e dytë e rendit të ditës u krye.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27 maj 2011

Në sallë janë 66 deputetë. Pyes, të nderuar deputetë, nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Nuk ka. Atëherë, konstatoj që Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 27 maj 2011.

Para se të fillojmë me shqyrtimin e ligjeve, propozoj një pauzë prej 10 minutash.

Vazhdimi i seancës pas pushimit

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Ministra,
Po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

**4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin
e Ligjit nr. 3/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të
komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës**

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin, Bujar Bukoshi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

BUJAR BUKOKSHI: Ju faleminderit!

Të nderuara zonja deputete dhe deputetë,
Ky Projektligj ka për qëllim ndryshimin edhe plotësimin e Ligjit 03-L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Në këtë projektligj komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare, tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës, të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë: komuniteti Serb, Turk, Boshnjak, Romë, Ashkali, Egjiptian, Goran, Malazez dhe Kroat, si dhe komunitete të tjera.

Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar, po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë ligj. Ky veprim legjislativ që po ndërmerret, është në vijë me përkushtimin e Qeverisë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Prandaj, propozohet që të merret vendim. Kolegu im, zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi më është lutur që ta prezantoj për t'u shqyrtuar ky Projektligj, ai është i zënë.

Sot, nëse më lejohet një koment të shkurtër, pati kritika se ka shumë zëvendëskryeministra. Ne edhe ashtu, si duket, ndoshta mos po shumëhet numri i tyre, se kemi mjaftë punë. Kur isha kryetar i një qeverie, të cilën e udhëhoqa me 6 ministra, kisha po ashtu kritika të hidhura se janë pak, tash shumë, duhet ta gjejmë diku mesin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani, sipas Rregullores, fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional për Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, deputeti Sasha Rashiq. Nuk është. Atëherë, në emër të komisionit, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Dua t'ju informoj se në pajtim me nenin 56.21 dhe nenin 64.1.2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni edhe pse ka caktuar mbledhjen me datën 1.06. 2011, me qëllim të shqyrtimit të Projektligjit në parim, në bazë të konsultave që kryetari i komisionit është deleguar për zëvendësministër dhe deputetëve të këtij komisioni, është marrë vendim që mbledhja të shtyhet dhe shqyrtimi i projektligjit në komision nuk është bërë hiq. Kështu që secili prej grupeve parlamentare do të japë mendimin e vet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Lumniye Morina.

LUMNIJE MORINA. Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Duke pasur parasysh se ky projektligj është bazuar e është hartuar si rezultat i përkushtimit politik të Qeverisë së Kosovës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe plotëson Ligjin e theksuar më lartë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, edhe pse komisioni përkatës nuk e ka shqyrtuar këtë projektligj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe e përkrah dhe mbështet në shqyrtim të parë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Përsëritje për të gjithë!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka analizuar ndryshimet dhe plotësimet e paraqitura në këtë Ligj për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Projektligji ka ardhur me kohë në dorën e deputetëve

dhe për lehtësim pune kanë ardhur edhe shkresat përcjellëse të nevojshme me memorandum shpjegues, me qëllimin, nevojën, arsyetimin, përmbajtjen dhe risitë në avancimet e projektligjit.

Projektligji e ka edhe deklaratën financiare dhe deklaratën e Ministrisë së Integritetit Evropian se përmbajtja e Projektligjit për ndryshimin e këtij ligji nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së.

Duke i parë të gjitha këto dhe para se gjithash se projektligji është në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kapitujt II dhe III të Kushtetutës dhe shihet se është në interesin e përgjithshëm të Kosovës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i pranon këto ndryshime dhe do të votojë për dhe, për fund, ushtrimi i të drejtave të komuniteteve në Kosovë bartë me vete edhe detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Konjufca e ka fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë,
Së pari, ky procedim i këtij projektligji për ta ndryshuar Ligjin ekzistues mbi komunitetet dhe në këtë formë qysh ka ardhur, nuk është fare në rregull, për arsye se duhet ta kalojë komisionin dhe pa e kaluar atë, faktikisht ne nuk mund të dimë aktualisht mos ai mund të jetë edhe në kolizion me..., pra në kundërshtim edhe me ligjet tjera apo edhe me vetë aktin më të lartë, Kushtetutën.

Por, Projektligji për ndryshimin e Ligjit ekzistues për komunitete mund të përmbledhet kështu. Ligjit, i cili është edhe ashtu skandaloz, po i shtohet një mbindërtim i keq dhe pa leje bile.

Së pari, vetë ligji është i papranueshëm dhe shumë i dëmshëm për Kosovën. Ky është njëri prej ligjeve i cili më së shumti e ngërthen planin e Ahtisarit dhe ai është, siç dihet, i miratuar më 13 mars të vitit 2008, pra në formën e pakove ligjore, kur në Kuvendin e Kosovës kalonin me dhjetëra ligje pa kurrfarë qasjeje kritike, vetëm pse kështu parashihte plani i Ahtisarit. Ky ligj është etnizim i skajshëm i Kosovës dhe legalizim i dëmshëm i ndarjeve etnike në vendin tonë.

Ligji në fjalë është i papranueshëm së paku në shtatë nene, kurse ato pak nene pozitive janë aty vetëm sa për të treguar se sa të pa zbatueshme kanë qenë ato. Pra, ligji mund të shihet si një përmbledhje e neneve të dëmshme, të cilat janë zbatuar me përpikëri, si dhe atyre pak neneve pozitive të cilat nuk janë zbatuar fare.

Zbatueshmëria dhe mos zbatueshmëria e këtij ligji e ka pikërisht burimin në etnizimin e problemit të Kosovës që ka ndodhur, sepse nenet të cilat do të mund të shfrytëzoheshin për mbrojtjen e shqiptarëve, për shembull, nuk zbatohen, kurse ato që kanë të bëjnë me serbët zbatohen rregullisht.

Neni 1.4, për shembull, e vendos komunën si njësi bazë të definimit të kategorive politike shumicë dhe pakicë. Kjo është shumë gabim.

Ky ligj është në funksion të politikave të gabueshme të rajonalizimit të Kosovës sonë, edhe ashtu të vogël, krahasuar me shtetet tjera, si dhe në funksion të decentralizimit etnik, që e dobëson edhe më shumë autoritetin politik qendror të Prishtinës, i cili madje ende nuk ka arritur të konsolidohet mirë.

Komuna nuk duhet të jetë njësi themelore e definimit të raportit shumicë, pakicë në Kosovë. Njësi themelore për këtë definim duhet të jetë vetë shteti i Kosovës. Në këtë nivel duhet të definohet populli i Kosovës dhe mbi këtë bazë duhet të përcaktohet karakteri kombëtar i shtetit të Kosovës, si dhe të drejtat dhe obligimet që rrjedhin për kategoritë politike.

Pikërisht pse niset nga kjo pikë, Ligji i definon si pakicë shqiptarët, të cilët gjenden në ato komuna ku nuk janë ata shumicë. Pra, kjo qasje etnike për të drejtat politike duhet të ndryshohet nga ana e institucioneve të Kosovës.

Në nenin 4.6, për shembull, përcaktohet përdorimi i simboleve dhe shenjave kombëtare politike, por ajo që i duhet jo vetëm ligjit por edhe Kushtetutës sonë të varfër, është ndalimi i përdorimit të shenjave dhe të gjeesteve të cilat janë fyerje për popullin e Kosovës dhe shtetësinë e Republikës së Kosovës. Si gjeeste të tilla, të cilat duhet të ndalohen në Kosovë, është për shembull, këtu na ka ndodhur në Kuvend, deputetja Rada Trajković i ka ngritur tre gishta në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Një gjest i tillë e fyer popullin e Kosovës dhe duhet të ndalohet me ligj.

Po ashtu, me ligj duhet të ndalohet edhe shprehja e ministrit të Qeverisë Thaçi, Radojica Tomiq, i cili shtetin tonë e quan Kosova dhe Metohija. Edhe kjo do duhet të rregullohet me ligj, duhet të ndalohen këto shprehje të tilla.

Neni 4.7 i Ligjit, po ashtu tregon një asimetri domethënëse në mes atyre vendeve ku jetojnë shqiptarët dhe serbët. Për shembull, rasti i toponimeve dhe shkrimet e tabelave, shënohen edhe në gjuhën serbe dhe në atë shqipe, mirëpo këtu në ligj shkruan nëse në atë rajon, po citoj: “ka popullsi të mjaftueshme të asaj pakice”.

Nëpër Kosovë jo vetëm gjitha toponimet shkruhen edhe në shqip edhe në serbisht, bile edhe aty ku nuk jeton asnjë serb, por edhe nëpër të gjitha institucionet komunale, por po të shkonim në komunën e Graçanicës, aty do të gjeni vetëm mbishkrime në serbisht.

Neni 6.5. po ashtu e favorizon pakicën serbe dhe i diskriminon pakicat tjera, sepse parasheh televizion shtetëror vetëm për serbë në nivel të Republikës së Kosovës!

Neni 7.6. Trashigiminë mesjetare ortodokse të Kosovës ia dhuron Kishës Ortodokse Serbe me seli në Beograd dhe kjo është e pa drejtë.

Neni 8.5. ia lejon shkollave nëpër komunat e banuara me serbë që të shërbehen me plan-programe të Ministrisë së Arsimit të Serbisë. Aty UÇK-ja definohet si organizatë terroriste. Kjo është kundër Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të lejohet.

Kurse neni 8.6 e themelon Universitetin e Mitrovicës së veriut, si dhe e vendos atë nën autoritetin komunal, në vend që ta vendoste në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës, siç janë të gjitha universitetet publike të Republikës së Kosovës. Kjo është një asimetri e papranueshme.

Në dy nenet tjera, ligji na tregon se aty ku është fjala për mbrojtjen e shqiptarëve, ai nuk zbatohet fare. Për shembull, neni 2.3, thotë se “ndalohen çfarëdo masash për ndryshimin e përmbajtjes demografike të popullsisë në Republikën e Kosovës”. Por, është pikërisht kjo gjë që ka ndodhur me shqiptarët e veriut të Kosovës. Ata janë dëbuar, kurse pronat e tyre të lëna shkret, po blihen nga Qeveria e Serbisë. Ky është ndryshim i strukturës demografike në veri të Mitrovicës.

Më 1999 shqiptarët kanë qenë shumicë atje, kurse tash janë pakicë dhe mbi këtë spastrim etnik është ngritur justifikimi i krijimit të komunës me shumicë serbe të Mitrovicës së veriut. Pra, ligji nuk po zbatohet në këtë pikë, sepse vetëm se kemi të bëjmë me shqiptarët.

Po ashtu, ligji nuk është i zbatuar në pikën 3.2. sepse aty thuhet se duhet të mbrohen të gjithë ata persona të cilët janë të kërcënuar për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare. Shqiptarët janë të kërcënuar në veri sot, për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare dhe ky ligj nuk zbatohet.

Këto pra janë arsyt pse ligji është krejtësisht i pa pranueshëm. Po projektligji që na ka ardhur sot për vlerësim këtu, mund të përmbledhet me një fjalë: pakicave ekzistuese që janë serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët t’ua shtojmë edhe dy pakica tjera që janë malazezët dhe kroatët.

Kjo po tregon që jo veç Qeveria po trashet, jo vetëm po rriten ministrinë, zëvendëskryeministrat e zëvendësministrat, po në Kosovë po shtohen edhe pakicat.

Rritja e pakicave në këtë mënyrë është precedent i rrezikshëm, sepse kjo po ndodhë vetëm pasi Mali i Zi ka bërë trysni mbi kryeministrin Thaçi për njohjen e pakicës malazeze në Kosovë.

Në një paraqitje mediale para dy ditës, ku gërshetoheshin monologu, vetëlavdërimet dhe propaganda, kryeministri Thaçi tha se nuk i nënshtrohet presionit të veteranëve të UÇK-së, por ai po i nënshtrohet trysnisë së Malit të Zi për krijimin, për ta bërë kushtetuese, domethënë, këtë kategori – kategorinë e malazezve në Kosovë.

Lëvizja “Vetëvendosje” është për mbrojtjen dhe drejtën e pakicave sipas konventave më të avancuara evropiane dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të pakicave, por të gjitha pakicat jo serbe e pranojnë Republikën e Kosovës, shumica e pakicës serbe nuk e pranon shtetin e Kosovës. Ne mendojmë që integrimi i serbëve nuk mund të ndodhë me të drejta ekskluzive. Integrimi dhe mbrojtja e serbëve ndodh atëherë kur shpërbëhen strukturat paralele të paligjshme të Serbisë që po e pengojnë integrimin e serbëve në Kosovë, si dhe kur të rritet mirëqenia sociale për ta, ashtu sikurse për të gjithë qytetarët e

Kosovës. Vetëm atëherë do të ketë integrim, sepse të gjithë ata që jetojnë në Kosovë do të shohin perspektivë të jetesës në Republikën e Kosovës.

Prandaj, ne jemi kundër këtij ligji dhe kundër këtij projektligji, ne jemi për të drejtat e pakicave, por kësi të drejtash të çuditshme dhe me sherr që i ka plani i Ahtisarit, nuk ekzistojnë kurrkund në botë.

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, besoj, Xhevdet Neziraj!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në parim përkrah një pjesë të këtij ndryshim-projektligjit dhe kjo përkrahje është në atë për pranimin e këtyre dy komuniteteve, pasi ky ligj ka kaluar në legjislacionin e kaluar dhe është bërë pranimi i disa komuniteteve. Nuk do të hyjë në detale se a ka qenë e drejtë apo jo e drejtë, mirëpo ka kaluar në këtë Kuvend, sepse ka qenë pjesë e pakos së Ahtisarit, prandaj në këtë drejtim Grupi i Aleancës e jep përkrahjen, por vërejtjet tona janë se ky ndryshim i Projektligjit është dashur të kalojë nëpër disa komisione dhe të jepen edhe disa sugjerime tjera, për arsye se tash do të ndodhin disa gjëra tjera, duhet të ketë ndryshim edhe në Këshillin konsultativ të Komuniteteve, që është pranë presidentit të Kosovës, duhet të ndryshohet edhe Ligji mbi festat dhe shumë gjëra tjera të cilat nuk janë të definuara.

Unë do të cek vetëm nenin 6 të Kushtetutës së Kosovës, ku thuhet se flamuri, stema dhe himni janë simbole shtetërore të Kosovës, që pasqyrojnë karakterin shumë etnikë dhe gjatë Kushtetutës dhe hartimit të Kushtetutës nuk është përmendur, bie fjala, flamuri, tash dikush e shpjegon dhe ai që ka marrë edhe shpërblimin, thotë: këta gjashtë yjtë janë gjashtë komunitete. Tash mbasi u shtuan, nuk di a duhet të shtohen edhe yjtë apo ndoshta mundet të ngatërrohemi ne komunitetet në mes, të themi unë jam ylli i parë e tjetri i fundit, prandaj me këtë ligj tash e tutje do të kemi shumë probleme dhe është dashur që më parë të kalohet nëpër disa komisione tjera dhe të vihet në seancë, kështu që për pjesën e parë, atë që është për shtimin e komuniteteve, Grupi i Aleancës do ta përkrah, mirëpo për këtë pjesën tjetër duhet që të kalohet nëpër disa komisione tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Neziraj!

Për Grupin Koalicioni Kosova e Re, deputetja Muzejene Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për kabinetin qeveritar dhe të gjithë deputetët!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve tyre në Republikën e Kosovës, duke marrë parasysh se edhe kolegu nga grupi tjetër parlamentar potencoi se ky ligj vetëm është miratuar në

mandatin e kaluar, mirëpo siç po shihet, është dashur të vjen deri te ndryshimi, ku e kemi nenin 2, për qëllimet e këtij ligji edhe komunitetet apo grupet tjera të komuniteteve të cilat duhet të përfshihen këtu. Të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet do të jepen nga deputetët e Koalicionit Kosova e Re në komisionet parlamentare dhe kur marrim parasysh se në këtë kohë edhe është plotësim ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës, ne të gjitha të drejtat e komuniteteve i kemi të përcaktuara edhe me Kushtetutë, mirëpo çdo vërejtje e jona do të shkojë në bazë të anëtarëve tanë që i kemi edhe në grupin e Kushtetutës dhe në grupet e komisioneve parlamentare ku do të shqyrtohet ky projektligj. Në parim e përkrahim! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Selmani!

Në emër të Grupit SLS, deputeti Petar Miletic.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržace Nacrt zakona o izmeni Zakona o zaštiti promovisanja prava zajednica i njihovih pripadnika i suština ovih izmena jeste da se u etničke grupe na Kosovu uvode i Crnogorci i Hrvati, koji zaista jesu etničke grupe koje tradicionalno žive na Kosovu, tako da ćemo mi podržati da oni budu etnička zajednica i da se tako tumači i u zakonu.

Ono što je još u zakonu navedeno, a to je proširivanje Konsultativnog veća za zajednice pri Kabinetu predsednika Kosova sa ovim zajednicama. Ja kao predsjedavajući ovog Konsultativnog veća za zajednice mogu da kažem da Crnogorci i Hrvati već jesu članovi ovog veća i mislim da je to dobro i oni zaista doprinose radu ovog veća.

Međutim, ja bih želeo da se nadovežem ovde još kod toga, da ovo Konsultativno veće za zajednice zaista nema u ovom trenutku onu funkciju koju bi trebao da ima i nema onu snagu koju bi ovakvo jedno veće trebalo da ima.

Mi crpimo našu snagu iz autoriteta predsednika, međutim na nekoliko naših inicijativa institucije su ostale neme, posebno u delu koji se tiče inicijative oko obrazovanja. Dakle, mi kao Skupština bi trebalo da budemo svesni snage ovog Konsultativnog veća, jer ono zaista obuhvata ne samo sve zajednice, već i sve one sfere društva koje čine jedno društvo, a to su i političke partije, i nevladine organizacije, i neke druge organizacije tako da ja mislim da bi trebalo da ovo Konsultativno veće za zajednice ima jednu jaču ulogu nego što je imalo do sada.

Takođe, treba imati na umu, i to je već neko pomenuo, da ove izmene Zakona moraju biti usklađene sa Ustavom i to bi Komisija koja radi na izmeni Ustava trebala da ima na umu. Naime, naravno radi se o zagarantovanim mestima u Parlamentu, no to nije tema za današnju raspravu, tako da, evo ja ponavljam još jednom da će Poslanički klub Samostalne liberalne stranke u načelu podržati ovaj nacrt zakona o izmenama i dopunama.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për Grupin Parlamentar “6+” Duda Balje!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Cilj ovog zakona je zaštita i promovisanje prava zajednica i njihovih pripadnika u Republici Kosovo, a razlog za donošenje ovog nacrt zakona dolazi kao potreba za definisanje zajednica Crnogoraca i Hrvata kao zajednica na Kosovu.

Parlamentarna grupa "6+" podržava Nacrt zakona u načelu sa određenim primedbama. Prva se odnosi na član 2. ovog nacrt zakona, a tiče se nabiranja manjinskih zajednica, gde se ispred Bošnjačke stavlja Turska zajednica, a po svim statističkim podacima i drugim evidentnim faktima Bošnjačka zajednica je brojnija od Turske manjinske zajednice i druga manjinska zajednica po brojnosti u Republici Kosovo.

Druga primedba odnosi se na član 12. tačka 6. koja se tiče direktno članova Konsultativnog veća, gde se odredba: "može biti poslanik u Skupštini Kosova", znači 1 član može biti, smatramo da bi umesto „može“ trebalo biti „treba“ i da bi na taj način sve zajednice imale po jednog legitimnog predstavnika u Skupštini koji bi dao svoj doprinos za dobrobit svoje zajednice. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Tash grupet i dhanë mendimet dhe deklaratat e veta rreth ligjit, në parim. Vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Deputeti Arsim Bajrami!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshiroj t'i jap përkrahje parimore ndryshimit të këtij ligji dhe të flas për tri segmente të këtij ligji, aspektin politik, juridik dhe atë kushtetues.

Vlerësoj se në aspektin politik është jashtëzakonisht pragmatike dhe e qëlluar që është proceduar ky projektligj. Ka një rëndësi të veçantë politike për faktin që Kosova përmes këtij projektligji po krijon kushte për vazhdimin e raporteve miqësore me Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Malit të Zi – dy shtete të ish Jugosllavisë, të cilat edhe e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Në anën tjetër, ne kemi pasur tradicionalisht këto dy komunitete të pranishme në Kosovë, tradicionalisht në Kosovë ka pasur një komunitet kroat, i cili jo në numër të madh, por ka jetuar tradicionalisht në komunën e Lipjanit, në qytetëzen e Janjevës dhe mendoj se me këtë ne po krijojmë kushte që jo vetëm ky komunitet të ketë mbrojtje kushtetuese, por të fillojë edhe procesi i kthimit të disa pjesëtarëve të këtij komuniteti të cilët janë shpërngulur pas luftës.

Gjithashtu, tradicionalisht ka jetuar edhe komuniteti malazez dhe për raportet ndër fqinjësore është jashtëzakonisht e qëlluar, duke pasur parasysh që edhe Kosova ka një komunitet bukur të madh në Kroaci dhe ka një komunitet jashtëzakonisht të madh edhe në Malin e Zi.

Në aspektin juridik, ligji është jashtëzakonisht i qartë, është shumë i shkurt por ka dy qëllime strategjike. Qëllimi i parë është që të japë mbrojtje legale dhe të njohë këto dy komunitete dhe, segmenti i dytë, që të sigurojë prani edhe përfaqësim të këtyre dy komuniteteve tek Këshilli Konsultativ i Komuniteteve, një organ kushtetues i cili është formuar si një zyre këshillëdhënëse e presidentit dhe është jashtëzakonisht mirë që pjesëtarët e këtyre dy komuniteteve, me hyrjen në fuqi të këtij projektligji do të kenë përfaqësim te ky organ konsultativ.

Segmenti i tretë, që unë do ta diskutoj, është segmenti kushtetues dhe miratimi i këtij ligji, hyrja e tij në fuqi automatikisht kërkon ndryshime kushtetuese. Kërkon ndryshime kushtetuese të nenit 64 i Kushtetutës së Kosovës, i cili nen ka listuar listën e komuniteteve tradicionale dhe ka përcaktuar mundësinë e përfaqësimit të tyre përmes të ashtuquajturave vendeve të rezervuara, përkatësisht tani vendeve të garantuara dhe ky ndryshim është i domosdoshëm për të mos krijuar edhe vakum në sistemin juridik. Komisioni që po punon në përgatitjen e amendamenteve, është i gatshëm që me një mandat shtesë, e si duket do të ketë nevojë për mandat shtesë që kjo çështje, ky ligj plotësisht të harmonizohet me Kushtetutën dhe ne të bëjmë ndërrime kushtetuese në mënyrë që ky projektligj të harmonizohet dhe këtyre dy komuniteteve t'u jepet edhe mbrojtja adekuate kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Bajrami!
I fundit është deputeti Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shumë shkurt. Ashtu siç tha edhe deputeti Neziri, e mbështesim në parim kalimin e këtij ligji. Ajo që unë dëshiroj të them është se në rastet kur marrim kesi projektligje, është mirë që të na vijjnë amendamentet për shkak se ndryshimi është shumë i thjeshtë dhe thjeshtohet puna e Kuvendit, edhe paraqitja të jetë e asisoj që të na tregojë se cila është gjendja ekzistuese, çka po duam të ndryshojmë në ligj dhe pse. Me siguri se në ato raste edhe debati në Kuvend do të jetë një debat i cili do të sillt rreth atij ndryshimi, a ka nevojë Kosova për atë ndryshim. Unë mendoj se Kosova në këtë rast ka nevojë ta bëjë këtë ndryshim, është traditë shqiptare për t'i pranuar ashtu siç janë të gjithë përfaqësuesit, qoftë pakicave, qoftë popujve tjerë, ashtu si e thirrën veten.

Çështje tjetër është, prapë te paraqitja. Në vazhdimësi paraqitjet e projektligjeve janë njëfarë logjike, thuaj se pse të thuhet thjeshtë, nëse kemi mundësi për ta komplikuar. Mendoj se duhet thënë shumë thjeshtë, të prezantohen thjeshtë ndryshimet që duan të bëhen për shkak se në ato raste Kuvendi ka mundësi të debatojë për thelbin e asaj çështje për të cilën po flasim.

Çështje tjetër është, edhe pse e mbështesim në parim këtë projektligj, profesor Bajrami para meje tha se ky ligj e determinon ndryshimin e Kushtetutës. Në aspektin kushtetues dhe juridik, e me siguri profesor Bajrami e di shumë më mirë se unë, është njëfarë forme gati e paradoksit kur ligji e determinon ndryshimin e kushtetutës.

Nuk është aspekt tradicional kushtetues, ndoshta nuk po zgjerohem më tepër në këtë çështje, po në vendet serioze nuk guxon ligji ta determinojë ndryshimin e kushtetutës, por vice versa, do të thotë përkundrazi! Faleminderit! Nuk pata qysh të mos i them këto vërejtje të mira! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gjini!

Nuk kemi të tjerë të paraqitur për të debatuar për ligjin, në lexim të parë. Ne dëgjuam në fillim që Komisioni i komuniteteve nuk ka referuar një mendim të veçantë për ligjin, por veç desha t'i kujtoj deputetët për të mos krijuar konfuzion që është e këshillueshme që para leximit të parë komisioni funksional të paraqet një mendim, por nuk është e domosdoshme, sepse është seanca e cila merr vendimin dhe voton në finale.

Unë tash pas këtij diskutimi, i jap shans përfaqësuesit të Qeverisë, nëse e do fjalën. Nëse s'e do fjalën, do të kalojmë në votim.

Zëvendëskryeministër, a e do fjalën? Bujar Bukoshi, e ka fjalën!

BUJAR BUKOSHI: Faleminderit!

Unë besoj se nuk është e vendit tash të hapet shumë debati për një çështje që është dhe ka shumë kontraverza, çështja e komuniteteve, pakicave, shumicave, e tjera. Ne jemi dëshmitarë se kjo punë ka qenë shumë e mundimshme dhe me shumë shtresime, por sa i përket aspektit politik, edhe unë do të përqendrohem vetëm në aspektin politik, pa këto teknikat e tjera, mendoj se duhet bërë një distinkcion shumë të qartë dhe të vendosur për interes të vendit të ndahen ato fenomenet kolaterale, dëmeve kolaterale në aplikimin e kësaj politike të bashkëjetesës me pakica.

Natyrisht, unë personalisht e kam idealizuar shumë modelin slloven, shteti slloven thotë, ai nuk thotë se është shtet multietnik, po thotë Sllovenia është shtet demokratik, në të cilin qytetarët e saj nuk ndihen të hendikepuar se i përkasin këtij apo atij kombi. Është fjala për minoritetin italian e tjera.

Unë e di dhe besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm për këto momente, po them me shtresime, por nga ana tjetër mesazhi politik do të jetë ai dhe është se Kosova e ka mekanizmin më të mirë në Evropë për mbrojtjen e komuniteteve në Kosovë. Në këtë drejtim nëse punojmë, mendoj se edhe me kohë do të vijë deri te lodhja e obstruksionit dhe obstruksioneve nga më të ndryshmet në abuzimin e këtyre të drejtave ose këtij diskriminimi pozitiv. Unë për veti kam qenë kur para se të kalojë ky propozim nga ana e Qeverisë që të futen edhe çerkezët aty, sepse ka edhe çerkezë në Kosovë. Disa kanë qesh me mua, por ka edhe çerkezë, ka pasur edhe hebrenj.... Jo, po flasim për ekzistencën tradicionale të këtyre komuniteteve. Më falni, a! Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër, faleminderit!

Në vazhdim, edhe teknika, edhe deputetët le të bëhen gati që të votojmë në parim për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/1-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Në sallë kemi 78 deputetë të pranishëm. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim, votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 16 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesë raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 02/L-8 për verërat

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Blerand Stavileci, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuari kryesueses i Kuvendit,

Të nderuar dhe të çmuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Në sektorin e vreshtarisë, në sektorin e hortikulturës është me rëndësi të veçantë për bujqësinë e vendit, sepse së pari kemi kushte shumë të favorshme pedologjike dhe agroklmatike për zhvillimin e këtij nën-sektori dhe, së dyti, kemi traditë shumë vjeçare në kultivimin dhe përpunimin e rrushit.

Duke përpunuar këtë kulturë bujqësore, ekzistojnë mundësi të mëdha për të prodhuar verëra të cilësisë së lartë, mirëpo për rritjen e mëtejme të kësaj prodhimtarie dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori përveç mundësive ekzistojnë edhe nevoja dhe pikërisht njëra prej tyre ka qenë plotësimi i zbrazësive ligjore për subjektet që ofrojnë shërbime për prodhimin dhe përpunimin e rrushit, si dhe për mbrojtjen e verës së prodhuar në nivel sa më të avancuar.

Për shkak të mangësive që kanë dalë në pah gjatë zbatimit të Ligjit Numër 02/L-8 për verëra, neve si Ministri na ka lindur nevoja për t’i shqyrtuar mundësitë alternative, duke plotësuar kornizën aktuale ligjore për ta bërë më të lehtë zbatimin e tij në vreshtarinë dhe verëtarinë e vendit tonë.

Në këtë kontekst, alternativa më e mirë ishte amendamenti i Ligjit Numër 02/L-8 për verëra, duke ndërmarrë veprime legislative që janë në vi me orientimin politik për vendosjen e ligjshmërisë në mënyrën më të mirë të mundshme për programin e politikave

zhvillimore në prodhimin, përpunimin dhe qarkullimin e rrushit të verës si dhe nën-produkteve të tjera të tyre.

Në këtë aspekt, vlen të theksohet se nëpërmjet riformulimit të nenit 2, i cili përshkruan verën në paragrafin 1, thuhet që, citoj: “Vera nënkupton prodhimin ushqimor bujqësor të fituar ekskluzivisht nga fermentimi alkoolik i tërësishëm apo i pjesërisht të rrushit të freskët dhe pemëve frutore të bluara, të pa bluara apo mushtit të rrushit” dhe nëpërmjet këtij riformulimi krijohet mundësia që vera deri në shkallën 14% alkool të lirohet nga akciza që ka qenë kërkesë e vazhdueshme e të gjithë hisedarëve në këtë sektor.

Qëllimi i këtij projektligji është të adresojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kompletimin e strukturës ligjore të përafuar me atë të Bashkimit Evropian.

Ekspertët që kanë punuar në hartimin e këtij plotësim-ndryshimi, kanë bërë hulumtime dhe konsultime me hisedarë të ndryshëm në këtë fushë dhe konsiderojmë që miratimi i tij është në interesin e përgjithshëm të zhvillimit të bujqësisë në vendin tonë.

Dhe, besoj të gjithë pajtohem, se hyrja në fuqi e këtij projektligji do të krijojë mundësi të reja që potenciali zhvillimor i kësaj fushe të shfrytëzohet me efikasitet më të madhe ngase rregullimi ligjor është në pajtim me praktikën më të mirë për prodhimin, përpunimin e verërave.

Është e nevojshme gjithashtu të sqaroj para jush, deputetë të nderuar, se për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore të cilat do ta ngarkonin buxhetin e vendit tonë, sepse organet e parapara për themelimin e tanimë veç ekzistojnë dhe nuk nevojitet plotësimi i tyre me resurse shtesë njerëzore. Përkundrazi, zbatimi i tij do të gjenerojë mjete të konsiderueshme për buxhetin e vendit tonë, prandaj hyrja në fuqi e këtij projektligji ka ndikime pozitive të shumta dhe shpresoj në vlerësimin tuaj të drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti ministër, faleminderit!

Të nderuar deputetë, tash do të fillojmë debatin për Ligjin, në parim. Kryetari i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani e merr fjalën.

NAIT HASANI: Përsëritje, kryesues!

Ministër, zëvendëskryeministër,

Komisioni për Bujqësi, Mjedis në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23. 5. 2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 02/L-8 për verëra dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqes këtë rekomandim.

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 02/L-8 për verëra.

Mendoj që ky ligj ka pasur nevojë të vihet, sidomos për stimulimin e bujqve tanë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hasani!

Tash do të dëgjojmë paraqitjet e kryetarëve të grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e këtyre grupeve. Për Grupin e PDK-së, deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj ndër të tjera do të rregullohet prodhimi, qarkullimi, përpunimi i rrushit për prodhimin e verës, prodhimin dhe kushtet së vënies në qarkullim të verës dhe nën-produkteve tjera.

Vera definohet si produkt bujqësor ushqimor, përcaktohet prejardhja e mbrojtur gjeografike, përcaktohen institucionet bartëse për menaxhimin dhe implementimin e këtij ligji, këtij Projektligji, përcaktohen rajonet vreshtare të Kosovës, përcaktohen kriteret për klasifikimin dhe vlerësimin e verës bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Verës, përcaktohen rregullat e tregtimit të rrushit të verës dhe prodhimeve tjera, rregullon fushën e kontrollit të kualitetit të verës, rregullon regjistrin e kultivuesve të rrushit dhe prodhuesve të verës e tjerë.

Kërkesa për plotësim-ndryshimin e Projektligjit për verëra ka për qëllim harmonizimin e këtij legjislacioni tonë të vreshtarisë dhe verarisë me Rregulloren ekzekutive të Bashkimit Evropian.

Me plotësim-ndryshimin e këtij projektligji do të arrihen këto përfitime: do të hiqet akciza për prodhuesit vendorë të verës; do të shtohet interesimi për mbjellje të varieteteve të rrushit për verëra kulminante, për të cila ne kemi shumë nevojë; do të bëhen ngritje të kontrollit të kualitetit të verës; do të rritet konkurrenca edhe me importin.

Me këtë projektligj 5.000 fermerët pronarë të 3.100 hektarëve me rrush dhe 13 kompani të licencuara prodhuese të verës do t'ju bëhet e mundur që të konkurrojnë më mirë në tregun e konkurrencës së lirë. Ata do të sfidohen në shtimin e sipërfaqeve me vreshta, shtim të eksportit të verës së ambalazhuar, ngritje të kontrollit të kualitetit të verës, shkollimin dhe aftësimin e njerëzve të tyre për prodhim e tjera.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet në parim këtë projektligj dhe si të tillë do ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Sali Morina.

SALI MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për verëra dhe përmes këtij ligji ka paraparë që do të rregullohen çështjet të cilat janë me prioritet për prodhimin, qarkullimin dhe përpunimin e rrushit, për prodhimin e verës dhe produkteve të saj.

Ky ligj deri më tani nuk ka pasur implementim të plotë për shkak të mangësive që kanë ekzistuar për një zhvillim të qëndrueshëm të prodhimeve dhe qarkullimit si dhe përpunimit të rrushit. Unë do të doja të shtoj edhe për shkak të mungesës së buxhetit, sepse ne kemi shumë ligje të aprovuara, por janë të pa implementueshme. Përmes këtij ligji do të thotë përcaktohet komuna e zonave, vreshtave, lloji i rrushit si dhe cilësia e rrushit. Sipas deklaratës financiare nga MEF-i, ky ligj nuk kërkon mjete buxhetore shtesë, është në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2011/2013 dhe si i tillë do të thotë vlerësohet i përballueshëm.

Ne si grup parlamentar do të japim kontributin tonë në kuadër të komisionit deri në amendamentimin e tij dhe e rëndësishme e këtij ligji është do të thotë heqja e akcizës, sepse stimulon kryesisht prodhuesit e vreshtave në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu!

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për verërat është i domosdoshëm. Ligji aktual ishte pengesë e prodhimit të verës në Kosovë. Ky ligj është një ndër shkaktarët e shumë që ndikoi që prodhimi i verës të mos arrijë të depërtojë në tregun madje edhe të brendshëm, e lëre më të huaj.

Ta zëmë, njëri nga elementet që i bëri dëm është trajtimi si pije alkoolike dhe jo si produkt ushqimor, e që ia shtonte akcizën e verërave dhe si të tilla ato dilnin me çmim të lartë në treg. Pastaj, mos përcaktimi i qartë i kontrollit të kualitetit të verës së importuar, në ligj etj.

Prandaj, është shumë e qartë nevoja për ndryshimin e ligjit i cili ndryshim dhe plotësim duhet shoqëruar pastaj me implementimin e këtij ligji, si dhe me politikat e shtetit në favor të prodhimit vendor, gjë që nuk është parë shumë herë të ndodhë deri tani.

Më se të qartë, këtë nevojë për ndryshim të këtij ligji e bën situata e rëndë në terren tek prodhuesit e verës dhe sidomos tek vreshtarët, për të cilët prodhimi i rrushit është profesioni dhe burimi i jetesës për shumë gjenerata.

Vjeshtën që shkoi, patëm edhe protestën e vreshtarëve, e cila përfundoi me përleshje me policinë dhe me të lënduar. Përfundoi me përleshje para bodrumit të verës, respektivisht pikës së grumbullimit të rrushit. Prodhuesit e rrushit ranë në konflikt me prodhuesit e

verës. Të dyja palët prodhues, në vendin ku prodhuesit nuk mbrohen, në vendin ku si në asnjë vend tjetër mbrohet tregu i prodhimit të jashtëm. Në shtetin me politikën që diskriminon prodhuesin e pazhvilluar e të pambrojtur vendor në raport me prodhuesin e fortë të jashtëm e të subvencionuar nga shtetet e tyre, dhe më avantazhin shumëvjeçar. Prodhuesit e diskriminuar dhe të pakënaqur vendor u gjenden përballë njëri - tjetrit. Dhe në këtë protestë, shteti me politikën e tillë gati mbeti e paprekur. Gati mund të themi që konflikti u bë në vendin e gabuar dhe në mes të palëve të gabuara. Këtë natyrisht e korrigjoi policia, duke e treguar prezencën e shtetit dhe forcën e tij.

Sidoqoftë, protesta e sensibilizoi problemin e rrushit, të verës, dhe e bëri temë. Aty ku protestohet, ka arsye të protestohet, lëviz diçka, dhe si rrjedhojë lëvizën gjërat.

Edhe për prodhuesit e rrushit dhe të verës po lëvizë diçka. Pra ndryshimi i këtij ligji është produkt i reagimit të protestuesve dhe mu për këtë është mjaft i vlefshëm. Edhe pse këta prodhues edhe këtë vit, ndoshta edhe vitin tjetër do të përballen me problemet e njëjta, edhe pse pasi së pari ky ligj që po shqyrtojmë sot do të jetë në fuqi pas grumbullimit të sivjetmë të rrushit dhe, e dyta, që mbrojtja e prodhimit të rrushit dhe verës nuk varet vetëm nga ky ligj.

Prodhimi i verës dhe rrushit varet shumë edhe nga implementimi i këtij ligji, nga subvencionet, promovimi institucional i prodhimit të verës e tjerë.

Shitja e verës është e kushtëzuar edhe nga implementimi i pjesës së ligjit për kontrollin e kualitetit të verës së importuar, e që parashihet në këtë ligj, nga kontrolli i vënies së banderolave në prodhimet e importuara e tjera.

Pra, që prodhuesit e rrushit dhe të verës të jenë të kënaqur dhe të përkrahur, nuk mjafton vetëm ky ligj, por edhe shumë faktorë të tjerë.

Prandaj, i lus prodhuesit e rrushit dhe verës të mos relaksohen shumë, sepse mbetet shumëçka të bëhet. Dhe kusht që të vazhdojë të lëvizë edhe më tutje diçka për ta, është që ata të jenë të gatshëm të lëvizin për veten e tyre. Ndryshe, ata do të mbesin çdo herë prodhues të diskriminuar.

Krahas përkrahjes nga grupi parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji - Ligjit për verërat, prodhuesve vendorë anekënd Kosovës u dëshirojmë gatishmëri, organizim dhe energji të mjaftueshme për të protestuar për të drejtat e tyre, sepse ashtu dhe vetëm ashtu i fitojnë ato. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, shefi i grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shumë shkurt. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet ndryshimin e këtij ligji.

Mendojmë se do të jetë një ndihmesë për të gjithë vreshtarët e Kosovës. Shpresojmë që të gjitha procedurat të kalojnë sa më shpejt, në mënyrë që implementimi po ashtu të jetë i shpejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Ardian!

Për Grupin Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Sevdije Lama!

SEVDIJE LAMA: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E përkrah këtë projektligj, sidomos nenin 2, paragrafi 1, i cili thotë: “vera nënkupton produkt ushqimor bujqësor”, duke nënvizuar rëndësinë e saj, duke u nisur nga përmbajtja në vitamina, në oligo-elemente ose edhe në hekur, si dhe përbërës të tjerë.

Nga ana tjetër, pasoja e lëndëve ushqyese të pranishme dhe të përdorura përherë nga popullsia përëndimore garanton gjerësisht edhe furnizimin me këta përbërës të paktë në numër dhe që gjenden te verëra.

Të dhënat epidemiologjike që janë bërë në kuadër të promocionit të dietës mesdhetare e lidhin konsumin e verës me një incidencë të ulët të infarktit të miokardit, mjekimin e anemisë, apo rritjes së sasisë së kolesterolit të dobishëm.

Verëra më shumë se çdo lloj pije tjetër mund të parashikohet të futet në shkencën dietetike, moderne jo për meritat ushqyese të veçanta, as për faktin e të qenit me virtyte për shëndetin, por thjeshtë për kënaqësitë e saj gastronomike, për kontributin, për cilësinë dhe rritjen e nivelit të jetesës, si dhe mënyrën se si konsumi i saj në sasi të kontrollueshme nuk arrin kurrë të bëhet një rrezik për shëndetin. Ndërkaq, vera nuk është një pije për të shuar etjen, as edhe për t’u bërë, për t’u shndërruar në një simbol shoqëror, është thjeshtë një ushqim që merret dhe shijohet së bashku me vaktet për të amplifikuar vlerën shijuese të ritit dhe të ushqyerit, por gjithmonë duke ruajtur masën.

Dhe, si përfundim, për arsyet që i ceka më lartë dhe pasi që ky projektligj e parasheh verën si produkt ushqimor, propozoj që t’i hiqet edhe akciza. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Për Grupin Parlamentar SLS, deputeti Sasha Millosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Samostalna liberalna stranka je razmotrila Nacrt zakona o vinu i mi ćemo u načelu podržati ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për Grupin Parlamentar “6+”, deputeti Albert Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuri zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+”, pas shqyrtimit të detajizuar të këtij projektligji mendon se ky projektligj për ndryshim dhe plotësim me Numër 02/L-08 për verëra i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme dhe të parapara me nenin 54 dhe në parim do ta miratojë atë duke pasur parasysh nevojën dhe domosdoshmërinë e tij për zbatueshmëri dhe duke shpresuar që së paku në të ardhmen do të përmirësojë kushtet e vreshtarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dëgjuam deklaratat e përfaqësuesve ose të shefave të grupeve parlamentare. Tash kalojmë në diskutimet e deputetëve. Deputeti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryesues!

Ligjin për verërat – projektligjin edhe në komision e kemi shqyrtuar, po në bashkëpunim me ekspertë të verës, të cilët merren me përpunim, ata na kanë pru edhe sugjerimet e veta për ndryshim ose amendamentim të Ligjit që e ka pru Ministria. Te ta kërkohet në disa fusha që Projektligji nuk i plotëson në mënyrë të mjaftueshme, që ne gjatë procesit të leximit në komisione, do të kërkojmë që këto pjesë të amendamentohen, por e para që është bërë është çështja, nuk është vetëm Ligji për verërat, por Ligji për akcizën është edhe ai që do t’i ndihmojë bujqit dhe këtu kërkohet që, meqë i kemi këtu dy ministrat, edhe të bujqësisë, edhe të financave dhe besoj se janë mirë duke kaluar këtu, që ta kuptojnë që vera është produkt ushqimor e si produkt ushqimor duhet t’i hiqet akciza, e për ta provuar verën, secili grup parlamentar i kanë nga dy paketa verë nëpër zyrat e veta, kështu që le të shkojnë ta provojnë a është produkt ushqimor dhe të na tregojnë se duhet të hiqet akciza.

Për këtë mund të them që në nenin 8.4 ka disa propozime – “të ndalohet dhe të hiqet për verën”, nuk duhet të thuhet “të ndalohet”, por duhet të thuhet “të lejohet”, duhet të bëhet përkufizimi i “rajonit gjeografik”, cili është “rajoni gjeografik”, duhet të përcaktohet sa kilometra është ajo pjesë.

Dhe në nenin 18.4, po ashtu është për gram për litër, plus 2 gramë, që nuk e tejkalon 9 gramë për litër.

Në vazhdim shtohet pjesa 18 gramë për litër, nëse acidet e përgjithshme, plus 10 nuk kalojnë 18 gramë për litër.

Kemi edhe jo renditjen e mjaftueshme të mirë të tipeve, të kategorive dhe të llojeve të verës, të cilët duhet dhe besoj që brenda komisionit me amendamente ose me ndryshime do të bëhet dhe të riformulohet më mirë.

Është me rëndësi që ky ligj ka ardhur dhe do t’i stimulojmë me këtë, besoj, bujqit të cilët do të dalin dhe do të jenë të kënaqur për këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

I fundit, për fjalë është paraqitur deputeti Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Në parim, e mbështes Projektligjin për arsye se me anë të këtij projektligji trajtohen në mënyrë të drejtë prodhuesit e verës, por gjithsesi domethënë duhet të harmonizohet me Ligjin Numër 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, do të thotë që në Aneksin A të këtij projektligji, domethënë duhet të hiqet vera si produkt apo mall i cili i nënshtrohet formës së akcizës, që mos të ndodh pasi ta miratojmë këtë ligj dhe njëri me ligjin tjetër të jenë në kundërshtim, dhe u tha që ligji, edhe më herët u tha edhe nga ministri që ligji është i planifikuar në kornizën afatmesme dhe nuk erdhi si pasojë këtu e asnjë presioni, por si pasojë e punës dhe për krijimin e kushteve më të mira për të gjithë prodhuesit e verërave.

Gjithsesi, gjatë shqyrtimit sigurisht që do të merren në konsideratë edhe prodhuesit e verërave dhe kjo do të jetë në kohezion gjithsesi të nevojshëm bashkërisht që të kemi një ligj vërtet të mirë dhe kushte më të mira për prodhuesit e verërave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk kemi më interes të deputetëve që të flasin për këtë projektligj. A e do fjalën ministri? Nuk e do fjalën ministri!

Atëherë, kolegë deputetë,

Duhet të përgatitemi që të deklarojemi me votim për miratim, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 02/L-8 për verërat.

Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Tash unë këtu po shoh, “për” janë 61 dhe 4 janë “kundër”, që i bie se janë 65 deputetë. Më jepni edhe një herë listën! Do të thotë, në parim Ligji kalon, për korrektësi po e lypj edhe një herë, a i kanë numëruar mirë a jo. Numërimi është mirë, por 2 vetë i kanë prekur sustat e huaja dhe mos e bëni më këtë, se nuk ka kurrfarë nevojë, për të mos thënë është shkelje e Rregullores së Punës në Kuvend!

Pra, të pranishëm janë 63 deputetë, këtu po votojnë 61 “për”, dhe 4 “jo”, kalon në parim dhe Kuvendi në parim e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 02/L-8 për verërat.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e mëhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime.

Tash është pushimi i drekës, deri në orën 15:00. Veç një moment! Ka njerëz që... A e doni deri në orën 15:00, apo 14:30? Atëherë, deri në orën 14:30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUES SABRI HAMITI: Lus deputetët të ulen, sepse do të vazhdojmë punën. Kemi kuorum për të diskutuar, besoj kur të vjen puna e votimit mbërrijnë edhe këta dembelët që s'janë këtu.

Pika e gjashtë e rendit të ditës, është:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisionit funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim, në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kjo iniciativë e Ministrisë së Financave është pjesë e strategjisë legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe në kuadër të strategjisë së reformave që ka marrë Qeveria për përsheptimin dhe përafrimin e legjislacionit tonë me atë të komunitetit evropian.

Në zbatim të kësaj strategjie Banka Qendrore e Kosovës, me asistencë teknike të ofruar nga Banka Botërore, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë hartuar Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm të auto-përgjegjësisë ndaj palëve të treta.

Deri më tani siguri i detyrueshëm në Kosovë ka qenë i rregulluar me Rregullore Numër 3 për sigurimin e detyrueshëm të auto-përgjegjësisë të Bankës Qendrore.

Sipas dispozitave të këtij rregulli, është rregulluar dhe ndërtuar tregu i sigurimeve të detyrueshme të auto-përgjegjësisë ndaj palëve të treta.

Nxjerrja e këtij ligji do të konsolidojë dhe avancojë bazën ligjore për tregun e sigurimit të detyrueshëm të auto-përgjegjësisë, kur dihet se deri më tani ky lloj siguri ishte rregulluar me akt nënligjor.

Qëllimi i këtij projektligji mbi të gjitha është ofrimi i mbrojtjes ligjore për polisë-mbajtësit dhe personat e dëmtuar si pasojë e aksidenteve të shkaktuara nga mjetet motorike. Në këtë funksion, Projektligji parasheh edhe krijimin e mekanizmave të posaçëm që bëjnë këtë ligj më të përshtatshëm dhe më të dobishëm për polisë-mbajtësit, përfutuesit, por edhe për palët tjera, siç është themelimi i Byrosë kosovare të sigurimit, krijimi i Fondit të kompensimit dhe themelimi i Qendrës informative të sigurimeve.

Në rrethanat e reja të krijuara në Kosovë është e domosdoshme që kjo fushë të rregullohet me ligj, i cili përcakton dispozitat e pajtueshme me standardet e pranuar ndërkombëtare, të themelohen mekanizma që janë të nevojshëm që Kosova të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare të sigurimit të auto-përgjegjësisë, siç është anëtarësimi në sistemin ndërkombëtar të kartonit të gjelbër.

Anëtarësimi në sistemin ndërkombëtar të kartonit të gjelbër do të ndikojë në lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe do të thjeshtësonte procedurat për kompensim dëmin nga palët e dëmtuara.

Sipas Projektligjit, pronari i regjistruar i mjetit motorik duhet që të lidhë kontratë regjistrimi për të siguruar mbulim të përhershëm ndaj përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara të palëve të treta për rastet e vdekjeve, lëndimeve trupore, dëmtimit të shëndetit apo dëmtimit të pronës të shkaktuar nga përdorimi i mjetit motorik.

Me këtë projektligj parashihet të themelohet Byroja kosovare e sigurimit, të cilës Qeveria do t'ia njeh statusin e Byrosë nacionale të sigurimit me të drejtat e pakufizuara si byro pagese dhe byro trajtuese.

Byroja, sipas këtij projektligji do të jetë person juridik, e themeluar për qëllime jo fitimprurëse. Byroja do të mbikëqyrë dhe do t'i raportojë Bankës Qendrore përkitazi me ushtrimin e autorizimeve që janë dhënë me këtë projektligj.

Projektligj parasheh krijimin e Fondit garantues, qëllimi i të cilit është garantimi i detyrimeve financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit të gjelbër dhe marrëveshjet tjera ndërkombëtare që rrjedhin nga kjo lëmi. Ky fond do të administrohet nga Byroja kosovare e sigurimeve.

Me këtë projektligj përcaktohen edhe situatat se kur duhet të përdoret ky fond. Po ashtu, projektligji përcakton themelimin e Fondit të kompensimit, i cili do të administrohet nga byroja dhe detyrimi i këtij fondi është kompensimi i dëmeve që shkaktohen nga mjetet motorike të pa siguruara, mjetet motorike të pasiguruara me regjistrim të huaj, mjetet motorike të pa identifikuar dhe dëmshpërblimi në rast të falimentimit apo likuidimit të kompanisë së sigurimeve dhe dëmshpërblimi i bazuar në sigurimin kufitar.

Parashihet themelimi i Qendrës informative të sigurimeve, qëllimi i së cilës është dhënia e statistikave të besueshme, standardizimi i praktikave, shmangia e rasteve të mashtrimit dhe realizimi i procedurave të dëmshpërblimit të palës së dëmtuar në kohën dhe masën e duhur.

Ky projektligj është në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, veçanërisht janë marrë për bazë direktivat e Bashkimit Evropian që kanë të bëjë me sigurimin kundër përgjegjësisë civile lidhur me përdorimin e mjeteve motorike.

Të nderuar deputetë, pas diskutimeve të juve, pas shqyrtimit të këtij projektligji në komisionet funksionale, pres që ky projektligj të bëhet, të begatohet edhe më tutje dhe ju lus që të njëjtin ta aprovojme. Faleminderit!

Drejtimin e mbledhjen e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të Projektligjit nga ministri, hap debatin për diskutime në parim. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta dhe e ka miratuar në parim.

Me këtë projektligj krijohet baza ligjore për sigurimin e detyrueshëm të auto-përgjegjësisë, përcaktimin e kriterëve dhe mekanizmave me anë të cilave u ofrohet mbrojtje palëve të dëmtuara dhe çka është e rëndësishme, është se tani kjo fushë e cila nuk ka qenë e rregulluar me ligj, po rregullohet më në fund me ligj, sepse ka qenë e rregulluar me rregullën 3 për sigurimin e detyrueshëm të auto-përgjegjësisë të nxjerrë nga Banka Qendrore e Kosovës, kështu që Komisioni megjithatë ka vlerësuar se ka nevojë për disa plotësime teknike, por edhe përmbajtjesore në disa nene të këtij projektligji, kështu që ne si komision do të punojmë intensivisht edhe me sponzorizuesin e këtij projektligji që t'i bëjmë përmirësimet e duhura dhe njëkohësisht me amendamente ky projektligj të bëhet më i avancuar.

Projektligji nuk përmban implikime buxhetore, po ashtu projektligji është në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, është i rregulluar drejt, sipas strukturës dhe dispozitave, kështu që Komisioni për Buxhet e Financa e ka miratuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta sepse ky projektligj i plotëson kushtet për t'u miratuar sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit, prandaj i ftoj të gjithë deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta dhe në parim e mbështesim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim nëpër komisionet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sali Asllani e ka fjalën!

SALI ASLLANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës të paraqes vërejtjet dhe sugjerimet ndaj këtij projektligji me rëndësi për funksionimin normal të obligimeve që dalin nga dëmet e shkaktuara prej automjeteve në raste aksidentale ndaj palëve të treta, gjegjësisht personave që pa fajin e tyre u shkaktohen dëm material apo jo material.

Mendoj që ky ligj ka qenë i domosdoshëm për të rregulluar këtë sferë e cila është objekt i shumë kontesteve në mes të palëve dhe funksionimi normal i këtij ligji do të kishte ndikuar pozitivisht edhe në uljen e kontesteve të shumta civile dhe dukurinë e ... si dukuri e njohur tek ne. Pra, zgjidhja e mirë ligjore, zbatimi i përpiktë i tij e bën të dobishëm në shumë fusha ligjin.

Kisha dashur që në fillim të them që përkundër disa vërejtjeve të vogla që kemi lidhur me saktësimin e disa neneve dhe paragrafëve që mund të bëhen në procedurën e amendamentimit të ligjit, konsideroj që ky ligj i përmbush kriteret e një ligji të punuar mirë me subjekt themelor - mbrojtjen e qytetarit nga gabimet e të tjerëve në trafik, që për dëme materiale mund të jetë shumë i përpiktë në kompensimin e dëmeve sipas nenit 12, ndërsa për dëmtime jo materiale gjegjësisht si vdekje, lëndimi trupor, fizik apo trauma psikike ky ligj, fatkeqësisht, vetëm mund të pretendojë që të ofrojë kompensim material, ngushëllues, por jo edhe kthim të gjendjes fillestare, sepse së paku jeta nuk mund të kthehet as me shifra marramendëse të kompensimit të çfarëdo fondi.

Që të jetë ky ligj edhe më i dobishëm dhe të mos lë vend për interpretim të ndryshëm, kisha dashur t'i jap disa vërejtje parimore, të cilat besoj se do të merren në konsideratë gjatë leximit të dytë, e ato janë:

Në kapitullin 5, në kapitullin - Dispozitat e përgjithshme, kisha dashur që, neni 5 ka të bëjë me vlefshmërinë e polisave të sigurimit, të precizohet në mënyrë të tillë që afati i polisës së sigurimit të jetë një vjeçar, aq sa edhe i regjistrimit të automjeteve, në mënyrë që të shmanget mundësia e qarkullimit të automjetet qoftë edhe për një ditë pa polisë të sigurimit.

Te po i njëjti kapitull, në nenin 11, që ka të bëjë me rastet përjashtuese nga mbulesa e sigurimit, kisha propozuar që të hiqen krejt nga teksti i mëtejme sepse janë vështirë të përkufizueshme pika 1 e nenit 11, pika 1.2, pika 1.3 dhe 1.4 për arsye se kisha dashur që vërtet të kem vëmendjen e juaj që të lexoj, mendoj se ka raste të një absurdi.

Domethënë, do të përjashtohen nga kompensimi pasagjerët që në rastin kur ata kanë ditur apo është dashur të dinë se drejtuesi i mjetit motorik ka qenë nën ndikimin e alkoolit apo të çfarëdo substance tjetër kimike në kohën e aksidentit.

Pastaj pika 1.3. Pasagjerët që ndodhen me vullnetin e vet në mjetin motorik me të cilin është shkaktuar incidenti, kur provohet nga siguruesi se pasagjeri ishte në dijeni se mjeti motorik drejtohej nga personi i autorizuar, i pa autorizuar ose i pa patentë shoferi. Kjo i bie me një përkthim tjetër që sikur pasagjeri sa herë të hip në autobus do të duhej të kërkonte lejen e shoferit, të vërej a është nën ndikimin e alkoolit, a është nën ndikimin e narkotikëve e tjera. Tash këto nene, sipas mendimit tim, do të duhej të hiqen fare dhe secili i aksidentuar do të duhej ta gëzonte beneficinin e kompensimit nga fondi.

Neni 20, që parasheh nga përdorimi i mjeteve motorike të pa identifikuara, që do të thotë fjala është për mjete motorike të cilat kanë shkaktuar aksident, por nuk janë kapur nga organet kompetente të trafikut, është në rregull që të kompensohen ato dëme, por gjithsesi kisha propozuar që afati i paraqitjes së dëmeve të jetë shumë më i shkurtër sepse më duket shumë normale që nëse dikujt i ndodh ndonjë dëm material apo ndonjë automjete i panjohur, të paraqes menjëherë që në patrullën e parë që has të policisë së trafikut dhe nuk do të duhej që ajo e drejtë të gëzohej për shtatë ditë ose dëmet e lëndimeve trupore të paraqiten në afat maksimum 7 ditë nga aksidenti, natyrisht, me mundësi që ato t'i paraqet edhe një i afërm i të lënduarit në policinë e trafikut, kurse paraqitjen e rastit në Byronë nacionale për mendimin tim do të mjaftonte vetëm një muaj e jo tre, sa parashihet në projektligj.

Këto i propozoj me qëllim më të mirë që procedura të jenë sa më të shpejta, më eficiente dhe më pak hapësirë për shfrytëzimit nga të pa përgjegjshmit.

Shumë çështje nga ky ligj i lihen të rregullohen me aktin nënligjor të cilat do t'i nxjerrë Banka Qendrore, që do të jetë edhe m mbikëqyrëse ligjore e funksionimit të strukturave të Byrosë nacionale dhe organeve drejtuese të saj, si Asambleja e përgjithshme e anëtarëve, Këshilli administrativ dhe drejtori ekzekutiv.

Do të dëshiroja që me përkushtim të njëjtë të punohet edhe në akte nënligjore, në mënyrë që të kompletohet një strukturë ligjore në lëminë përkatëse.

Këto ishin disa nga sugjerimet të cilat, sipas mendimit tonë, do ta bënin ligjin edhe më funksional, më të rezistueshëm ndaj interpretimeve subjektive dhe më të dobishëm për qytetarët si palë e tretë në një aksident të pa nxitur nga ata, e raste të tilla ka mjaft që pësojnë qytetarët tanë me një gjendje që kemi të komunikacionit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Po them në fillim që Lëvizja “Vetëvendosje” e përkrah në parim këtë ligj, këtë projektligj dhe konsiderojmë që është shumë i rëndësishëm një ligj i tillë, jo vetëm që t'i mbrojë qytetarët ose të garantojë dëmshpërblimin për qytetarët në raste të aksidenteve, po çka

është edhe më me rëndësi, konsideroj unë, është që të jemi shumë të kujdesshëm që përmes këtij ligji t’ia pamundësojmë edhe kompanive të sigurimeve që t’i dëmtojnë qytetarët, siç e dimë ne që ndodh, të them, jo vetëm në Kosovë, po në të gjithë botën. Natyrisht që ky ligj e mbulon vetëm një pjesë të fushëveprimit apo shërbimeve që i ofrojnë kompanitë e sigurimeve këtu në Kosovë, po ne e dimë që kjo e mbulon fushëveprimin ndoshta më voluminoz të ofrimi të polisave, për shkak se polisa e sigurimit ndaj palëve të treta TPL që quhet, është një ndër polisat ndoshta që më së shumti përdoret në Kosovë – polisa të sigurimit dhe rrjedhimisht ky është një ndër ligjet më të rëndësishme në këtë fushë.

Në vazhdim, do t’i jap disa prej vërejtjeve që i ka Lëvizja “Vetëvendosje” në nene të caktuara të këtij ligji dhe për të cilat natyrisht do të jemi domethënë aktivë edhe në komisionet përkatëse për t’i ndryshuar dhe argumentuar ato.

Po e nis prej pjesës së dispozitave të përgjithshme. Konsiderojmë që aty duhet të specifikohet se çka nënkuptohet me parimet e aktuaristikës në mënyrë që ta bëjmë ligjin sa më lehtë të interpretueshëm dhe të zbatueshëm, pra jo që t’i lëmë hapësirë interpretimit se çka do të kishin qenë ato parime. Ndoshta këto janë të njohura për persona të cilët merren domethënë ekskluzivisht me këtë çështje dhe të cilët e kanë aftësinë teknike dhe matematike për t’i kuptuar këto parime, po jo të gjithë personat që do të kenë ndesh me këtë ligj dhe që do të kenë punë me këtë ligj, do ta kuptojnë se çka është kjo.

Po ashtu, te neni 8, i cili specifikon kushtet dhe veprimin e sigurimit të detyrueshëm, konsiderojmë që në vend të gjuhës që është përdorur aty, ku thuhet që BQK ka kompetencë të nxjerrë rregulla që përcaktojnë strukturën e veprimit, konsiderojmë që këtu duhet të obligohet BQK-ja që të nxjerrë një gjë të tillë, përndryshe nëse BQK-ja nuk e bën një gjë të tillë, atëherë ua lë duart e lira kompanive të sigurimeve që ta caktojnë këtë dhe kjo paraqet një rrezik shumë të madh që kjo liri e kompanive të sigurimeve të shkon ndesh të interesit dhe të drejtave të qytetarëve.

Po ashtu, në nenin 4, pika 2 thuhet që policat lëshohen përmes sistemit online, që është në rregull, mirëpo konsiderojmë që ky sistem online do të duhej të përmbante edhe informata tjera për sa i përket domethënë veturave të siguruara, sa ai përket lirimeve që ato i kanë marrë në të kaluarën, historikut të përgjithshëm të siguruesit ose të siguruarin, më falni, në mënyrë që ai të jetë në cilën do kompani qoftë që shkon, ajo kompani të ketë qasje në këtë historik në mënyrë që të mund t’ia caktojë lirin nga çmimi i polisës.

Po ashtu, kemi te neni që specifikon procedurat e kërkesave për dëmshpërblim, neni 24 ose 25 mos gabofshim, do të duhej të shtohet edhe ndonjë dispozitë e cila iu lejon palëve të ushtrojnë të drejtën e ankesës dhe të ndërmarrin procedura ligjore për të realizuar të drejtat e tyre në rast se kanë pakënaqësi me dëmshpërblimin e ofruar nga siguruesi. Pra, kjo lidhet edhe me nenin 12 mbi kompensimin e dëmit, i cili konsideroj se e lë shumë të mangët domethënë të drejtat e të siguruarit karshi siguruesit, për shkak se këtu thuhet që palës së dëmtuar, që ka të drejtë në kompensim në pajtim me nenin 9, do t’i paguhet dëmi në shumë të mjaftueshme që ekonomikisht do ta kthente atë në situatën e ngjashme.

Ky nen nuk tregon qartë se kush është autoriteti vlerësues i këtij dëmi, domethënë kush e vlerëson në fund se a ka qenë i mjaftueshëm dëmshpërblimi apo jo, a është kjo kompania e sigurimeve a është një palë e tretë apo ndonjë institucion shtetëror. Konsideroj se është e rëndësishme që kjo të definohet.

Po ashtu, te neni 16, paragrafi 1, i cili thotë se secili person që hyn në territori në Kosovë me mjet motorik të regjistruar jashtë Kosovës, duhet të jetë i pajisur me sigurimin e vlefshëm prej njërit nga vendet që kanë marrëveshje bilaterale të sigurimeve me Kosovën. Pra, ne e dimë që ajo që po tentohet të rregullohet me këtë ligj, i ka shkaktuar shumë probleme Kosovës, veçanërisht u ka shkaktuar edhe probleme të mëdha mërgimtarëve – diasporës së Kosovës, të cilët janë obliguar të paguajnë nga 50 euro me të hyrë në Kosovë, sa herë që kanë ardhur në Kosovë me veturat e tyre, në ndërkohë që po ashtu e dimë që e njëjta pagesë nuk është aplikuar asnjëherë ndaj atyre që hyjnë me targa të Serbisë dhe të Malit të Zi në Kosovë, vëllimi i automjeteve i të cilave është mjaft i madh. Pra, vetëm sa për t dhënë një shifër këtu, në vitin 2008 janë shitur gjithsej 153.000 polisa kufitare, prej nga janë realizuar 10.9 milionë euro dhe nga kjo shumë, sipas BQK-së, janë paguar vetëm 1 milion euro dëmshpërblim. Kjo i bie që diku afër 9 milionë euro kanë qenë përfitim i kompanive të sigurimeve, që konsiderojmë se është shumë e madhe dhe kjo shumë prej 50 eurosh është caktuar arbitrarisht nga kompanitë e sigurimeve dhe kjo natyrisht se e ka dëmtuar tej mase qytetarin e Kosovës i cili jeton dhe vepron jashtë Kosovës.

Tjetër, te neni 28, i cili e parasheh themelimin e Byrosë kosovare të sigurimit, konsiderojmë që duhet të specifikohet një periudhë transitore, domethënë te dispozitat kalimtare, se kush e kryen këtë punë deri sa të themelohet ajo. Për shkak se me hyrjen në fuqi të ligjit, e dimë që ajo byro nuk mund të themelohet aq lehtë, pra duhet ta kemi një, ku ta di unë, organizatë apo dikush ta merr përsipër që t'i kryejë ato kompetenca për deri sa të themelohet byroja.

Po ashtu, ky projektligj duhet që ta rregullojë me ndonjë dispozitë apo më shumë dispozita, nëse ka nevojë, mundësinë e nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit me vendet tjera për t'i pranuar polisat e sigurimeve. Ne e dimë që deri tash e kemi të nënshkruar një të tillë me Republikën e Shqipërisë dhe memorandume të tilla kishim mund të nënshkruajmë edhe me shtetet tjera, Po ashtu, projektligji duhet të specifikohet shprehimisht se a do të vlejë dhe në çfarë mase, në çfarë mënyre do të vlejë parimi i reciprocitetit në mes të Republikës së Kosovës dhe shtetet tjera për sa i përket kësaj fushe, pra për sa i përket pranimin të polisave të sigurimit dhe ky parim i reciprocitetit është veçanërisht i rëndësishëm karshi disa shteteve të cilat nuk i pranojnë këto polisa.

Domethënë, këto ishin pak a shumë vërejtjet që i kemi ndaj këtij ligji dhe po ashtu po e përsëris prapë që ne në parim do ta votojmë këtë ligj, mirëpo presim që këto vërejtje të përfshihen në të. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Visar!

Në emër të Aleancës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Shkurt, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet këtë ligj, do ta votojë, në parim.

Mendojmë se është një ligj kompleks dhe materien e ka të punuar mirë. Në këtë rast i kisha sugjeruar ministrit që ai vetë ose dikush nga Ministria të jetë vazhdimisht bashkë me komisionet kur punojnë për shkak se ndryshimet eventuale mund të shkaktojnë lëvizje goxha të mëdha, se ligji është kompleks, do të thotë e ka një kompleksitet pak më ndryshe se ligjet tjera.

Zakonisht, unë nuk flas për gjuhën e ligjeve, mirëpo në këtë rast prapë nuk mundem të mos flas.

Titulli i ligjit është goxha i çuditshëm: “Projektligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta”. Do të thotë, ky titull më së pakti është shqip. Edhe nëse e lexojmë në anglisht, kush e flet anglishten, e shumica e flasim, në anglisht ka kuptim. Në shqip nuk e ka asnjë kuptim. Këto fjalët “ndaj”, dhe “nga”, më falni kështu që po qeshi, janë vendos goxha gabueshëm edhe te përkufizimet nuk e pash që shpjegohet çka është auto-përgjegjësia. Për shkak se është diçka që përmendet krejt kohën në ligj dhe përkufizimet nuk tregojnë çka është. Ligji ka të bëjë me sigurimin e detyrueshëm të automjeteve, se për automjete, për mjete motorike flet, të palëve të treta prej dëmeve eventuale, në anglisht thuhet shumë saktë, kështu që mendoj se nuk kanë nevojë ligjet që i prodhojmë ne të kenë titullin ekstremisht përshkrues se çka përmban ligji dhe të na komplikohet kështu. Edhe një herë po vijmë te ajo farë shprehja e famshme, pse ta bësh thjeshtë, kur mund ta komplikosh. Edhe ndoshta kishte për të qenë mirë të paktën komisioni në titull të punojë pak, mirëpo edhe një herë po them, materia e ligjit është punuar në rregull dhe si ligj kompleks e kërkon mbështetjen e vazhdueshme të ministrit në punë të komisionit dhe të provojë sa më tepër të sqarojë pse, cili do element është në ligj.

Edhe një herë, do ta votojmë në parim. Mendojmë se është një ligj i nevojshëm dhe kryesisht i mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Gjini! Në emër të Grupit Koalicioni Kosova e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Përsëndetje për të gjithë!

Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë projektligj. Konsideron se i njëjti është i rëndësishë së veçantë dhe e përkrah. Ka vend për ndryshime, për disa intervenime dhe në vazhdim do t'i japim disa vërejtje.

Përkritazi me emërtimin e ligjit, kemi dy alternativa. Njëri është - Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga përgjegjësia e pronarëve të mjeteve motorike për dëmet e shkaktuara palëve të treta, apo alternativa tjetër - Ligji mbi sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia.

Përkitazi me definimin e disa nocioneve, të përkufizimeve, propozohet riformulimi i nenit 2, i disa termave.

Në pikën 1. 3. Mjeti motorik, është mjeti që lëviz në tokë, me anë të fuqisë motorike, por jo mbi shina, rimorkio dhe gjysmë-rimorkio të bashkuara ose jo me mjet motorik tërheqës, për të cilat parashihet të regjistrohen dhe pajisen me dokument regjistrimi. Mjet motorik nuk konsiderohet mjeti me fuqi motorike i cili në momentin e dëmit është përdorë si mjet pune jashtë trafikut.

1.8. Pala e tretë. Personi fizik apo juridik të cilit i është shkaktuar dëmi dhe i cili sipas dispozitave të këtij ligji ka të drejtë në dëmshpërblim në baza të sigurimit të auto-përgjegjësisë.

Tek pika 1.12, është e shkruar shuma maksimale e sigurimit. Termi: “shuma maksimale e sigurimit”, nuk ekziston në sistemin e sigurimit të auto-përgjegjësisë dhe është në kundërshtim me përmbajtjen e kufizimit të mbulesës siguruese në shumë të sigurimit. Prandaj, e njëjta duhet të jetë shuma minimale e sigurimit. Do të thotë, kjo pikë duhet të jetë: “është shuma e sigurimit e përcaktuar si e detyrueshme, sipas këtij ligji, për kontraktim të sigurimit të auto-përgjegjësisë, që paraqet”. Tani mund të jetë detyrimi maksimal. Kjo është detyrimi maksimal i shumës minimale, do të thotë maksimal të siguruesit për dëmshpërblim nga një rast i siguruar, nëse nuk është kontraktuar shumë më e lartë e sigurimit.

Këshilli i byrove, pika 1.15. është organizata përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të kartës ndërkombëtare të sigurimit, në të cilën janë të detyruara të anëtarësohen të gjitha byrotë nacionale.

1.16. Karta e gjelbër e sigurimit, është certifikatë ndërkombëtare e sigurimit të auto-përgjegjësisë, të cilën e lëshon Byroja nacionale e sigurimit si provë për ekzistimin e sigurimit valid të auto-përgjegjësisë në territorin e shteteve anëtare të sistemit të kartës ndërkombëtare të sigurimit, e lëshuar në pajtim me modelet e aprovuara nga Këshilli i byrove.

Të shtohet pika 1.21. Byroja. Byroja e cila në këtë rast mendohet Byroja nacionale, e cila është Byroja nacionale e sigurimit të Kosovës, respektivisht organizatë profesionale e themeluar në kuptim të rekomandimit Numër 5 të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën.

Neni 3. Propozohet të ndryshojë në disa pika, deri sa pika 1, 2, 3 të riformulohet, pika 4 dhe 6 gjithashtu të riformulohet, deri sa të shtohet një pikë që do të jetë pika 5 dhe do të jetë kështu: “Me sigurimin e auto-përgjegjësisë mbulohen edhe dëmet e shkaktuara palëve të treta nga drejtuesi i pa autorizuar i mjetit motorik, duke i njohur siguruesit të drejtën e regresit ndaj personit përgjegjës”.

Propozohet një dispozitë e re lidhur me përcaktimin e kategorisë së personave tjerë të siguruar, më se e nevojshme që në vetë ligjin të përcaktohet rrethi i personave me status të të siguruarit, respektivisht që gëzojnë mbulesë nga sigurimi i auto-përgjegjësisë. Propozohet, do të thotë, teksti i nenit të ri: “personat tjerë të bashkë-siguruar” i cili do të jetë: “Sigurimi i auto-përgjegjësisë ofron mbulesë siguruese edhe për dëmet e shkaktuara prej personave tjerë të cilët me pëlqimin e pronarit përdorin mjetin motorik”.

Neni 4, propozojmë që pika 2 të fshihet. Është plotësisht e pakuptimtë që me dispozita ligjore të rregullohet teknika e sistemit online, e që kufizon çdo lloj apo formë tjetër të administrimit të sistemit me një normë imperative.

Pastaj, në pikën 3, thuhet “polisa e sigurimit duhet të jetë unike në territorin e Republikës së Kosovës”. Termi “duhet” ne propozojmë që të jetë “mund”, në vend të fjalës “duhet” do të thotë të shënohet fjala “mundet” dhe këtë nga arsyeja që t’i jepet mundësia e instalimit të polisës unike kosovare TPL, që me akte nënligjore mund ta trajtojë BQK-ja, por mos të jetë imperativ. Nëse do të mbetej si detyrim, do të kufizonte mundësinë që mund të jetë kërkesë e kohës që polisa TPL nuk duhet të jetë unike, pasi që e tillë mund të paraqitet si pengesë për konkurrencë të lirë në treg.

Neni 5. Vlefshmëria e polisës. Kjo dispozitë, respektivisht neni 5 të fshihet në tërësi si i panevojshëm, pasi që kjo çështje lidhur me vlefshmërinë e kontratës së sigurimit është rregulluar me nenin 922 të LMD-së.

Dispozita e nenit 6 propozohet të riformulohet, duke paraparë mundësi për automatizëm dhe vazhdimin e kohëzgjatjes së sigurimit me rastin e ndërrimit të pronarit. Me këtë thjeshtësohet procedimi i mbulesës siguruese dhe e vlefshmërisë së kontratës me interes si për të siguruarit, ashtu edhe me siguruesit.

Më tutje, me këtë zvogëlohet mundësia e rritjes së numrit të rasteve të pa siguruara për shkak të rregullimit të komplikuar të raportit juridik në rast të ndërrimit të pronarit.

Neni 6. Bartja e pronësisë. Në rast se ndryshon pronësia e mjetit motorik gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe detyrimet nga kontrata e sigurimit i kalojnë pronarit të ri dhe vlejnë deri në përfundimin e kontratës së sigurimit, nëse nuk është kontraktuar ndryshe.

Neni 9, propozojmë të fshihet në tërësi. Ky tekst i referohet mbulesës siguruese veç të trajtuar në dispozitat përkatëse të nenit 3 të draftit.

Neni 10, propozojmë që të fshihet. Është i inkorporuar në dispozitat përkatëse që i referohen dëmshpërblimit në nenet përkatëse.

Përndryshe, dispozitat e nenit 10 të draftit janë të panevojshme, konfuze dhe pjesërisht të pa kuptimta.

Nocioni i institutit më të rëndësishëm në këtë lëmi, pala e tretë, është formuluar në mënyrë jo të saktë dhe me disa gabime dhe ka nevojë që të intervenohet për të eliminuar

kontekstet në zbatimin e ligjit dhe vërejtjet për ligj të pa harmonizuar me direktivat e Unionit Evropian.

Neni 11. Përjashtimet nga mbulesat siguruese, janë disa pika të cilat janë përfshirë, mirëpo të njëjtat nuk janë edhe aq të sakta, prandaj të njëjtat duhet të riformulohen.

Dispozitat e nenit 12 duhet të fshihen si të panevojshme dhe pjesërisht të pa sakta në formulim, që si e tillë krijon konfuzion në zbatimin e ligjit përkitazi me mbulesën siguruese, përndryshe është i nënkuptueshëm principi resitutio përkitazi me kompensimin e dëmit material, por jo edhe të atij jo material – satisfaksion, sipas parimeve themelore të zhdëmtimit konform dispozitave të LMD-së.

Në dispozitën e nenit 13, është më se e nevojshme të intervenohet lidhur me lartësinë e mbulesës siguruese, shumës minimale të sigurimit, limitit. Për dëmin në persona të dëmtuar ende figuron limiti 100.000 euro, plotë 10 vjet në Kosovë. Përndryshe, shuma e përmbledhur prej 1 milion euro dihet fare mirë është vetëm konstruksion dhe improvizim i një pasqyre të rrejshme të mbulesës reale siguruese në Kosovë.

Sugjerohet të aprovohet edhe inkorporohet në draft propozimi inicial i grupit punues të BQK-së, i cili parasheh shumën unike minimale siguruese për dëmin në persona prej 1 milionë euro dhe në pasuri prej 200.000 euro. Kjo duke marrë parasysh rrethanat sociale-ekonomike në Kosovë, arsyeton por edhe tregon për përpjekje që Kosova bën për integrim dhe përafrim dhe harmonizim të legjislaturës së vet me atë të Bashkësisë Evropiane.

Për këtë moment, propozohet shuma minimale siguruese më të vogla nga ato që rekomandohen me direktivën e Bashkësisë Evropiane, e cila parasheh shumën prej 5 milionë euro për dëme në persona dhe 1 milionë euro për dëme në pasuri, por jo dhjetë herë më të vogla siç është përcaktuar në draft.

Nuk kuptohet si mund të flitet për harmonizim me legjislaturë evropiane, kur me draft parashihen shuma minimale siguruese deri dhjetë herë më të vogla se sa janë të parapara në direktivë.

Neni 13, tek përkufizimi i mbulesës siguruese – limitet e sigurimit. Do të thotë, pika 1. propozojmë të jetë “Detyrimi i siguruesit nga kontrata e sigurimit të auto-përgjegjësisë është e kufizuar me shumën e detyrueshme të sigurimit të vlefshëm në ditën e aksidentit....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Po ua tërheq vërejtjen, ligjin jemi duke e miratuar në parim, mendoj që diskutimet duhet të jenë në parim. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, uvaženi predsedniče.

Gospodine ministre,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmatrala Nacrt zakona o obaveznom osiguranju u saobraćaju i idgovornost prema trećim licima. Smatramo da zadovoljava sve kriterijume za njegovo usvajanje u načelu i kao Grupa mi ćemo glasati za isti.

Međutim, u cilju poboljšanja samog teksta, mi bi dali nekoliko primedbi. Prva primedba se odnosi na slovne greške pa predlažemo da se pročisti ovaj tekst Nacrta zakona. Ponoviću, recimo u članu 2. stav 1.4. "Vlasnik motornog vozita", trebalo bi „vozila“ i tako redom, i tako redom.

Smatramo da u članu 9. umesto reči „osiguravalac“ da stoji reč „osiguravač“, to je adekvatnija reč koja odražava kompaniju koja se bavi ovim poslom.

Takođe u članu 1.13 reč „prim“ trebalo bi zameniti rečju „premija“. To isto važi i za član 8. gde stoji „uslovi i prim obaveznog osiguranja“, znači u mesto reči „premija“. To bi bilo mnogo značajnije, i u cilju razjašnjavanja ili pojašnjavanja samog ovog člana vezanog za osigurani slučaj, smatramo da prethodno treba da se objasni šta je osigurani rizik, jer se u stvari mi osiguravamo od rizika nečeg neizvesnog u budućnosti i to bi nam pomoglo kasnije da shvatimo šta bi se podrazumevalo pod rečju odnosno pod značenjem šta je to "osigurani slučaj".

Ponavljam, mi ćemo kao Parlamentarna grupa podržati ovaj nacrt zakona u načelu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, Mursel. Fjalën e ka në emër të Grupit "6+", deputeti Rasim Demiri!

RASIM DEMIRI: Hvala, prededniče!

Na osnovu procena i analiza koje smo izvršili, Nacrt zakona o obaveznom osiguranju auto-odgovornosti je u potpunom skladu sa najboljim međunarodnim praktikama.

Parlamentarna grupa "6+" podržava Nacrt zakona o baveznom osiguranja auto-odgovornosti prema trećoj strani. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë, do të thotë shkojmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Në sallë kemi 64 deputetë dhe votojmë tash:

Me 61 votë "për", asnjë "kundër", asnjë "abstenim", Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta.

Kërkohet nga komisionet funksionale dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, të prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në fushën e legjislacionit për këtë vit, ne kemi paraparë që rregulloret e UNMIK-ut, të cilat ende janë të zbatueshme në Kosovë, në fushën e financave, të shfuqizohen dhe të zëvendësohen me legjislacion të ri në përputhje me Kushtetutën e Kosovës.

Një ndër to, është edhe draftligji për akcizën e produkteve të duhanit, i cili sot është paraqitur për aprovim në këtë seancë. Ne kemi draftuar këtë projektligj me qëllim të rregullimit të pagesës së tatimit të akcizës në produktet e duhanit, që është prodhuar, importuar dhe shitur në territorin e Republikës së Kosovës.

Kjo fushë deri me tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/23. Nxjerrja e këtij ligji, do të konsolidojë dhe avancojë bazën ligjore, fushën e akcizës, si një tatim i veçantë. Po ashtu do t'i eliminojë shumë të meta dhe vështirësi që i ka sjellë bizneseve Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2003/23. Me qëllim të hartimit të një projektligji kualitativ kemi pasur dhe kemi komunikim me komunitetin e bizneseve, gjatë draftimit kemi për bazë edhe komentet e tyre.

Mund të them se bashkë me këto subjekte, kemi ndërtuar projektligjin që sot e prezantojmë para jush, dhe ky komunikim do të vazhdojë edhe gjatë diskutimeve, shqyrtimit të këtij ligji në komisionet funksionale.

Me Projektligjin për akcizën në produkte të duhanit kemi rregulluar: procedurën e blerjes dhe vendosjes së pullave fiskale, si një mjet identifikimi dhe dëshmimi të pagesës së tatimit të akcizës në produktet e duhanit, momentin e lindjes së borxhit të akcizës, momentin e inkasimit të taksës të akcizës, i cili do t'i pasojë ndryshimet e mëdha nga e kaluara. Në të kaluarën tatimi i akcizës është inkasuar apriori, para se malli të arrijë te pronari. Kjo mënyrë e inkasimit të tatimit të akcizës nuk ka qenë dhe nuk është në frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Direktivat e Bashkimit Evropian për tatimin e akcizës në produktet e duhanit.

Tani, me projektligjin e ri, momenti i inkasimit të tatimit të akcizës do të jetë në momentin e doganimit të mallit për importues, ndërsa për prodhues, në momentin e nxjerrjes në treg. Kjo mënyrë e inkasimit do të jetë një lehtësim i madh për importues dhe prodhues dhe do të jemi në harmoni me konventën dhe direktivat e lartcekura. Ky është një sinjal i mirë që dërgojmë te investuesit e huaj të kësaj industrie.

Po ashtu, ne jemi kujdesur dhe kemi draftuar projektligjin në atë frymë, që nëse malli, produktet e duhanit për të cilin është paguar tatimi i akcizës, është shkatërruar në mbikëqyrje të Doganës, për arsye ligjore apo është eksportuar nga Kosova, tatimpaguesit të akcizës, do t'i kthehet shuma e paguar në emër të tatimit të akcizës të produkteve të duhanit.

Mënyra e lirimit nga tatimi i akcizës, është rregulluar në përputhje me Konventën e Vjenës, për privilegje dhe imunitet dhe direktivat e Bashkimit Evropian për lirime. Me projektligj kemi paraparë edhe masat e mbikëqyrjes doganore dhe sanksionuese të ashpra në rast mospërfilljes së dispozitave ligjore, duke marrë për bazë rrezikun që ekziston nga shmangia e pagesës së tatimit të akcizës në produktet e duhanit.

Të nderuar deputetë,

Siç e paraqita më lart, ky projektligj është në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, veçanërisht janë marrë për bazë direktivat e Bashkimit Evropian, që kanë të bëjnë me tatimin e akcizës në produkte të duhanit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, propozoj që ta aprovoni këtë akt me vlera të veçanta që rregullon të drejtat dhe obligimet e subjekteve që importojnë dhe prodhojnë produktet e duhanit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hap debat për diskutimin në parim. Sipas rendit, fjalën e ka kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit dhe është i mendimit se ky projektligj u jep zgjidhje shumë problemeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e akcizës dhe në njëfarë mënyre i është përfruar edhe legjislacionit të bashkësisë evropiane. Megjithatë, në këtë projektligj ka nevojë për disa ndërhyrje, në disa nene, siç janë neni 2, neni 11, neni 12, 15, 16, ka nevojë për disa përmirësime të cilat duhet bërë në këto nene. Besoj që në bashkëpunim edhe me sponzorizuesin, pra me Ministrinë e Financave, ne do të analizojmë nen për nen këtë projektligj dhe në bashkëpunim me ta edhe do t'i bëjmë përmirësimet e duhura.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, është i mendimit që ky projektligj i plotëson kushtet të cilat i parasheh rregullorja e punës së Kuvendit dhe e ka miratuar në parim dhe i rekomandon Kuvendin që ta miratojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e kryetarëve ose e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit dhe për lexim të parë, e përkrahim në parim. Vërejtjet dhe sugjerimet tona për këtë projektligj, do t'i japim nëpër komisionet parlamentare dhe grupet punuese. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që u tha më herët nga ministri lidhur me projektligjin që ka për qëllim vënien e akcizës në produkte të duhanit që prodhohen, importohen ose që tregtohen brenda Republikës së Kosovës, është një gjë e mirë që më në fund Rregullorja e UNMIK-ut, zëvendësohet me ligjin tonë.

Ligji në përgjithësi ka një strukturë të mirë, të qëndrueshme, përbëhet prej 25 neneve, që kanë të bëjnë me sanksione dhe 2 nene që kanë të bëjnë me dispozitat kalimtare, që faktikisht e shfuqizojnë Rregulloren e UNMIK-ut. Grupi Parlamentar i LDK-së, do ta mbështesë këtë projektligj, por unë isha ndalur në disa momente që kanë të bëjnë, ndoshta një ndërhyrje që është dashur të bëhet në dy-tri nene, sidomos te neni 4, ku mendoj se klasifikimi i duhanit që përcaktohet në kategori, duhet të jetë pjesë e ligjit, ndërsa pjesa e akteve nënligjore, mund të jetë ndarja e nën këtyre kategorive. Ndërsa te neni 7, që ka të bëjë me lindjen e detyrimeve të akcizës, konsideroj që paragrafi 1.3 dhe 1.4 që ka të bëjë me importin e paligjshëm dhe shitjen e paligjshme, ka të bëjë me çështjen që është, do të duhej konsiderohet vepër penale dhe një vepër penale sanksionohet sipas Kodit Penal dhe kur të rregullohet në aspektin administrativ, ai produkt i paligjshëm i nënshtrohet akcizës sikur produktet e rregullta.

Ajo që është më delikate në kreh të këtij ligji, konsideroj duhet të jetë neni 16, lidhur me çështjen e banderolave. A duhet të jetë çmimi në shitje në këto banderola, apo nuk duhet të jetë? Arsyeja është kjo: nëse është vu çmimi në banderolë dhe ajo sasi e mallit nuk është konsumuar dhe ka ardhur në treg një sasi e mallit tjetër, i produktit të njëjtë, domethënë me një çmim të ri, atëherë mund të krijojë konfuzitet në treg. Kjo mund t'i sjellë shumë telashe edhe konsumatorit, por i sjell telashe edhe prodhuesve edhe shitësve të duhanit. Mirëpo, duhet të kemi parasysh që buxheti përbëhet nga një sasi goxha e madhe, pikërisht nga akciza e duhanit dhe nga shitja e duhanit, prandaj duhet

të gjejmë, mendoj variante alternative që kjo të jetë më e pranueshme dhe të marrim praktika më të mira nga shtetet të cilat vetëm e kanë rregulluar këtë çështje. Dhe ato që i tha kryetarja e Komisionit edhe disa nene tjera që më tepër ka nevojë për një renditje më të mirë të kuptimit të këtyre neneve, për arsye se edhe disa nene vetëm janë të rregulluara në Ligjin për duhanin. Unë konsideroj që ligji do të kalojë dhe do të jepet kontributi në Komisionin funksional. Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e përkrah në parim këtë ligj për akcizën në duhanin. Ato vërejtjeje që i kemi ne, që janë vërejtje ndoshta teknike kështu, do t’i paraqesim në komision. Unë po ndalem vetëm te një çështje këtu, që është e përmendur në ligj, por edhe njëfarë... që është një çështje që po na përcjell në secilën fushë të ekonomisë e ko është barazimi i importit me prodhimin vendor, gjë që është dëshmuar të jetë shumë i dëmshëm për zhvillimin ekonomik të vendit, për shkak se po e mbyt prodhimin. Edhe me këtë rast e kemi që akciza i aplikohet njëjtë sikur duhanit të prodhuar brenda Kosovës, sikur duhanit që importohet. Kjo mungesë ose kjo fshehtësi në zbatimin e taksave, pavarësisht a është prodhim vendor apo prodhimi që vjen nga jashtë, e ka dëmtuar rënd prodhimin vendor për shkak se këtu po shohim që prodhuesit vendor po kanë shumë vështirësi, në mënyrë që të përballen me konkurrencën që po iu vjen nga jashtë e nuk po kanë kurrfarë mbrojtje prej shtetit, kështu që konsiderojmë që, domethënë në përgjithësi kjo çështje duhet të ndryshojë e veçanërisht në këtë ligj kur dihet që Kosova, megjithatë e ka një potencial dhe një historik të mirë të prodhimit të duhanit, që kishte mundur të kthehet prapë si një sektor shumë i rëndësishëm i zhvillimit bujqësor, por edhe industrisë së lehtë në vend. Dhe, po që se vazhdojmë ta mbysim kështu me tatime të njëjta, si prodhimin vendor, si atë që e blejmë nga jashtë dhe, natyrisht që ai që vjen nga jashtë, do të fitojë karshi këtij vendor dhe ne do të shndërrohemi në një shoqëri sikurse jemi tash vetëm konsumuese, pa kurrfarë prodhimi, pra pa kurrfarë ekonomie dhe në varfëri të vazhdueshme. Kaq kisha për këtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Aleancës, deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e mbështet në parim votimin për Ligjin në akcizën për produktet e duhanit. Janë disa çështje, të cilat mendojmë se duhet të shtjellohen gjatë punës në komisione. Çështja e parë, ka të bëjë me një pyetje të thjeshtë në ligj përdoret termi: “Territor doganor i Republikës së Kosovës” dhe është mirë që të shpjegohet edhe pse është e qartë terminologjia, të shpjegohet se a përputhet territori i Republikës së Kosovës në territorin doganor të Republikës të Kosovës, do të thotë a janë kongurent, nëse përputhet, atëherë duhet ditur pse përdoret

termi: “territor doganor”, dhe që të mos kemi dilema se mund të na ndodhë ndonjë mospërputhje në mes këtyre dy territoreve, atij doganor dhe të Republikës.

Çështje tjetër është se ne, në legjislaturën e kaluar, e kemi kaluar Ligjin për duhanin dhe në ligjin për duhanin janë disa nene të cilat mund të bien ndesh me disa nene që janë përmendur në Ligjin për akcizën në produktet e duhanit dhe mendoj se Komisioni parlamentar, duhet që të ketë kujdes që këto dy ligje të jenë në harmoni. Kemi të bëjmë me nenet ku përmendet shitja e produkteve të duhanit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe grupi ynë parlamentar e mbështet në leximin e parë Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit dhe ne konsiderojmë se në trajtimin e mëtejshëm, duhet të shihet kjo çështja e banderolës dhe e vënies në pah të çmimit me pakicë, për arsye se mund të krijohet pra, do të kemi dy çmime, një çmim për stoqet e pa shitura të produktet ekzistuese dhe çmimin tjetër, kështu që duhet të shihet se si të rregullohet ky problem në procedurën e mëtejme. Ne e shohim këtë si një nga çështjet e rëndësishme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit SLS, Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke u načelu podržava Nacrt zakona o akcizi na duvanske proizvode. Ovaj Zakon je neophodan i smatramo ga veoma bitnim za naše društvo. Kao što sam već rekla, mi ćemo ovaj Nacrt zakona u načelu podržati, a svoje dodatne doprinose i primedbe uložićemo kroz dalje razmatranje i u komisijama. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit “6+” Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nacrt zakona koji je pred nama ima za cilj posebno plaćanje akcize na duvanske proizvode, koji se proizvode, uvoze, prodaju u naše carinsko područje. Ovim zakonom se utvrđuju pravni odnosi koji se odnose na definisanje akcize na duvanske proizvode, uslove, procedure, prava i obaveze poreskih obveznika u vezi akcize. Zakon uređuje i pitanje vezano za prikupljanje, administrovanje akcizne takse na druvanski proizvod od strane poreskih i carinskih organa Republike Kosova.

Ovakav zakon je krajnje potreban zato što nemamo nijedan zakon koji reguliše akcize na duvanske proizvode i sve druge pojedinosti vezane za nju. Parlamentarna grupa „6+“,

podržaće Nacrt zakona u načelu i glasaće za njega, a sve sugestije koje su evidentirane dostaviće funkcionalnim grupama koje su zadužene za ovaj zakon. Zahvaljujem!

KRYETARI: Ju faleminderit!

I kemi edhe tre deputetë të lajmëruar për diskutime.

Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ky është një projektligj i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Konsideroj se ky projektligj, duhet të harmonizohet me Ligjin për duhanin. Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, kam vërejtur se disa nene në këtë projektligj, bien ndesh me Ligjin për duhanin. Për shembull, neni 14, pika 1 i këtij projektligji, i cili flet për vendin e shitjes së produkteve të duhanit, ku thuhet: “produktet e duhanit, në bazë të këtij ligji, tatimpaguesit akcizorë dhe të gjithë personat e tjerë juridik dhe fizik, nuk mund t’i shesin në vende ku nuk janë të destinuara si tregje dhe në vende ku mund të bëhet tregti informale, përveç në hapësirat ku ofrohen shërbime hoteliere dhe shitjes nga aparatet automatike”. Derisa në Ligjin për duhanin, neni 9, paragrafi 2, thuhet: “shitja apo ofrimi i duhanit, ndalohet përmes makinave automatike shitëse”. Mendoj se neni 14, pika 1 e këtij projektligji duhet të qartësohet dhe të hiqet fjalia: “se mund të shitet në aparate automatike”. Kjo edhe për në arsye, sepse derisa shitja e duhanit ndalohet t’iu shitet personave më të rinj se 18 vjeç, me këtë ju lejohet mundësia që ata të blejnë duhan në aparatet automatike, në objektet hoteliere. Prandaj, kërkoj nga Komisioni funksional që të harmonizojnë këtë ligj me Ligjin për duhanin. Ju faleminderit! Në parim e përkrah këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do t’i jap disa vërejtje dhe disa sugjerime lidhur me këtë draftligj. Konkretisht do të ndalem në nenin 5, paragrafi 2 në të cilën thuhet, citoj: “ministri i Financave përmes një udhëzimi administrativ, mund të ndryshojë bazën për llogaritjen e akcizës”. Mendoj se çështja e rregullimit të bazës për llogaritjen e akcizës, është dhe duhet të jetë çështje ekskluzive që rregullohet me ligj, sepse, nëse lejohet që ministri me një udhëzim administrativ të rregullojë këtë çështje, do të paraqiste një lloj parregullsie, eventualisht një mundësi të drejtpërdrejtë për keqkuptime apo edhe për keqpërdorime, sepse sipas paragrafit të parë, si bazë për llogaritjen e akcizës për cigare, është një kilogram peshë e zakonshme. Shtrohet pyetja vetvetiu çka do të bëjë sikurse me urdhëresë administrative të dyfishohej apo të trefishohej kjo peshë?

Si çështje e dytë që po ashtu dëshiroj ta shtroj lidhur me këtë ligj, është neni 9, pika 2, ku thuhet: “ministri i Financave mund që me udhëzim administrativ të saktësojë pronën, e cila përjashtohet nga taksat, kufizimet dhe konfiskimet”. Edhe për këtë çështje, mendoj se është objekt që duhet rregulluar me ligj e jo me akte nënligjore, sepse tek e fundit të gjithë ne e dimë se konfiskimi mund të jetë edhe si një lloj sanksioni penal, që mund të shqiptohet për vepër penale. Andaj, nuk është mirë që të mbetet në kompetencë të ministrit që me një akt të tillë, të ketë mundësi të përjashtojë pronat nga taksat, nga konfiskimet.

Në anën tjetër, në nenin 10, pika 1,4 dhe pika 1.5, haset një formulim shumë i përgjithshëm, që mendoj që më shumë është një formulim apo një gabim teknik që ka ndonjë qëllim apo prapavi të caktuar, ku thuhet: “produktet të cilat importohen hyjnë ose pranohen nga bota e jashtme për të cilat, me kodin doganor dhe akcizave, është paraparë lirimi nga detyrimet doganore”. Mendoj se mirë është të konkretizohet dhe të theksohet se është fjala për produktet e duhanit e jo të mbetet kështu e përgjithësuar siç është tani për tani në draftligj.

Ndërsa në nenin 13, në pikën e dytë kemi një përkufizim të këtillë: “pakot për shitje me pakicë, nuk duhet të përmbajnë gjësende që nuk janë produkte të duhanit”. Sipas këtij përkufizimi, mund të interpretohet ndryshe, se pakot që janë për shitje me shumicë, mund të përmbajnë gjësende të tilla. Prandaj, mirë është që ta kemi një përkufizim më konkret, në mënyrë që të mënjanoen dyshimet.

Kurse në nenin 14, pika 2, ekziston fjalia, sipas të cilës- shitja konsiderohet si prezantim ose posedim i këtyre produkteve. Ky është një formulim jo i përshtatshëm, i cili nuk është në pajtim me konceptin e vet institutit të shitjes.

Ndërsa në nenin 17, rregullohet çështja e sigurimit të pullave fiskale nga tatimpaguesit, të cilët sipas këtij neni janë të obliguar të aplikojnë për pulla fiskale në Doganë. Mirëpo, në draftligj më tutje, në asnjë dispozitë të tij, nuk rregullohet çështja se çka do të ndodhë me ta në qoftë se nuk aprovohet aplikacioni apo lutja e tyre. Andaj mirë është që të kemi ndonjë dispozitë tjetër ligjor me të cilën rregullohen situata të tilla. Dhe, krejtësisht në fund, në nenin 22, pika 1 dhe pika 2, trajtohen dispozitat sanksionuese të cilat në rastin konkret, nuk janë përcaktuar sipas standardeve juridike bashkëkohore, sepse në ligj thuhet: “dënimi me gjobë deri në 5 herë të shumës së akcizës të paevidentuar apo të papaguar dhe konfiskimit të produkteve”. Rëndom, sanksionet përcaktohen prej një limiti të ulët deri te një limit më i lartë, por pa e ndërlidhur me ndonjë kusht tjetër, siç është në rastin konkret shuma e akcizës së paevidentuar, sepse në praktikë mund të zbulohet ndoshta vetëm një pako apo vetëm një boks i duhanit, me akcizë të papaguar, kurse i njëjti person ndodh që ndoshta ka importuar ose ka eksportuar duhan edhe me kamionë. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Hydjat Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

E mbështesë sjelljen në Kuvend të këtij ligji dhe besoj edhe miratimin e tij, por si edhe deputetët e tjerë, kam dy – tri vërejtje. Së pari, edhe te përkufizimet atje flitet edhe për duhanin për përtypje si, nuk është ndonjë vërejtje e madhe, ndonjë problem, po krijon përshtypjen se është marrë nga përvojat e tjera. Nuk besoj te ne që e kemi këtë lloj duhani dhe këtë praktikë të konsumimit të duhanit. Nuk jam duhanxhi, megjithatë.

Vërejtja e dytë ka të bëjë me atë që theksoi me të drejtë deputeti Ymeri, trajtimin e njëjtë të, edhe të prodhimit vendor edhe të duhanit të importuar, por me një shtesë ndoshta, se në fakt prodhimin vendor të duhanit e kemi rrënuar tërësisht. Do të ishte shumë interesante që ndonjëherë të debatohet për këtë çështje, madje edhe të shikohet efekti i privatizimit, ta zëmë në prodhimin e duhanit. Unë vij nga Gjilani dhe mund të them se një pjesë e madhe e popullsisë që ka jetuar nga prodhimi i duhanit, tani është krejtësisht e pamundësuar që të ushtrojë këtë veprimtari.

Po vërejtja konkrete që besoj se do të merret parasysh dhe do të amendamentohet nga kolegët që janë në komisionin përkatës, ka të bëjë me nenin 10, u theksua pjesërisht edhe nga folësi paraprak, lirimi nga akciza. Nuk e kuptoj këtë lirim të disa kategorive që janë përfshirë këtu, ta zëmë diplomatët që duhet t'u lirohet, u dashka të lirohen me njëfarë reciprociteti ose edhe ata që kanë një autorizim, siç thuhet dhe aludohet, nënkuptohet që është një pjesë e pranisë ndërkombëtare në Kosovë.

Nuk e di nga vjen, por e vërteta është që një pjesë e madhe e duhanit në qarkullim në Kosovë, është i pa doganuar. Nëse e hap deriçkën, nuk është çudi pastaj që për të edhe të futet në sasi të madhe edhe malli i kontrabanduar. Besoj se këto do të korrigjohen në procesin e amendamentimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe diskutuesi i fundit, Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sipas të dhënave nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, në Kosovë pirja e duhanit është në rritje dhe numri i duhanpirësve në veçanti i atyre femrave, është në rritje e sipër. Është shqetësuese se gjatë vitit 2009, afër 21% e grave shtatzënë, kanë vazhduar të pinë duhan edhe gjatë shtatzënisë.

Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, Kosova ka afër 600.000 duhanpirës dhe harxhon afro gjysmë milioni euro në ditë për duhan. Duhani si njëri ndër shkaktarët kryesor të vdekjes në botë, te ne është trajtuar me ligj dhe kërkojmë nga Inspektorati që më seriozisht të merret me zbatimin e Ligjit kundër duhanit, ndërsa kur jemi te Projektligji për akcizën dhe produktet e duhanit, mbështes projektligjin në fjalë, duke e ditur se që gjitha të hyrat e grumbulluara në Thesarin e Kosovës, domethënë të gjitha grumbullohen atje, propozoj që në këtë normë të akcizës, një 10% të shkojnë drejtpërdrejt për shëndetësi edhe 10% për zhvillim të sportit. Sporti është aktivitet

përmes të cilin ngrisin aftësitë tona fizike, andaj, investimet në sport do të ishte preventiva më e mirë e dyfishtë. Së pari, përmes sportit do të kishim një masivizim të sportit, përmes këtyre investimeve dhe do të kemi një popullatë më të shëndoshë dhe së dyti, ngritja e çmimit të duhanit do të zvogëlojë numrin e duhanpirësve, me këtë edhe zvogëlimin e rrezikshmërisë nga sëmundjet të cilat do të vijnë si pasojë e konsumimit të duhanit.

Është shqetësuese se në Kosovë 17% e fëmijëve nga mosha 13 deri në 15 vjet, konsumojnë duhan. Atëherë, nëse këtyre fëmijëve iu krijohet kushte që të merren me sport, atëherë mundësia që të zvogëlohet duhan pirja do të ishte në shërbimin e shëndetit të tyre. Dhe së fundi, pasi që me këtë ligj do të ndikohet në përmbajtjen e pakos së duhanit e cila do të ketë pulla fiskale, propozimi im është gjithashtu, që në çdo pako cigare, po mendoj këtë që do ta marrë seriozisht Komisioni përgjegjës, që shitet në Kosovë, tek vërejtjet që janë në pako se duhani dëmton shëndetin dhe duhani vret, atëherë të vendosen foto me imazhe jo të këndshme, të cilat vijnë si pasojë e duhan pirjes. Kështu do të ndikohet me anë të imazhit të jepej mesazhi, ngase shpeshherë shkrimet të cilat janë në pako edhe injorohen nga duhanpirësit dhe nuk lexohen fare, nuk merren seriozisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Bekim!

Tash do ta votojmë në parim.

Në sallë kemi 64 deputetë, erdhën edhe 2, u bënë 66 deputetë,

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë, tash.

Me 57 vota “për”, 2 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime. Po besoj që komisionet e kanë parasysh në aftin e paraparë me Rregullore t’i bëjnë raportet me amendamentimin e ligjeve.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj Ministrin për Punë të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve, i sponsoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procedurat, kushtet dhe kriteret e prodhimit, tregtimit, importit, eksportit, transitit, transferimit, deponimit, përdorimit dhe asgjësimit të eksplozivëve dhe fishekzjarrëve. Gjithashtu ky projektligj, rregullon format për ushtrimin e kësaj veprimtarie si dhe dhënien dhe revokimin e licencave për personat juridik.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji, është i një rëndësie të madhe për faktin se kjo fushë nuk është e mbuluar në mënyrë të plotë me ligjin aktual në fuqi, andaj është konstatuar edhe nga ekspertët më eminentë vendor e ndërkombëtar se nevojitet një projektligj i ri për përdorimin civil të eksplozivëve, në të cilin do të specifikohen qartë dispozitat që kanë të bëjnë me rregullimin e saja fushe.

Projektligji ka 14 kapituj me gjithsej 56 nene. Projektligjit i është bashkëngjitur deklarata e pajtueshmërisë, e lëshuar nga Ministria për Integritet Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e BE-së, dhe vlerësimin e ndikimit buxhetor të lëshuar nga Ministria e Financave. Projektligji krijon stabilitet legjislativ për fushën të cilën e rregullon.

Nga arsyet e lartcekura, propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës, ta miratojë në parim Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve, në mënyrë që i njëjti t'i nënshtrohet procedurës së mëtejme. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Radha është për kryetarin e Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për deputetin Ahmet Isufi. Anton Quni, shumë mirë.

Fjalën e ke Anton!

ANTON QUNI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Kërkoj falje, zoti kryetar!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës të Sigurisë të Kosovës, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2011, shqyrtoi në parim Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet në parim Projektligji për përdorim civil të eksplozivëve.

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional, pas shqyrtimit të parë të Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve, në mbledhjen plenare e shqyrtoi këtë projektligj dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim, në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për përdorimin civil të eksplozivëve dhe ka konstatuar se ky projektligj është mjaft mirë i konceptuar dhe i plotëson kriteret të cilat e përcaktojnë: importin, eksportin, tranzitin, transferin, transportimin, deponimin, ruajtjen dhe mënyrën e shkatërrimit të mjeteve eksplozive dhe mjeteve tjera piroteknike.

Gjithashtu ky projektligj i adreson qartë të gjitha procedurat dhe parimet për përdorimin civil të eksplozivëve dhe mjeteve piroteknike si dhe në këtë projektligj, janë përfshirë të gjitha direktivat e Bashkësisë Evropiane për identifikimin, bartjen, transportin, ruajtjen dhe mbikëqyrjen e shkatërrimit të mjeteve eksplozive. Andaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozon që të miratohet në parim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Anton Quni, e ka fjalën.

ANTON QUNI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji për përdorimin civil të eksplozivëve në masë të madhe përcakton kushte dhe kriteret e prodhimit: tregtimit, importit, eksportit, transitit, transferimit, deponimit, përdorimit dhe asgjësimit të eksplozivëve dhe fishekzjarrëve, si dhe deri në një masë mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji. Ky projektligj po ashtu duhet të pamundësojë që përdorimi i eksplozivëve, mund të krijojë rrezik për rendin dhe qetësinë publike, mjedisin apo të bëhet çështje e terrorizmit.

Me këtë projektligj, ende ka hapësirë të trajtohen çështjet siç janë, që në situata të jashtëzakonshme, emergjente, krize, trazirave e tjera, eksplozivët duhet të vihen nën kontrollin dhe të sigurohen nga institucionet e sigurisë. Institucionet e sigurisë, duhet të posedojnë të dhënat e sakta për vendndodhjen dhe sasinë e eksplozivit në çdo moment, dhe listën e personelit të autorizuar për manipulim dhe qasje tek eksplozivët.

Po ashtu duhen të aplikohen masat veçanta për mbrojtjen e parqeve nacionale, monumenteve të trashëgimisë kulturore, monumenteve memoriale e tjera nga efektet e eksplozivit apo fishekzjarrëve.

Do të ishte mirë që të mos bëhet publike përbërja kimike e eksplozivëve që mund të shpërbejnë si udhëzues për prodhimin e eksplozivëve nga individë apo grupe të pa autorizuar. Dhe, në fund, të përkufizohet më saktë koha dhe vendi i përdorimit të fishekzjarrëve dhe masat e sigurisë që duhet të ndërmerren nga Policia e Kosovës, zjarrfikësit dhe shërbimet mjekësore.

Lidhja Demokratike e Kosovës, do të thotë deputetët e saj, do ta votojnë këtë ligj në parim dhe njëkohësisht do të ofrojnë ekspertizën sa më të lartë për hartimin e ligjit, të jetë sa më funksional dhe i implementueshëm me standardet më të larta evropiane të përcaktuara me Direktivën e Bashkësisë Evropiane 93/15 dhe 2007/23. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi, e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ligji për përdorim civil të eksplozivëve që parasheh të sanksionojë apo t'i rregullojë me ligj kriteret dhe kushtet e përdorimit civil të eksplozivëve dhe kushtet e mbikëqyrjes, po ashtu, është një ligj shumë i nevojshëm për rrethanat dhe kushtet tona. Bëhet fjalë kryesisht për eksplozive të minierave, përfshirë edhe gurthyesit dhe fishek zjarre. Pra, ky ligj do të rregullojë ose do të bëjë një rregullim të nevojshëm të përdorimit të këtyre materialeve si materiale shumë të ndjeshme dhe shpeshherë kanë rezultuar si të rrezikshme, sidomos në përdorimin e mjeteve piroteknike dhe fishekzjarrëve deri më tani gjatë kremtimeve dhe festave të ndryshme por jo vetëm kaq. Përvoja e deritashme e përdorimit të këtyre mjeteve piroteknike dhe fishekzjarrëve ka qenë përvojë e keqe dhe po ashtu ka shkaktuar aksidente shumë të mëdha edhe besoj që ky ligj ndoshta nuk mund të japë përfundim të gjitha fatkeqësive, po sido qoftë do t'i shërbejë shumë.

Rreth përdorimit ka qenë po ashtu përvojë jo e mirë edhe përvoja e importit dhe deponimit të tyre dhe mendojmë që ky ligj do të shërbejë shumë për rregullimin e këtij fenomeni. Pastaj, po ashtu jemi dëshmitarë të aksidenteve të ndryshme të cilat kanë ndodhur deri më tani, mendoj që ky ligj do të shërbejë shumë.

Ne si Grup Parlamentar do të japim kontributin tonë në Komisionin Parlamentar për Siguri Punë të Brendshëm dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me ekspertizën tonë, megjithëse e dimë shumë mirë që do të ketë një punë shumë të madhe që ky ligj të jetë sa më funksional, të jetë edhe sa më i kompletuar dhe i implementueshëm.

Pra, ne do të japim kontributin tonë në këtë ligj edhe në komision dhe njëkohësisht do ta votojmë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Mendojmë se ky projektligj vërtet ka një rëndësi të madhe, sepse kjo fushë gjithmonë ka pasur edhe ka jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet tjera, ka tendenca që për t'ikur kontrollit dhe mbikëqyrjes, qofshin për qëllime krejt tregtare, qofshin për qëllime tjera negative që mund të përdorin ose mund të ballafaqohemi në të ardhmen, sidoqoftë besojmë se është i shkruar mirë, oshtë goxha mirë i konceptuar, por gjatë procedurës tjetër duhet të ketë edhe pak saktësi, sidomos saktësi në aspektin e mbikëqyrjes të prodhimit edhe përdorimit edhe te pjesa e licencave dhe lejes së prodhimit, tek transportimi edhe tek deponimi, për atë që flitet për kushtet adekuate të sigurisë, për deponimin e këtyre. Gjithmonë është një fushë që ia vlen edhe duhet të ketë Qeveria dhe shteti i Kosovës, kujdes të veçantë, dhe normalisht se duket fare e qartë, ka një përputhje të mirë me standardet ndërkombëtare, por duhet të ketë edhe pak më tutje saktësi në fushat që i përmendën.

Normalisht, ne do të mbështesim dhe do të votojmë pro në parim të këtij projektligji dhe besojmë që me pak përmirësime do të jetë prej ligjeve më të mira që i kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Suzan Novobrdaliu, e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, pa dashur t'i përsëris disa vërejtje të parafolësve tanë, e përkrah këtë projektligj dhe kontributin do ta japim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanički klub Samostalne liberalne stranke razmotrio je Nacrt zakona o sigurnoj upotrebi eksploziva i slaže se da on ispunjava uslove za dalje procesuiranje i glasa za njegovo usvajanje u načelu. Ali moramo napomenuti da sam Nacrt zakona je lektorski loše urađen i ima dosta pravopisnih grešaka. Moramo napomenuti da nacrt zakona ima dosta nejasnih članova od kojih ću pomenuti samo neke.

U članu 2. tačka 1.27.3 Opasnost od požara ili opasnost od projekcije, te manje opasnosti od udara ili manje opasnosti od projekcije ili obojen, ali ne predstavlja veliku opasnost od eksplozije.

Imamo i nejasnu definiciju u istom članu 2. tačka 1.30 oko municije. U članu 3. u tački 5 i 6 imamo definiciju “nacionalni spisak eksploziva” i “nacionalni spisak dozvoljenih i zabranjenih petardi”. Verovatno se misli na “državni spisak”.

Nadamo se da će ove nepravilnosti ispraviti u daljem radu i da će sam zakon u budućnosti zaživeti jer je veoma velike važnosti. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala, predsedniče!

Nakon svih analiza i razmatranja, Nacrt zakona o civilnoj upotrebi eksploziva ispunjava propisane uslove. Možemo zaključiti da Nacrt zakona ispunjava i glave ciljeve evropskog zakonodavstva, a posebno za postizanje potrebnog nivoa zaštite ljudskog zdravlja i života, imovine i životne sredine.

Parlamentarna Grupa „6+“ u načelu podržava Nacrt zakona o civilnoj upotrebi eksploziva. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Me grupet parlamentare e përfunduar.

Kemi edhe 3 deputetë për diskutim. Po fillojmë me deputetin Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam vetëm një çështje lidhur me këtë draftligj dhe ajo ka të bëjë me nenin 16.8, në të cilin nën rregullohen masat e sigurisë për objektet e planifikuara për prodhimin, tregtimin dhe deponimin e eksplozive. Sipas këtij neni, objektet duhet të jenë fizikisht dhe teknikisht të sigurta, si dhe duhet të jenë jashtë zonave urbane, gjë që nënkupton se në zonat rurale mund të ndërtohen objekte të tilla apo mund të vendosen objekte të tilla, kurse në të dimë që zonat rurale janë të stërngarkuara shpeshherë me popullatë. Prandaj, mirë është që të gjejmë një përkufizim, një definim më të saktë që eventualisht qoftë me gjatësi, qoftë me kilometra, qoftë me metra të përcaktohen se sa larg mund të jenë objekte të tilla, në mënyrë që mos të kem ndonjë aksident me pasoja të rënda. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Vazhdojmë me deputetin Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në parim, edhe unë dëshiroj të shtroj diçka që mendoj që për këtë fazë është e rëndësishme.

E para, ky projektligj me aprovimin ose me përfundimin e tij e zëvendëson një ligj tjetër që veç para pak vitesh është aprovuar dhe është mirë që jemi në këtë fazë ku kemi një version tjetër të ligjit, i cili përfundimisht i plotëson disa sfera të rëndësishme dhe të cilat ligji ekzistues nuk i ka mbuluar, ka qenë ligj që ka ardhur në paket më herët. Është mirë që ka një version krejt tjetër dhe për më tepër është i punuar në bazë të standardeve më të mira. Po ashtu, është me rëndësi që kemi një pajtueshmëri të plotë nga të gjitha grupet. Nuk metët tjetër vetëm aprovim dhe zbatim të këtij ligji në vijim.

Ajo që dëshiroj të shtoj, është se ka dy kategori të cilat shfrytëzojnë eksplozivët në vendin tonë, është kategoria për qëllime të hulumtimeve dhe industriale, pra të minierave e të tjerë. Dhe, pjesa tjetër për çështje rekreative, të festave dhe mjete tjera piroteknike që përdoren qoftë prej teatrove ose për çështje tjera komerciale. Mendoj që shumë më shumë e rëndësishme është në ndërkohë të bëhet një listë shtetërore që e jep ligji dhe të merren parasysh gjendja aktuale si nga nevoja që kërkon në aspektin industriale, bëhet lista vetëm e atyre mjeteve që janë përdorë deri më tash dhe të mos jepen leje për ato që nuk janë kërkuar, pra vetëm me leje rishtazi të lejohen, sepse ligji e lejon.

Dhe, në pjesën tjetër, siç u tha këtu, kemi pasur dëme dhe incidente të mëdha nga përdorimi i mjeteve piroteknike. Mendoj që është momenti me këtë ligj të përpunohet lista e atyre mjeteve piroteknike që nuk duhet lejohen fare në tregun tonë dhe që nuk do ta zbehnin aspak ekzistimin ose festimin e ngjarjeve të ndryshme shtetërore dhe private duke hequr prej përdorimit disa mjete piroteknike të cilat vetëm shkaktojnë zhurmën dhe të cilat janë shkaktare në 90% i të gjitha incidenteve që ka ndodhur, sidomos me rastin e festimit të vitit të ri.

Dhe, sa u përket neneve, unë mendoj që në vijim ne do të japim kontributin tonë dhe sidomos komisionet përkatëse. Po është, për shembull, një pikë ku paraqitet te furnizuesit e fishekzjarrëve mbajnë evidencat për çdo furnizim që tejkalon 50 kilogram në së paku 3 vite. Mendoj që nëse kemi kufizim për kompanitë që bëjnë furnizimin, kjo do të ishte në rregull, por nëse nuk kemi fare kufizim, atëherë pse të ekzistoj ky. Mendoj që duhet të mbahet evidencë për çdo sasi e cila duhet të jetë në furnizim.

Në princip, mendoj që kemi një ligj të mirë dhe po ashtu jemi të gatshëm të kontribuojmë nëse ka ndonjë nevojë edhe gjatë fazës vijuese personalisht, mendoj që mund të jap ndonjë kontribut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

I mbylлим diskutimet me deputetin Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë do të jem i shkurtër, shumë i shkurtër. Nuk do të lëshohem në materien që ka rregulluar ky projektligj, por unë në deklaratën financiare prita që dikush do ta theksoj, e sheh ministria, besoj që është këtu ministri, thotë: Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Siguri Publike është deklaruar se nga buxheti aktual, por edhe nga buxheti i paraparë në dokumentin e KASH-it 2011 – 2013 nuk mund të përfshijë dhe të trajtojë këtë kosto buxhetore përmes kufirit buxhetor që është përcaktuar sipas dokumentit KASH-it 2011 – 2013, përkatësisht as masën monetare, por as stafin. Dhe këtë, krejt në fund, Ministria kompetente e Ekonomisë dhe Financave, tash e Financave sugjeron që ky projektligj të mos aprovohet. Mendoj që këtu duhet një sqarim para deputetëve, përndryshe nuk është interes as i Kuvendit, as i Qeverisë vetëm për ta aprovuar një projektligj dhe të mbetet në sirtar. S’kam më tepër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë numrin e kemi 62. Faleminderit!

Shkojmë në votim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Kështu, i miratuam ligjet, tash e kemi pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010

Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010, të përgatitur nga Ministria e Financave.

Radha e diskutuesve. Fjalën e ka ministri i Financave, Bedri Hazma.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejon që sot para jush të paraqes Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010.

Në programin e punës të prioritetëve, por edhe në dokumente të tjera të Qeverisë në vazhdimësi kërkohet nga të gjithë shpenzuesit të mjeteve buxhetore që të ngrisin sisteme efikase të kontrollit, menaxhimit, rrezikut, parasë publike dhe performancës operacilane për të siguruar se burimet e alokuara për secilin subjekt të sektorit publik duhet të pëndoren edhe në harmoni të plotë me ligjin.

Hartimi i raportit që po diskutohet sot, është rezultat i raporteve të marra nga njësitë e auditimit të brendshëm nëpër organizatat buxhetore që financohen nga buxheti i Kosovës.

Raporti që është para jush, në pika të shkurta prezanton të arriturat gjatë vitit 2010 në fushën e auditimit të brendshëm në nivel qendror dhe në nivel lokal, krahasuar me vitin paraprak, pastaj aktivitetet e Njesisë Qendrore Harmonizuese të auditimit të brendshëm, gjetjet konkluzionet, rekomandimet, si dhe planin e veprimit për vitin 2011.

Të arriturat gjatë vitit 2010, në fushën e auditimit. Dëshiroj të potencoj se në vitin e kaluar në fushën e auditimit kemi të arritura të konsiderueshme edhe ato konsistojnë në një numër çështjesh, sikurse që janë.

Hartimi i bazës ligjore për auditimin e brendshëm, aftësimi dhe trajnimi i auditorëve të brendshëm në lëmitë kyçe profesionale, rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional në këtë drejtim.

Sidoqoftë, shkurtimisht do të potencojë se gjatë vitit 2010 ka rritje të performancës, si dhe të efektivitetit të auditivit, të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë efikasitetin e auditimit të brendshëm në aspekte të ndryshme. Rritja e numrit të njësive të auditimit të brendshëm për 8.47%, rritja e numrit të komuniteteve të auditimit për 16.13% dhe rritja e numrit të auditorëve të brendshëm prej 14.43%.

Bazuar në raportet e marra dhe njësitë e auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2010 janë kryer 364 auditime të brendshme dhe për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm janë dhënë 1987 rekomandime, prej tyre: 53.35% janë implementuar, 28.23% janë në proces të implementimit dhe 18.42% nuk janë implementuar.

Vlen të përmendet se një numër i rekomandimeve të paimplementuara i përkasin tremujorit të fundit të vitit të kaluar.

Për të adresuar çështjet e paraqitura, ne rekomandojmë që të ndërmerren disa veprime gjatë vitit 2011, si për shembull, menaxhimi i subjekteve të sektorit publik t'i plotësojë njësitë e auditimit të brendshëm me staf të nevojshëm, konform planeve të tyre për auditim, standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira profesionale.

Auditorët e brendshëm të përkrahen vazhdimisht nga menaxhmenti, duke u siguruar kushte adekuate për punë, pavarësinë e plotë, mos kufizimin e kontratave të punës, pjesëmarrjen në trajnime të organizuara nga Ministria e Financave - Njësia Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm dhe shoqatat tjera profesionale vendore dhe ndërkombëtare.

Subjektet e sektorit publik, të cilat ende nuk i kanë krijuar komitetet e auditivit, t'i krijojnë ato duke u bazuar në udhëzimin administrativ për krijimin dhe funksionimin e komuniteteve të auditimit. Një përkushtim më i lartë i menaxhmentit për kontroll të brendshëm, transparencë, llogari dhënie dhe kompetencë për menaxhimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Të nderuar deputetë,

Të vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e auditimit të brendshëm, komentet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja ndaj këtij raporti do të kontribuojnë në ngritjen e performancës së auditimit të brendshëm në përgjithësi sepse një auditim i mirë do të përmirësojë edhe më tepër sistemin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të financave publike, që domethënë se do të kemi një qeverisje më të mirë në shfrytëzimin e parave publike. Ky është një synim i ynë i përhershëm dhe objektivë e prioritetëve të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është për kryetarin e Komisionit funksional, deputetin Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mbledhjen e vet të mbajtur më datën 24 maj 2011, ndër të tjera shqyrtoi raportin e auditimit të brendshëm nga Njësia Qendrore Harmonizuese, për vitin 2010. Në mbledhje ishin të pranishëm ministri i Financave, drejtori i Njesisë Qendrore Harmonizuese, ishte drejtori gjeneral me ekipin e vet i Zyrës së Auditimit dhe bashkërisht shqyrtuam Raportin në fjalë.

Gjatë hartimit vërehet se janë kryer një sërë çështjesh shumë të rëndësishme dhe vërehet një progres i shtuar në raport me vitet e kaluara. Janë kryer 364 auditime, nga ato dalin 1987 rekomandime, prej tyre 53.5 janë implementuar, 28.23 janë në implementim e sipër dhe kanë ngelur të pa implementuara edhe 18.42. Shpresojmë që ky trend të vazhdojë dhe këto përmbushje të arrihen.

Ashtu siç tha ministri, në një mënyrë e morëm edhe si premtim të tij, që duhet angazhuar edhe më tutje në plotësimin e njësive të auditimeve të brendshme. Kemi parasysh standardet e kërkuara, në veçanti te komunat e mëdha, e keni Mitrovicën dhe Prizrenin me nga një, duhet më së paku 2 apo 3. I kemi tri komunat e veriut Leposaviq, Zubin Potok e Zveçan, që nuk ka raporte dhe unë nuk e kuptoj pse s'ka raporte, duhet t'i detyrojmë, kemi mundësi t'i detyrojmë përmes buxhetit, përmes formave tjera. Ne nuk mund të lëshojmë mjete pa e ditur se ku shkojnë, pa e dhënë një llogari për ato se ku janë. Pastaj, duhet formuar edhe njësitë e auditimit te komunat e reja, që janë formuar rishtas, po ashtu edhe ministritë e reja.

Shpresojmë që këto do të ndodhin, përgjithësisht thash ky raport i plotëson standardet dhe si të tillë ne ia rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Valbona Dibra ka kërkuar fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës.

Raporti, siç shihet, prezanton zhvillimet në fushën e auditimit të brendshëm në nivelin qendror dhe lokal gjatë vitit 2010. Dihet se për funksionimin e auditimit të brendshëm është shumë e rëndësishme korniza legjislative, e cila përfshinë Ligjin për auditimin e brendshëm, Doracakun për auditimin e brendshëm, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, Kodin e etikës, praktikat më të mira profesionale për auditimin e brendshëm, të cilat, i gjithë ky legjislacion ka ndihmuar shumë në punën dhe funksionalizimin e auditimit të brendshëm në Kosovë.

Po ashtu, akter kyç për funksionimin e auditimit të brendshëm në Qeverinë e Kosovës janë: Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, njësitë e auditimit të brendshëm, auditorët e brendshëm, komitetet e auditimit dhe menaxhmenti.

Në raport janë paraqitur të arriturat në fushën e auditimit të brendshëm, siç janë: nxjerrja e udhëzimit administrativ për themelimin dhe funksionimin e komiteteve të auditimit, krijimi i njësive të reja të auditimit, rritja e numrit të auditorëve, rritja e numrit të auditorëve si dhe trajnimi profesional i tyre. Këto të arritura janë rezultat i punës së mirë që ka bërë Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2010.

Po ashtu, gjatë vitit 2010 Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm nga gjithsej 63 njësi të auditimit të brendshëm, ka pranuar 61 raporte, domethënë raporte këto të kënaqshme. Nga kjo shihet se kjo njësi Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm ka monitoruar dhe vlerësuar funksionimin e auditimit të brendshëm të subjekteve të sektorit publik në Kosovë.

Deri në fund të vitit 2010, siç u cek edhe nga parafolësit e mi, 64 subjekte kanë themeluar njësinë e auditimit të brendshëm. Nga këto njësi ende nuk është themeluar njësia e auditimit të brendshëm në komunat serbe, me përjashtim të asaj të Shtepcës. Në këtë drejtim duhet bërë më shumë që edhe komunat tjera me banorë serbë sa më shpejtë të krijohen këto njësi.

Gjatë vitit 2010, në nivelin qendror dhe atë lokal janë kryer 364 auditime, kur si rezultat i këtyre auditimeve auditorët e brendshëm kanë dhënë 1987 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Prej tyre janë implementuar 1060, në proces të implementimit janë 561, ndërsa pjesa tjetër pritet të implementohet në vitin 2011.

Një nga të arriturat e cekura në këtë raport është edhe themelimi i komiteteve të auditimit si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokalë. Gjithsej në komitetet e auditimit janë mbuluar 41 subjekte të sektorit publik. Nga e gjithë kjo që u tha më lart, na gëzon fakti se dita ditës sektori i auditimit në Kosovë po profesionalizohet falë angazhimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional dhe mbështetjes së Qeverisë në forcimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm.

Dhe, në fund, ne si Grup Parlamentar përkrahim raportin në fjalë dhe njëherësh kërkojmë ose ftojme edhe grupet tjera të përkrahin këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Jo vetëm në këtë raport, por edhe në raporte tjera dhe thuaja se në të gjitha raportet është një çështje që Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike e shqetëson dhe ajo është se baza e regjistrimit të pasurisë nuk është në harmoni me nevojat e një transparence të plotë për mënyrën e furnizimit, mënyrën e trajtimit dhe bazën ekzistuese të pasurisë në organizatat buxhetore. Po thuaje se te të gjitha kemi shpërputhje të shënimeve mes thesarit, librave e tjera. Asnjë raport nuk mund të jetë i saktë nëse kjo nuk

është një databazë themelore dhe e saktë që në çdo periudhë mund të na japë vlerën e vetë.

Prandaj, kisha kërkuar dhe, jo vetëm tash, po prej pas luftës kjo dukuri i ka përcjellë po thuaja se të gjitha organizatat buxhetore. Prandaj, do të kërkoja nga ministri i Financave që përmes udhëzimit administrativ, eventualisht ligjit, në Qeveri të nxirren normat detyruese që regjistrimi i pasurisë të bëhet ashtu siç e bën e tërë bota, siç i kemi bërë edhe ne në të kaluarën. Në çdo fund viti, pasuria duhet të regjistrohet, nga ajo të shihet cila është e vlefshme, cila është e pavlefshme, cila është amortizuar, cila është pasuri e re gjatë vitit që ka ardhur dhe cila është bazua ekzistuese, këto nuk i kemi dhe kjo na është bazë.

Prandaj, mendoj se është koha e fundit që kësaj i vejmë kapak, zoti ministër, se përndryshe krejt këto çka flasim janë parashikime, por kjo është baza mbi të cilën mund të konkludojmë në mënyrë më profesionale dhe në mënyrë të saktë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit!

Raporti të cilin e kemi përpara, natyrisht e mbulon një fushë që është shumë e rëndësishme, ajo e auditimit të brendshëm, ... dorën në zemër, në Kosovë nuk ka funksionuar ashtu siç duhet dhe siç e përshkruan madje edhe raporti. Kjo fushë është tejet e rëndësishme në parandalimin e keqpërdorimeve qoftë të qëllimshme apo të paqëllimshme të parasë publike dhe për këtë arsye e konsiderojmë që është shumë e rëndësishme.

Pra, këtu në raport janë paraqitur disa shifra ku tregohet një lloj progresi në rritjen e numrit të njësive edhe qendrore, edhe lokale të auditimit të brendshëm, po megjithatë nuk është ndonjë progres i cili mund të çmohet shumë. Për shembull, në vitin 2008, siç thuhet në tabelën, faqe 11, kanë qenë 50 sosh, përgjegjësi edhe në nivelin qendror, edhe lokal. Pastaj në vitin 2009 janë bërë 59, pra janë shtuar 9, dhe në vitin 2010, kjo shifër arrin në 64, pra janë shtuar 5, pra trendi është në rënie. Po ashtu, diçka që është tepër brengosëse është që, megjithatë, edhe pse janë funksionalizuar këto njësitë e auditimit të brendshëm, një pjesë e madhe e tyre nuk e kanë numrin e mjaftueshëm të auditorëve, domethënë sipas raportit që janë të domosdoshëm për ta kryer punën ashtu siç duhet, pra shumica e njësive vazhdojnë të jenë me nga një auditor, gjë që natyrisht, për ata që e kuptojnë fushën e auditimit, është e pamundshme që të auditohet një njësi e shpenzimit të buxhetit me vetëm një auditor. Në të gjitha ato fusha në të cilat pritet që ky auditor të jetë aktiv po ashtu konsiderojmë që duhet të përdoret një formë aktive e shtytjes apo cytjes së menaxhmentit dhe për t'i krijuar këto njësi të auditimit të brendshëm për shkak se ne e dimë që për nga natyra menaxhmenti është, nëse mund ta quaj këtë fjalë, armiku më i madh i auditimit për shkak se, pa auditim, menaxhmenti ka dorën e lirë që të punojë ashtu si të dojë me njësinë, ndërkohë që auditimi do të duhej të ishte ajo pararoja në mënyrë që ta mbajë menaxhmentin përbrenda dispozitave ligjore të menaxhimit financiar.

Prandaj, është tejet e rëndësishme që të ushtrohet trusni më e madhe në të gjithë njësitë, qoftë të nivelit qendror apo lokal, që t'i funksionalizojnë njësitë e auditimit të brendshëm, t'i pajisin ata me të gjitha, domethënë edhe me personelin e duhur, por edhe me pajisje tjera të nevojshme, në mënyrë që ata të jenë pastaj në gjendje që ta kryejnë punën ashtu siç duhet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Aleancës, deputeti Bali Muharemaj.

BALI MUHAREMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka shqyrtuar Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010.

Raporti prezanton të arriturat dhe sfidat gjatë vitit 2010 në nivelin qendror dhe lokal. Është arritur progres në funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm, mirëpo mbetet sfida implementimi i rekomandimeve, pastaj krijimi i komiteteve të auditivit, si dhe të njësive të auditimit. Ka komuna të cilat akoma nuk kanë njësi të auditimit.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010, dhe do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet këtë raport. Raporti vë në dukje se ka një progres në afirmimin e këtij funksioni shumë të rëndësishëm, domethënë se duhet të punohet shumë në ngritjen e vetëdijes së udhëheqësve të agjencive buxhetore dhe të ministrive që të jenë shumë koshient për rëndësinë që ka auditimi i brendshëm. Pra, në atë drejtim duhet të kërkohet më tepër punë dhe gjithashtu nevojitet, siç u tha këtu, që të afirmohen komitetet e auditimit të brendshëm, sepse ato me të vërtetë duhet të lëvizin gjërat në përmirësimin e menaxhimit të përgjithshëm të financave publike.

Gjithashtu, në të ardhmen sigurisht nevojitet që të shtohen përpjekjet që të realizohet plani plotësisht i auditimit dhe kjo ka të bëjë sidomos me disa agjencione shumë të rëndësishme që harxhojnë një buxhet të rëndësishëm, siç është Universiteti i Prishtinës ose disa komuna ku shihet një aktivitet modest i auditimit të brendshëm.

Në këtë drejtim, pra, me këto përmirësime, mendoj se duhet të mbështetim proceset e zhvillimit të këtij funksioni të rëndësishëm, të cilët janë në ngritje. Megjithatë, duhet të kuptohet se auditimi i brendshëm nuk është për një auditim një herë në vit, qysh mund të

jetë auditivi ekstern. Auditimi i brendshëm duhet të ketë një frekuencë shumë më të madhe të punës dhe të raportimit, ... funksione të ndryshme të agjencive dhe ministrive, qoftë në fushën e prokurimit, qoftë në fushën e çështjeve tjera të menaxhimit të përgjithshëm të financave publike. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të SLS-së, Mursel Halili e ka fjalën.

MURSEL HALILI: Uvaženi predsedniče,

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne strane je razmatrala izveštaj o funkcionisanju sistema unutrašnje revizije u javnom sektoru. Smatramo da je neophodno potrebno podržati nalaze Komisije za nadzor javnih finansija, koji je izneo predsednik komisije, gospodin Ali Sadriu. Smatramo neophodno potrebnim da se izvrši veći pritisak na adresiranje preporuka u cilju poboljšanja stanja utrošenje javnog novca. Međutim, u izveštaju smo takođe konstatovali da ne postoji podatak o broju revizora na centralnom i lokalnom nivou, a da su to pripadnici nacionalnih zajednica. Smatramo da je to neophodno potrebno, jer se može dogoditi da se broj revizora popuni u narednom periodu, a da ne zadovolji potrebe Zakona o zapošljavanju u javnom sektoru od strane pripadnika nacionalnih zajednica.

U principu, Parlamentarna grupa i u načelu mi ćemo podržati ovaj izveštaj. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit “6+” deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+”, pas shqyrtimit të Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010, dhe pasi që mendojmë se ky raport i plotëson të gjitha kriteret e nevojshme për miratim, do ta mbështesim këtë raport të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të lajmëruar për diskutim nuk ka.

Hymë në procedurën e votimit.

Në sallë janë 66 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash, 67 u bënë.

Konstatohet se me 59 vota “për”, 2 “kundër” dhe një abstenim, Kuvendi miratoi Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

10. Rekomandimi i Organit Përzgjedhës lidhur me emërimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Organi Përzgjedhës i Pavarur, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës më 19 maj 2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2011, ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Organi Përzgjedhës i Pavarur ka rekomanduar Kuvendit që zoti Osman Kryeziu, të emërohet anëtar i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar propozimin, vlerëson se kandidati i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara dhe e përkrah këtë kandidaturë.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë, si deputet do të flas, por po flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Faktikisht, personi në fjalë i plotëson kushtet ligjore për të qenë anëtar i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, por ne kemi arsye pse nuk duhet përkrahur dhe nuk duhet të votohet ky propozim, është sepse institucionet e pavarura po shndërrohen në institucione politike apo, të them konkretisht, në institucione të cilat nuk do të jenë në funksion dhe nuk do ta kryejnë punën e vetë me sukses. Arsye pse e them këtë është se personi në fjalë ka qenë kryeprokuror i Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë nga viti 2002 – 2010, dhe dihen rezultatet e tij në këtë fushë edhe në aspektin profesional, por edhe në angazhimin e tij për zbardhjen e krimeve në territorin e Prishtinës dhe në rrethinë. Prandaj, ne nuk e përkrahim këtë propozim dhe, po ashtu, i rekomandojmë Qeverisë që mos t'i shndërrojë organet e pavarura në organe sociale për ata që mbesin pa punë për shkak të mos aftësisë profesionale. Kjo është arsyeja jonë pse ne nuk e përkrahim këtë propozim.

KRYETARI: Faleminderit, Armend!

Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: I nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” ka vendosur që të abstenojë karshi këtij votimi për shumë arsye që u përmendën këtu, domethënë personi në fjalë e dimë se ka punuar si prokuror, e dimë po ashtu se edhe ka kandiduar edhe një herë si prokuror dhe nuk ka qenë i suksesshëm për t'u pranuar aty, pra nuk është një person i cili ka dëshmuar të jetë në aspektin profesional i përgatitur sa duhet, kështu që, për të mos votuar kundër këtij për shkak se nuk mund të themi që kemi edhe aq shumë informata për të, do të abstenojmë në këtë votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Aleancës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta abstenojë votimin në këtë pikë për shkak se nuk jemi pjesëmarrës nëpër zgjedhje dhe as në përcaktimin e ... Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit për Kosovën e Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re e përkrah vendimin e Qeverisë për anëtarin e Organit Shqyrtues të Prokurimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së? Nuk ka.

Në emër të Grupit parlamentar të “6+”? Nuk ka.

Atëherë, shkojmë në procedurën e votimit.

Në sallë kemi 65 deputetë, edhe 3 erdhën, 68.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 37 vota “për”, 16 “kundër” dhe 15 abstenime, Kuvendi zgjodhi zotin Osman Kryeziu, anëtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Vazhdojmë në pikën e njëmbëdhjetë:

11. Njoftim i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, për emërimin e deputetes Suzana Novoberdali, në vend të deputetit Ibrahim Makolli, në Komisionin parlamentar për ndryshime Kushtetuese,

Me kaq e përfundojmë seancën e sotshme. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve